

Zbardhet raporti i dekriminalizimit, 39 funksionarë të lartë rezultojnë të dënuar, 31 prej tyre nën hetim për falsifikim të të dhënave



Faqe 7

Afrimi i SPAK, mazhoranca premton rihapjen e dosjeve të bujshme, juristët tregojnë rrugët si do shkohet te “21 janari”, Gërdeci e afera “Durrës-Kukës”



Faqe 2,3

Dekriminalizimi, Prokuroria nis verifikimet për Kajmakun, PD hetime paralele për katër kryebashkiakët e tjerë

Prokurori ka nisur verifikimet për kryebashkiakun e Vorës Agim Kajmakun, pas akuzave të PD se ka qenë i dënuar në Greqi. Sipas burimeve, pritet që të merren shenjat e gishtave për Kajmakun në mënyrë që të verifikohet nga “Interpol Athina” nëse është apo jo i dënuar...

Faqe 6

Integrimi, gjermanët dhe OSBE gati të marrin në dorë situatën në shtator, tentativa për të negociuar mes PD-PS për zgjidhjen e krizës

Shtatori pritet të sjellë zhvillime të forta, sa i takon krizës politike në vend. Zgjedhjet vendore të 30 qershorit kaluan, ndërsa kriza politike vijon të mbetet ende prezente në vend, ku asnjë nga palët nuk hap rrugë. Por sytë tani janë kthyer nga ndërkombëtarët, të cilët sipas...

Faqe 8

Thellohet skandali me kreditë e “Veneto Banka”, ja arsyet pse Banka e Shqipërisë nuk shpalli falimentin

Thellohet akoma dhe më tepër skandali me falimentimin e “Veneto Banka”. Dokumentet që na kanë rënë në dorë së fundmi, tregojnë qartë pse Banka e Shqipërisë fshehu procesin e falimentimit të Grupit Veneto Banka në Itali. Nëse homologia e saj, Banka Qendrore e Italisë disponon një sërë shkresash dhe dekretesh të...

Faqe 9

Zbardhet udhëzimi, rriten pagesat për personat me aftësi të kufizuara, ja përfitimet sipas kategorive

Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale ka vendosur të rrisë pagesat për personat me aftësi të kufizuara, por edhe për personat që ju shërbejnë atyre. Në Qendrën e Botimeve Zyrtare janë botuar disa udhëzime të ministres Ogerta Manastirliu, të cilat tregojnë sesi do...

Faqe 10

PD-LSI pendohen për djegien e mandateve, 11 ish-deputetë padisin Kuvendin, kërkojnë pagat për periudhën e bojkotit parlamentar

Putin frymëzim për Ilir Metën, presidenti udhëtime në male njësoj si homologu rus, ja faktet që tregojnë lidhjet tij me Moskën

Zbulohet personi i cili frymëzon presidentin Ilir Meta. Në një intervistë që ka dhënë për mediat ruse një vit më parë, ai tha se frymëzohet nga

shkrimtarët rusë, por duket se frymëzimi i tij më i madh vjen nga drejtuesi i Rusisë. Shtëpia në “Gjirin e Lalëzit” duket se ja ka hequr dëshirën e

detit presidentit, i cili prej disa vitesh ka vendosur që të udhëtojë nëpër male, të lahet në liqene akullnajore, të vizitojë shpella...

Faqe 5

Amerikanët zbardhin detajet e zhvillimeve më 1990, ja si Ramiz Alia nisi të jepte sinjale se do linte pushtetin, nga vota e fshehtë, te kufizimi i posteve në parti

Faqe 15

Ndërkombëtarët japin alarmin, mos hapja e negociatave në tetor rrit rrezikun rus në Shqipëri, Moska me sytë nga Ballkani

Rreziku rus për Shqipërinë dhe vendet e tjera të Ballkanit duket se po rritet nga dita në ditë. SHBA dhe shumë vende të tjera kanë dhënë alarmin në këtë aspekt duke sjellë jo pak raste dhe reagime të ashpra...

Faqe 4

KOMENT & ANALIZE

F. 16-18

Nga Pirro PRIFTI

De-Heroizmi ose Shqipëria përballë humbjes së Identitetit Kombëtar

Nga Bardhyl BEJKO

Basha, na thuj një ofertë të ndërkombëtarëve refuzuar nga Rama!

Nga Besi BEKTESHI

Alessia e vogël nuk flet shqip, ajo është “integruar” në Evropë!

politike

Prefekti i Shkodrës i dërgon letër Metës për vakancën e krijuar në bashki, presidenti kërkon që të futet në lojë Këshilli i Ministrave

Prefekti i Shkodrës, Çesk Millja ka dërguar një letër për Presidentin e Republikës, Ilir Meta, ku e informon për vakancën e krijuar në bashkinë e këtij qyteti nga dorëheqja e kryetarit të dalë nga zgjedhjet e 30 qershorit. Sipas burimeve të gazetës, kjo letër nuk ka mbërritur akoma në zyrën e presidentit. Burimet i thanë gazetës se Presidenca ka ndërmend të shprehet për vakancën e krijuar vetëm pasi ta kenë në duar këtë shkresë. Gjithsesi, burimet thonë se kreu i

shtetit nuk ka asnjë detyrim ligjor t'i kthejë përgjigje letrës informuese të prefektit Çesk Millja. Sipas të njëjtave burime, ligjërisht institucioni që duhet t'i drejtohet zyrtarisht presidentit për ta informuar dhe për t'i kërkuar shpalljen e një date për zgjedhjet në rast të krijimit të një vakance në drejtimin e një bashkie është Këshilli i Ministrave. Ato saktësojnë se ligji që përcakton këtë procedurë është ai për qeverisjen vendore. E në këtë ligj në nenin 61 pika 3 e tij, thuhet se për rastet e

përfundimit të mandatit të kryetarit përpara afatit, Këshilli Bashkiak njofton Këshillin e Ministrave nëpërmjet prefektit. Në rastet e përfundimit të parakohshëm të mandatit, organizohen zgjedhjet e pjesshme për kryetarin e bashkisë, në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. E në kod përcaktohet se kreu i shtetit duhet të dekretojë një datë të re zgjedhesh brenda 48 orësh nga dorëheqja apo ndërprerja e mandatit të kryebashkiakut, e mbajtjes e zgjedhjet duhet të

kryhen jo më herët se 30 ditë dhe jo më vonë se 45 ditë. Burimet e Presidencës ripërsërisin qëndrimin e kreut të shtetit kur pyeten nëse do të ketë një dekret për datën e zgjedhjeve të pjesshme në Shkodër. Kreu i shtetit nuk i njeh zgjedhjet lokale të 30 qershorit dhe si pasojë nuk do të ketë asnjë dekret tjetër veç atij ku si datë e shpalljes së garës për vendoret e 2019 të jetë 13 tetori. Për shkak të këtij qëndrimi të presidentit, pritet të thellohet me tej kriza kushtetuese e politike në vend.

Ish-deputetët mbledhin disa periudha bojkoti për të përfituar disa paga nga Kuvendi

PD dhe LSI pendohen për djegien e mandateve, 11 ish-deputetë padisin Kuvendin, kërkojnë pagat për periudhën e bojkotit

Mimoza IBRA

Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim duket se janë penduar për vendimin ekstrem që morën në shkurt të këtij viti për të dorëzuar "në bllok" mandatet. Një gjë të tillë e tregojnë fare qartë tentativat e ish-deputetëve për të siguruar rrogë gjatë kësaj kohe që janë "të papunë". Në Gjykatën Administrative të Apelit janë regjistruar 11 padi nga ish-deputetët e opozitës, kryesisht të Partisë Demokratike të cilët kërkojnë nga Kuvendi i Shqipërisë që t'iu japë rrogën për periudhën e bojkotit. Që nga shtatori i 2018 e deri në janar të vitit 2019 opozitarët nuk morën pjesë në aktivitetet parlamentare. Për këtë periudhë kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, jua ndërpreu financat, por tani përfaqësuesit e PD-LSI kërkojnë para nga Kuvendi. Në fund të korrikut, pra 4 muaj pas djegies së mandateve, ish-deputetët e PD, Jorida Tabaku dhe Nadire Meçorapaj i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit, ku kërkojnë paratë e periudhës së bojkotit. "Padi të: Nadire Meçorapaj, Jorida Tabaku; I paditur: Kuvendi i Shqipërisë; Objekti: Detyrimin e Kuvendit të Shqipërisë të më paguajë përfitimet financiare të papaguara që burojnë nga legjislacioni për "Statusin e Deputetit" dhe që lidhen me ushtrimin e funksionit si deputet për periudhën korrik 2018 - janar 2019", thuhet në kërkesën e opozitarëve. Gjykatës Administrative të Apelit për të kërkuar pagat për një periudhë kur nuk ka marrë pjesë fare në Kuvend i është drejtuar edhe Luan Baçi. Të tjerë emra që si duket nuk po e përballojnë fort mirë djegien e mandateve janë edhe ato të Albana Vokshit, Genc Pollos, dhe Shezai Rrokajt. Ky i fundit deri tani është i vetmi nga radhët e LSI që ka kërkuar pagën për periudhën e bojkotit. Kërkesat e tyre të regjistruara në gjykatë vijnë vetëm pak muaj pas djegies së mandateve.

Bojkotet e tjera

Interesant është fakti se ka nga ata ish-deputetë të opozitës, të cilët kanë mbledhur disa periudha bojkoti për të përfituar sa më shumë para nga Kuvendi i Shqipërisë

JA PARASHIKIMET NË LIGJIN "PËR STATUSIN E DEPUTETIT"

"Mospjesëmarrja pa shkaqe të përligjura të deputetit në seancë, në komisione ose në veprimtari të tjera parlamentare sjell ndalesën e pjesshme të pagës ose të shpërblimit. Raportet e pagës, masës së dietës, të shpërblimit, si dhe norma për transportin që përfiton deputeti, kryetari i komi-

sionit, nënkomisionit dhe kryetari i grupit parlamentar përcaktohen me vendim të Kuvendit. Mospjesëmarrja pa shkaqe të përligjura e deputetit në seancë, në komisione ose në veprimtari të tjera parlamentare sjell ndalesën e pagës ditore", thuhet në ligjin "Për statusin e deputetit".



Në Gjykatën Administrative të Apelit janë regjistruar 11 padi nga ish-deputetët e opozitës, kryesisht të Partisë Demokratike të cilët kërkojnë nga Kuvendi i Shqipërisë që t'iu japë rrogën për periudhën e bojkotit. Që nga shtatori i 2018 e deri në janar të vitit 2019 opozitarët...

Edhe Mesila Doda kërkon pagë nga Kuvendi

Edhe ish-deputetja e PDIU, Mesila Doda i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit për të marrë nga Kuvendi i Shqipërisë pagën për një periudhë kohe kur ajo ka bojkotuar aktivitetet parlamentare kur ishte deputete. "Detyrimin e Kuvendit të

Shqipërisë, të më paguajë përfitimet financiare të papaguara që burojnë nga legjislacioni për "Statusin e Deputetit" dhe që lidhen me ushtrimin e funksionit për periudhën 01.07.2014 - 01.01.2015", thuhet në kërkesën e ish-deputetes së PDIU, Mesila Doda.

që burojnë nga legjislacioni për "Statusin e Deputetit" dhe që lidhen me ushtrimin e funksionit, për periudhën 01.07.2014 - 31.01.2015 dhe për periudhën 01.02.2017 - 01.06.2017 në vlerën prej 532.874 lekë. Detyrimin e të paditurit, t'i paguajë paditësit Oerd Bylykbashi përfitimet financiare të papaguara që burojnë nga legjislacioni për "Statusin e Deputetit" dhe që lidhen me ushtrimin e funksionit, për periudhën 01.07.2014 - 31.01.2015 dhe për periudhën 01.02.2017 - 01.06.2017 në vlerën prej 607.827 lekë. Detyrimin e të paditurit, t'i paguajë paditësit Edi Paloka përfi-

timet financiare të papaguara që burojnë nga legjislacioni për "Statusin e Deputetit" dhe që lidhen me ushtrimin e funksionit, për periudhën 01.07.2014 - 31.01.2015 dhe për periudhën 01.02.2017-01.06.2017 në vlerën prej 583.553 lekë", thuhet në kërkesën e opozitarëve. Luçiano Boçi nga ana tjetër kërkon pagat për periudhat shkurt-qershor 2017 dhe korrik 2018-janar 2019, ndërsa kryetari i PBDNJ kërkon pagën vetëm për periudhën shkurt-qershor 2017. Pra, opozitarët tani që janë pa paga, kërkojnë nga Kuvendi benefite me qëllim që ta përballojnë jetën jashtëparlamentare.

Jamabër Mallezi: Qeveria vjedh dhe tall qytetarët

Shefi i departamentit të Mjedisit në PD, Jamabër Mallezi akuzoi dje qeverinë se po abuzon me Bulevardin "Zogu I". Përmes një postimi në rrjetet sociale, ai deklaroi se mazhoranca nga njëra anë të vjedh dhe nga ana tjetër tallt me popullin. Sipas tij, për këtë projekt qeveria po kërkon të vjedhë gjashtë milionë euro të tjera, pasi grabiti 3 milionë euro më parë. "Bulevardi "Zogu I" duke u shkep. Para 12 vitesh njëri na vodhi 3 milionë euro nga taksat tona dhe na tha që e kishte zgjidhur punën dhe veç pas 70 vitesh do rikonstruktohej. Tani del një qerrata tjetër që na përland 6 milionë euro për 613 m gjatësi (10 milionë euro për km!) se do ndërrojë pllakat. Këta edhe të vjedhin, edhe të tallin se nuk kanë as popull protestues dhe as shtet ligjor ku të vepronte ligji", u shpreh demokrati Jamabër Mallezi në reagimin e tij. Kujtojmë se, kontrata në fjalë, e cila sërish i është dhënë "Fusha sh.p.k", është nënshkruar më 26 qershor.

Bujar Nishani: Të hetohen krimet e komunizmit

Ish-Presidenti i Republikës, Bujar Nishani përkujtoi ditën e djeshme Ditën Evropiane të Kujtimin të Viktimave të Nazizmit dhe Komunizmit. Përmes një postimi në rrjetet sociale, Nishani deklaroi se ka ende nga ata përfaqësues të regjimit që vijoje të kenë në dorë shumë sektorë të vendit. Sipas tij, tani ka ardhur koha që të hetohen krimet e komunizmit me qëllim që të rritet edhe siguria kombëtare. "Sot në Ditën Evropiane të Kujtimin të Viktimave të Nazizmit dhe Komunizmit, në Shqipëri shumë aktorë të regjimit më barbar stalinist të Evropës Lindore janë ende vendimmarrës në politikë, drejtësi, ekonomi, siguri, shoqëri! Hetimi i krimeve të komunizmit mbetet ende i ndaluar. Rezolutat e Këshillit të Evropës për Shqipërinë, ende të pa zbatuara! Prona private ende e konfiskuar! Hetimi i atyre krimeve, çështje e sigurisë kombëtare", deklaroi ditën e djeshme midis të tjerash ish-presidenti Bujar Nishani në statusin e tij në rrjetet sociale.

politike

www.sot.com.al

Beqiri dhe Koçi: Reforma në drejtësi histori sukcesi, SPAK do godasë pa dallim korrupsionin

Afrimi i SPAK, mazhoranca premtion rihapjen e dosjeve të bujshme, juristët tregojnë rrugët si do shkohet te "21 janari", Gërdeci e afera "Durrës-Kukës"

Rigels SELIMAN

Vjeshta duket se do të sjellë zhvillime të forta në skenën politike shqiptare.

Në fund të shtatorit, pritet që të hidhen themelet e SPAK, strukturës më të rëndësishme të reformës në drejtësi. Skeptikët janë të shumtë sa i takon rolin të saj, por zërat se SPAK do të sjellë tërmet në politikë nuk janë të paktë. Opozita po e sulmon çdo ditë reformën në drejtësi, por për socialistët dhe mazhorancën kjo reformë do të hedhë dritë për shumë çështje që janë propozuar prej vitësh. Gjatë një prononcimi për gazetën "SOT", zëvendësministri i Mbrojtjes, Petro Koçi shprehu bindjen se Struktura e Posaçme Anti-korrupsion do të godasë me zero tolerancë të korruptuarit në politikë. Në këtë kontekst, Koçi deklaroi se kulmin SPAK do ta arrijë kur të rihapë dosjet e bujshme si "21 janari", "Gërdeci" apo afera e Rrugës Durrës-Kukës, për të cilat theksoi se ka ardhur koha që të zbardhen dhe përgjegjësit të dalin para drejtësisë. Madje, numri 2 i Ministrisë së Mbrojtjes akuzoi PD-në dhe LSI-në se e sulmojnë qëllimisht reformën në drejtësi, në mënyrë që ajo të rrezohet dhe procesi i vetingut të mos flakë nga sistemi gjyqtarë dhe prokurorët e korruptuar, që sipas tij, janë në shërbim të këtyre dy partive. "Besoj se SPAK do të godasë pa dallim korrupsionin e çdo ngjyre. Këtë e beson edhe PD dhe LSI. Prandaj ata nuk lanë gur pa lëvizur kundër riformimit të sistemit të drejtësisë. Ata nuk hynë në zgjedhje dhe dogjën mandatet personale parlamentare me qëllimin e fshehur që të krijohej kaos politik e institucional, zgjidhja e të cilit do të përfshinte rrëzimin e reformës në drejtësi..."



Besoj se SPAK do të godasë pa dallim korrupsionin e çdo ngjyre. Këtë e beson edhe PD dhe LSI. Prandaj ata nuk lanë gur pa lëvizur kundër riformimit të sistemit të drejtësisë. Ata nuk hynë në zgjedhje dhe dogjën mandatet personale parlamentare me qëllimin e fshehur që të krijohej kaos politik e institucional, zgjidhja e të cilit do të përfshinte rrëzimin e reformës në drejtësi...

munguar. "Dosjet e bujshme duhet të rihapen nga SPAK. Çdo gjë duhet të rihapet. Kushdo që ka bërë shkelje, të dalë para drejtësisë. Nëse janë të rrezikuar, le t'ia lamë hetimit të plotë dhe të pandikuar", deklaroi Marto. Ndërkohë, deputeti socialist, Bujar Çela gjatë një prononcimi për gazetën "SOT" deklaroi dje se SPAK duhet të hapë dosjet e të korruptuarve, veprim ky që sipas tij, do t'i sillte dobi vendit në çdo aspekt. "Hapja dosjeve të ish-ave dhe atyre që janë në xhiro mbi kokën e fukarasë do të sillte shumë të mira që nga sekuestrimi i pasurive, deri në qilizmën që pret populli t'i bëhet këtij sistemi tejet të korruptuar në çdo qelizë", deklaroi Çela.

Beqiri: Ja rruga që do ndjekë SPAK

Por përveç socialistëve, pritshmëri të mëdha tek SPAK kanë edhe juristët. Gjatë një prononcimi për gazetën "SOT", avokat i njohur, Idajet Beqiri deklaroi se SPAK nuk është më një ëndërr, por një realiteti, i cili shumë shpejt do të çojë para drejtësisë gjithë të korruptuarit. "SPAK nuk është më një ëndërr në diell, por është një realitet që "de facto" ka kohë që e ka nisur punën e tij. Janë disa struk-

tura ndihmëse, të cilat nuk duan vota të Kuvendit për t'u miratuar, nuk duan as dhënie të pëlqimit të kreut të shtetit për t'u emëruar etj, etj, të cilat prej kohësh kanë përgatitur materialin bruto prej të cilit SPAK do të bëjë "ndarjen e grurit nga e gjëra" dhe do të dërgojë në gjyq gjithë zullumqarët e korruptuar të këtij vendi, të cilët gjatë këtyre 30 vjetëve i kanë katandisur Shqipërinë dhe shqiptarët në ditën më të zezë të jetës së tyre", deklaroi ai. Më tej, Beqiri shpjegoi edhe rrugën se si prokurorët e SPAK do të çojnë para drejtësisë të gjithë të korruptuarit. Sipas tij, edhe pse një pjesë e prokurorëve të SPAK kanë qenë pjesë e drejtësisë, ata tashmë kanë pësuar metamorfozë, pasi jovetëm që do të jenë "imunë" ndaj presioneve, por kanë edhe mbështetjen e SHBA-ve për të rivendosur drejtësinë e munguar në këto tre dekada në Shqipëri. "Skeptikët që thonë se, pikërisht këta prokurorë që do të jenë në SPAK, ishin në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, dhe siç bënë një vrimë në ujë atje, aq do të bëjnë edhe në kuadrin e SPAK, e kanë tërësisht gabim. Prokurorët e SPAK në vendimarrjen e tyre do të jenë të pavarur nga

krimi dhe nga kriminelët e pandëshkueshëm, por do jenë plotësisht të varur, e madje të varur prej gjuhe nga ligji, nga provat e pakontestueshme, nga drejtësia që kërkojnë shqiptarët. Ata janë të zbuluar tërësisht në veprimtarinë e tyre, çka do të thotë se transparenca do të jetë e atillë sa asgjë nuk do të zhvillohet dhe nuk do të veprojë dot më skutave të errta të politikanëve dhe të kriminelëve madhorë, të cilët me miliardat e korrupsionit të tyre i bënin edhe më zi nga ç'ishin këto skuta të errta. Vendimarrja transparente dhe maksimalisht ligjore e tyre do të kenë mbi kokë projektuesit, afruesit, modeluesit dhe garantuesit e SPAK, sikurse janë SHBA", nënvizoi Beqiri.

Frashëri: Me ndihmë e SHBA, SPAK do çrrënjosë korrupsionin

Optimizmin për SPAK dhe çuarjen para drejtësisë të gjithë të korruptuarve nuk e fshehu dje as avokat Kastriot Frashëri. Ky i fundit gjatë një prononcimi për gazetën "SOT" deklaroi se SPAK do të do çrrënjosë korrupsionin, pasi sipas tij, kjo strukturë mbështetet nga SHBA. "Sigurisht që në klimën politike me të cilën ka bashkëjetuar ky

BEQIRI: SPAK, "MAKTHI" I METËS DHE BERISHËS

Avokat i njohur, Idajet Beqiri deklaroi dje për gazetën "SOT" se: "Një mal me dosje rëndojnë mbi Berishën, Metën, Bashën, mbi familjarët e tyre, mbi shumë ish ministra e deputetë, mbi shumë prokurorë dhe gjyqtarë të lartë të shtetit. Presidenti Ilir Meta e ndjeu i pari "stuhinë" që do t'i zërë frymën në tetor, familjarët e Berishës, të afërmit në shërbim ndaj tij dhe vet Berisha gjithashtu! Ndaj ata ju vërsulen shtetit, institucioneve dhe gjithë faktorit ndërkombëtar që monitoron dhe mbikëqyr reformën në drejtësi me molotov dhe me përpjekje maksimale për destabilitetin e vendit, para se të mbërrijë tetori i zi për ta. Tashmë çdo ditë e më shumë po qartësohet dhe po bëhet e dukshme për çdo shqiptar se përpjekjet e tyre për destabilitetin e vendit janë donkishoteske. Stabiliteti i Shqipërisë është në duart e SHBA dhe të NATO. Ata duan një shtet ligjor në Shqipëri. Ata duan të "vrasin" përgjithmonë të pandëshkueshmit në këtë vend".

KOÇI: REFORMA NË DREJTËSI NUK DO TOLEROJË AS NJERËZIT E SAJ

Zëvendësministri i Mbrojtjes, Petro Koçi, teksa iu referua rastit të Maqedonisë së Veriut, ku kryeprokurorja speciale u vu në pranga, pasi dyshohet se është e përfshirë në një rast korrupsioni, shprehu dje bindjen se institucionet e reja të drejtësisë të dala nga reforma në drejtësi nuk kanë për të falur as zyrtarët e saj. "Thonë që arrestimi i prokurorës speciale në Maqedoninë e Veriut qenka dështim i reformës. Përkundrazi! Rastin e gjykoj se reforma nuk përzgjedh", nënvizoi dje Koçi gjatë një prononcimi për gazetën "SOT". Ndërkohë, deputeti i Partisë Socialiste, Bujar Çela gjatë një prononcimi për gazetën "SOT", deklaroi se SPAK duhet të rivendosë drejtësinë e munguar në vend, ndërsa e kundërta sipas tij, do të ishte një zhgënjim për të gjithë. "Ju jam prononcuar dhe herë të tjera që po të jetë se kjo strukturë se bashku me të gjitha hallkat e tjera të këtij sistemi nuk do sjellim jo vetëm tronditje, por dhe sekuestro të çdo qindarke të vjedhur të këtij populli, do ishte zhgënjim", deklaroi Çela.

FRASHËRI: TË KORRUPTUARIT PO LËVIZIN ÇDO GUR PËR TË PENGUAR REFORMËN

Avokat Kastriot Frashëri deklaroi dje gjatë një prononcimi për gazetën "SOT", se të korruptuarit nuk e duan reformën, ndërsa sipas tij, do të luajnë të gjithë gurët për ta penguar atë. "Ju e dini sa e vështirë ka qënë dhe është finalizimi i saj pasi jeni dëshmitarë të këtij tranzicioni të stërzgjatur ku rendi ligjor nuk është gjë tjetër vetëm një koncept abstrakt i shtetit ligjor që komandohet nga disa feudalë të përjetshëm dhe anarkia institucionale falë tyre ka sunduar shoqërinë tonë pasi krimi është instaluar në krye të institucioneve më të larta të shtetit, në politikëbërjen dhe në agjencitë e zbatimit të ligjit. Kjo gjendje e papranueshme na ka penguar edhe ne avokatëve të mbrojmë të drejtat ligjore të shtetasve të cilët falë disa gjyqtarëve dhe prokurorëve të korruptuar u kanë cënauar padrejtësisht qytetarëve të drejtat e tyre. Ndaj jam i sigurt se do të bëhen të gjitha përpjekjet nga këta kleptokratë të të gjitha ngjyrave që të bllokohet ngritja e shpejtë e institucioneve të reja të drejtësisë", deklaroi Frashëri.

vend përgjatë këtyre 30 vjetëve duket pak e pamundur formim i strukturave eficiente siç është SPAK apo BKH për të luftuar korrupsionin dhe për të vënë përpara drejtësisë të gjithë zyrtarët e lartë të shtetit të cilët kanë abuzuar me detyrën e tyre. Por Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Tiranë flet në emër të Departamentit të Shtetit dhe duke parë qëndrimin e saj të palëkundur këto vitet e

fundit për formalizimin e këtyre strukturave kam besim se diçka do të bëhet. Në fund të fundit kjo është edhe pritshmëria e mbarë popullit shqiptar. Në vlerësimin tim ky është shansi i fundit që Shqipëria të ndryshojë të ndahet nga e kaluara dhe të ecë e sigurtë drejt së ardhmes që në këtë vend më në fund të sundojë ligji dhe jo feudalizmi i politikanëve tanë kleptokratë", deklaroi Frashëri.

politike

Dosja "184", Petrit Vasili sulmon ndërkombëtarët dhe reformën në drejtësi, akuza të forta për Prelën dhe Markun

Nënkryetari i Lëvizjes Socialiste për Integritet, Petrit Vasili ka sulmuar ditën e djeshme reformën në drejtësi. Me anë të një statusi në Facebook, ai e ka cilësuar reformën si kapje të drejtësisë. Duke ju referuar ngërçit me dosjen "184", ai deklaroi se kjo tregon dështimin e reformës. "Këta flasin vetëm për "mrekullinë imagjinare" të reformës në drejtësi si e bukura e dheut të globit dhe "sukseset" e saj madhështore në shkretëtimin dhe shkatërrimin e drejtësisë. EURALIUSI mund të transferohet tash në Dibër.

Reforma e rilindjes ishte kapje e drejtësisë, pandëshkueshmëri dhe autostradë për kriminelët, kush nuk e sheh i plaçin sytë, kush e sheh dhe e fsheh pastë faqen e zezë. Goodbye reforma në drejtësi dhe udhë të mbarë për në Dibër", ka shkruar dje Vasili në Facebook. Vasili ndër të tjera ka ngritur një pyetje ky kërkun të dijë se pse nuk e hetuan dhe çuan përpara gjykatës Arta Marku dhe Donika Prella dosjen "184". "Varrosja e dosjes 184, e cila u mbajt e bllokuar për tre vjet dhe ku "peshqit e mëdhenj" kryem-

inistër, ministra, deputetët etj, që i mori vesh gjithë bota dhe u shpëtuan nga prokuroria në mënyrën më kriminale është demaskimi i plotë dhe pa alibi për reformën në drejtësi të rilindjes që zgjodhi Arta Markun me 69 vota. Po ministrat dhe deputetët Gjykata e Dibrës do t'i gjykojë? Po që do përgjigjen deri në një për shpërdorim detyre këta prokurorë a e dinë? Po që kanë përgjegjësi shumë të rëndë për mos-hetimin dhe mos-dënimin e krimit zgjedhor a e dinë? Po që nuk do t'i falë askush dhe toleranca për këta

shpërdorues detyre do jetë zero a e dinë?", pyet Vasili. Ndër të tjera Vasili ka dërguar një mesazh për ndërkombëtarët që kanë dalë në mbrojtje të reformës, ku sipas tij, tani nuk po flasin më dhe u shprehet se duhet të ketë reagim nga ana e tyre, pasi sipas tij, reforma është përpara një skandali të madh. "Pres të dëgjoj ndonjë opinion edhe nga këta duartrokitësit e mëdhenj në anglisht të reformës në drejtësi. Por, jo jo, këta janë memecë edhe përpara skandalit sa një mal", ka shkruar ndër të tjera Petrit Vasili.

Tendenat e Rosisë për rritjen e ndikimit gjeopolitik në Ballkan

Ndërkombëtarët japin alarmin, mos hapja e negociatave në tetor rrit rrezikun rus në Shqipëri e Maqedoninë e Veriut, Moska me sytë nga Ballkani

Arbjona ÇIBUKU

Rreziku rus për Shqipërinë dhe vendet e tjera të Ballkanit duket se po rritet nga dita në ditë. SHBA dhe shumë vende të tjera kanë dhënë alarmin në këtë aspekt duke sjellë jo pak raste dhe reagime të ashpra të Moskës. Në tetor Bashkimi Evropian do të vendosë nëse do të hapen apo jo negociatat me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Por një vendim negativ shihet si një rrezik për rritjen e kërcënimit rus. Revista "International Politics and Society", me seli në Gjermani e Bruksel dhe që është pjesë e fondacionit gjerman "Friedrich-Ebert-Stiftung", i ka kushuar një artikull kësaj çështjeje duke treguar rreziqet që i kanosen Ballkanit. Sipas saj, ndikimi i BE-së në Ballkan është duke u ulur pikërisht në një kohë kur rajoni ka nevojë për inkurajim në lidhje me perspektivat e saj evropiane. Revista ka kujtuar zhvillimin më të fundit në të cilin Rusia ka ndihmuar miken e saj më të madhe në rajon që është Serbia duke i siguruar mjete ushtarake. Kjo ka treguar se Rusia ka ende miq në Serbi dhe se kreu i Rosisë, Vladimir Putin është duke hedhur "grepin" drejt Ballkanit. "Brenda BE-së, ka shumë deklarata kontradiktore në lidhje me procesin e zgjerimit, të bëra nga zyrtarët kryesorë evropianë. Në këtë mënyrë, ajo fton Moskën të bëhet aktive në rajon dhe t'i largojë vendet e saj nga perspektiva e tyre evropiane. Udhëheqësit politikë të Ballkanit kanë mbetur të interpretojnë deklaratat e zyrtarëve evropianë, në varësi të rrethanave dhe zhvillimeve në vendet e tyre. Vetëm ky konfuzion hap derën për çdo lojtar tjetër gjeopolitik që të futet. Dhe kjo vjen në një kohë kur është e rëndësishme të pranohet se disa vende kanë bërë një rrugë të gjatë në përpjekjet e tyre për t'u bërë anëtarë të BE-së. Maqedonia e Veriut mori një ndryshim të emrit, duke zgjidhur argumentin tre-dekadash me Greqinë, për Shqipërinë, reforma të dhimbshme gjyqësore që tronditën sistemin politik në vend", shkruhet në revistë. Sipas artikullit, nëse BE vijon të ecë me këtë rritim mund të humbasë shumë dhe ndikimi rus të rritet në Ballkan. Revista shkruan se BE duhet të reagojë sa më shpejt në mënyrë që të fitojë

JA ALARMI I DHËNË NGA NATO E SHBA

Ndikimi rus në Ballkan ka vënë në alarm SHBA dhe NATO. Situata në rajon është përkeqësuar kohët e fundit dhe kjo ka bërë që dje komandanti i forcave të SHBA-së në Evropë dhe njëherësh komandant suprem i NATO, të raportojë pak ditë më parë në Senatit Amerikan. Duke folur në komitetin për Forca të Armatosura, Curtis M. Scaparrotti tha se afrimi i zgjedhjeve evropiane, tensionimi i situatës me protestat

në shtetet ballkanike si dhe rreziku i një konflikti të ri Kosovë-Serbi, po shton përpjekjet ruse për destabilizimin e rajonit. "Situata e sigurisë në Ballkan është shumë e brishtë dhe vendet e rajonit janë shënjestra kryesore të ndikimit malinj të Rosisë. Rusia e ushqen paqëndrueshmërinë rajonale në përpjekje për të parandaluar vendet e Ballkanit në përparimin e tyre drejt integritimit euroatlantik", tha ai.

Revista ka kujtuar zhvillimin më të fundit në të cilin Rusia ka ndihmuar miken e saj më të madhe në rajon që është Serbia duke i siguruar mjete ushtarake. Kjo ka treguar se Rusia ka ende miq në Serbi dhe se kreu i Rosisë, Vladimir Putin është duke hedhur "grepin" drejt Ballkanit...

The EU's failure in the Balkans

Two months ago, the EU Council decided not to follow the European Commission's recommendation for opening accession talks with North Macedonia and Albania. The Council postponed the decision for later this year, amid a current political turmoil in Albania, and a tense political summer in North Macedonia.

French President Emmanuel Macron is the most vocal when it comes to the future of the enlargement process. He claims that the EU first needs to implement deep reforms and then focus on new members. While there are arguments that support Macron's claim, the decision was not taken lightly by the Balkan countries. And while Brussels' overall message didn't sound encouraging for the Balkans, it was like music to Russia's ears and its role in the region.

In the case of North Macedonia and its impending effort to join NATO until the end of the year, it's clear why the country would become a target for Russian propaganda. Last year, Greece expelled two Russian diplomats, accusing Moscow of trying to interfere in the historic name agreement with its northern neighbor. The name deal later became the main driving force behind the country's NATO accession and beginning the accession talks with the EU. In the case of Albania, the country has been a NATO member for more than a decade, having joined the Alliance in 2008.

Lëvizjet e rusëve në Ballkan

"Gjatë muajit të kaluar, dy humoristë rus të njohur si Vovan dhe Lexus lëshuan një audio regjistrim një orë të gjatë me disa telefonata marramendëse me kryeministrin maqedonas Zoran Zaev. Në bisedë, humoristët mashtruan liderin e Maqedonisë së Veriut duke besuar se po fliste me ish-Presidentin e Ukrainës Petro Poroshenko dhe Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s

Jens Stoltenberg. Kryeministri maqedonas pohoi se Rusia dhe Turqia ishin prapa idesë së ndarjes dhe shkëmbimit të territoreve midis Serbisë dhe Kosovës. Koha dhe koha përsëri gjatë thirrjeve telefonike, Zaev gjithashtu pranoi se Presidenti rus Vladimir Putin kishte kontroll të drejtpërdrejtë ndaj homologut të tij serb Aleksandër Vučić", deklaroi revista "International Politics and Society".

Moska dhe përpjekjet e përsëritura ruse për të minuar vlerat evropiane në rajon", ka shkruar revista "International Politics and Society".

Dështimi i BE-së në Ballkan

Kujtojmë se para dy muajsh Këshilli i BE vendosi të mos ndiqte rekomandimet e Komisionit Evropian për hapjen e bisedimeve të pranimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë. Kjo ndodhi për shkak të

trazirave politike që ndodhën në Shqipëri dhe në Maqedoninë e Veriut, kësaj Këshilli e shtyu vendimin për më vonë këtë vit. Siç shprehet edhe revista, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kanë investuar shumë përpjekje në integrimin e tyre në BE. Fillimi i bisedimeve për hapjen e negociatave u cilësua si një fitore e madhe për Tiranën dhe Shkupin. Revista ka theksuar se diskursi dhe vendosmëria e palëkundur e rajonit ndaj BE-së dhe NATO-s ka acaruar Moskën në të kaluarën. "Rasti më i dukshëm ishte anëtarësimi i Malit të Zi në NATO dhe përpjekja e dështuar për grusht shteti në tetor 2016. Në maj të këtij viti, gjykata malazeze dha dënime me pesë vjet burg për dy politikanë të opozitës pro-ruse për përfshirjen e tyre në konflikt", thuhet në shkrim. Fill pas këtyre ngjarjeve Putin ka nisur të provojë forma të ndryshme për rritjen e ndikimit gjeopolitik në Ballkan.

Gramoz Ruçi vlerëson Luftën Nacional Çlirimtare

Kryetari i Kuvendit Ruçi ditën e djeshme ishte i pranishëm në festën e Çlirimit të Dibrës dhe krijimit të Brigadës XVIII, ku kujtoi dëshmoren 17-vjeçare, heroinën e dy popujve. Ruçi e ka cilësuar vajzën 17 vjeçare si heroinë të popullit shqiptar dhe maqedonas që sipas tij tregon qartë rrënjët e miqësisë, që zhvillojnë respektin tonë të ndërsjelltë për komunitetet dhe grupet etnike si dhe aspiratën e përbashkët për t'u bashkuar familjes evropiane. "Lufta kundër nazi-fashizmit e tradhtarëve të atdheut nisi si një rezistencë popullore dhe çlirimi i Shqipërisë u kurorëzua me fitoren e një ushtrie të rregullt, me brigada, divizione e korpamata. Idetë, ndjenjat dhe rezistenca antifashiste e popullit shqiptar nuk do të kishin çliruar Shqipërinë të vetme, pa krijimin dhe betejat e përgjakshme të Ushtrisë partizane, këtij uragani luftarak antifashist dhe çlirimtar", ka deklaruar dje Ruçi. Vajza 17 vjeçare që tashmë përkujtohet si heroinë ishte Hibe Palikuqi e cila vdiq në 23 shtator 1944.

Manjani: Prokuroria nën urdhrat e politikës

Ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani ka reaguar ditën e djeshme pas vendimit të Prokurorisë së Krimeve të rënda e cila shpalli moskompetencë në lidhje me dosjen 184, që për Manjanin fjala "moskompetencë" është fjala e duhur dhe që tregon fytyrën e vërtetë të prokurorisë. Dosja 184 është transferuar në Dibër për hetim dhe ky vendim është shoqëruar ditën e djeshme me shumë reagime nga opozita të cilët nuk i kanë kursyer sulmet e ashpra. "Fjala e duhur që Prokuroria e përdor për veten është "moskompetencë". Fiks, po fare fik! Kompetencë do të thotë, para së gjithash, këllqë. Prokuroria e thotë vetë që: Nuk i ka! Ama kush proteston e ngre zërin kundër hajnave të votave, pushtetit e produkteve të tij, e ha. Aty po, shkëlqen prokuroria e cila është e gjitha nën varësinë e policisë politike", ka shkruar dje Manjani. Më tej ai ka vijuar reagimin e tij duke ironizuar prokurorinë, pasi sipas tij ajo nuk është kompetente dhe akuzon se asnjë i arrestuar për politikë nuk ka përfunduar i dënuar.

politike

www.sot.com.al

Ilir Meta mesazh Ramës: Nuk mund të ketë më diktaturë, duhet të përballemi me të kaluarën që të mos rikthehet

Presidenti Ilir Meta i ka dërguar dje një mesazh në distancë kryeministrit Edi Rama. Duke përkujtuar Ditën Europiane të Kujtimit të Viktimit të Stalinizmit dhe Nazizmit, Meta deklaroi se nuk mund të ketë më kthim pas. Nëse kujtojmë deklaratat e mëparshme të Metës, ai ka akuzuar shpesh qeverinë se po kap të gjitha pushtetet, njësoj si në diktaturë. “Kujtimi i së shkuarës, të vërtetat e dhimbshme të mizorisë dhe shëmtisë së diktaturës komuniste janë një barë ndërgjegje e madhe për të gjithë ne. Disidencat shqiptare

meriton jo vetëm të kujtohet, të shkruhet e të plotësohet, por edhe të nderohet me të gjithë respektin që meriton. Përballja serioze me të kaluarën, trajtimi i saj me transparencë e drejtësi, uniteti shoqëror, paqja dhe mirëkuptimi social, do të na ndihmojnë, jo vetëm për të mos harruar tragjeditë e së shkuarës por edhe për t’u çliruar nga makthi i rikthimit të çdo forme diktature apo tendence despotike të qeverisjes. Për të bërë atë që është më e mira që çdo shqiptar të gëzojë jetën, lumturinë, të drejtat dhe liritë e tij si çdo qytetar

evropian, i pashantazhuar nga kontrolli politik, frika e varfëria”, ka deklaruar Meta. Sipas presidentit, ka ardhur koha që gjeneratat që do vijnë të mësojnë nga e kaluara, në mënyrë që ajo të mos ripërsëritet. Këtu duket se kreu i shteti ka dërguar mesazhe të koduara për kryeministrin. “Sot ne përkujtojmë Ditën Europiane të Kujtimit të Viktimit të Stalinizmit dhe Nazizmit, dy ideologjive shkatërrimtare të shekullit të kaluar, që shkakton mijëra viktima të pafajshme edhe në vendin tonë. Për 45-vite me radhë, Shqipëria u shndërrua në

Korenë e Veriut të Evropës. Me mijëra shqiptarë u vranë, u burgosën dhe u internuan. Liria, të drejtat e njeriut, demokracia e pluralizmi ishin vlerat tek të cilat ata besonin dhe për të cilat sakrifikuuan edhe jetën e tyre. Është detyra jonë t’u mësojmë gjeneratave të reja të vërtetën e të kaluarës tonë të afërt, me qëllim që ajo të mos përsëritet më. Për të mos i vrarë edhe për një herë të dytë ata që sakrifikuuan jetën dhe rininë e tyre, që ne dhe brezat e ardhshëm të jetonim të lirë në një vend tërësisht demokratik”, tha ai.

Meta ngjashmëri të jashtëzakonshme me presidentin rus

Putin frymëzim për Ilir Metën, presidenti udhëtime në male njësoj si homologu rus, ja faktet që tregojnë lidhjet tij me Moskën



Kliti TOPALLI

Zbulohet personi i cili frymëzon presidentin Ilir Meta. Në një intervistë që ka dhënë për mediat ruse një vit më parë, ai tha se frymëzohet nga shkrimtarët rusë, por duket se frymëzimi i tij më i madh vjen nga drejtuesi i Rusisë. Shtëpia në “Gjirin e Lalëzit” duket se ja ka hequr dëshirën e detit presidentit, i cili prej disa vitesh ka vendosur që të udhëtojë nëpër male, të lahet në liqene akullnajore, të vizitojë shpella e të takohet me barinj të zonës. Por këto lëvizje të presidentit Meta duket se nuk janë të panjohura. Të njëjtën gjë si ai bën dhe presidenti rus, Vladimir Putin. Mjafton të bësh një kërkim të thjeshtë në Facebook-un e presidentit Ilir Meta dhe në Google për Putin dhe ngjashmëria e tyre është e frikshme. Putin prej vitesh ka ngjitur malet dhe bente foto gjysmë i zhveshur duke treguar muskujt e tij. Ndërsa së fundmi kemi parë dhe Metën të bëjë të njëjtën gjë, edhe pse nuk është aq në formë sa presidenti rus. Edhe pse mund të duket pa kuptim, por janë dhjetëra foto që tregojnë veprime të njëjta të tyre. Pyetja që shtrohet është nëse presidenti Meta frymëzohet dhe për gjëra të tjera nga presidenti rus? Afekcioni i Metës për rusët është i dukshëm. Është i vetmi politikan që nuk është sulmuar nga ambasada ruse. Madje kur u pyet nga mediat mbi rrezikun rus, presidenti u shpreh se Shqipëria është kthyer pas në kohën kur komunizmi fliste për rrezikun që vinte nga SHBA. Edhe pse agjenci të ndryshme ndërkombëtare kanë shprehur prej kohësh se rreziku rus është i pranishëm në Ballkan dhe Shqipëri, për presidentin gjithçka duket si lojë. Pra përveç letërsisë ruse, po dalin dhe elemente të tjerë që lidhin Metën me Moskën. Nëse i numërojmë të gjithë, rezulton se është politikan i më shumë mbështetje prej tyre. Nga investigimi që u bë nga një prej revistave të njohura amerikane, rezultoi se dhe LSI, ashtu si PD, ka bërë lobime në administratën amerikane përmes parave ruse. Luan Rama është i vetmi politikan që ka bërë foto me Vladimir Putin. Meta është i vetmi politikan i lartë që ka dhënë intervistë në një prej televizioneve të mëdha ruse. Pastaj, ajo që i vë kapak gjithçkaje është se mediat ruse i bëjnë jehonë çdo lëvizjeje të presidentit. Edhe një status që bën Meta në rrjetet sociale, pasqyrohet në portalet ruse. Pra faktet që tregojnë

META E LSI LOBIME NË SHBA PËRMES RUSËVE

Revista amerikane "Mother Jones" përmes një investigimi tregoi kohë më parë se LSI dhe Ilir Meta, kanë lobuar në SHBA përmes personave të dyshimtë nga Rusia. “Doli se Dorelita ishte një kompani guaskë e që kishte vetëm një qëllim: të jepte pagesën për lobimin që McKeon do të bënte për LSI-në. Firma u inkorporua në vitin 2013 nga një avokat grek, i quajtur Andreas Petrou. Ai ka një zyrë të vogël ligjore në kryeqytetin e Qipros, e cila krijon dhe administron kompani guaskë. Një e treta e

klientëve të kësaj firme janë rusë, dhe madje kompania ka reklama një numër enkas për klientët që flasin rusisht. Sipas regjistrimeve të bizneseve ruse dhe qipriote, firma e Petrou ishte e përfshirë me kompani me bazë në Qipro, të lidhura me Oleg Deripaskan, manjatin rus të biznesit të aluminit, i cili është përfshirë në skandalin e lidhjeve ruse të presidentit Trump për shkak të bizneseve që ka pasur me Paul Manafort, kreun e fushatës së Trump-it që është nën hetim”, thuhej në artikull.



se mbi Presidencë po fryn era ruse po shtohen nga dita në ditë.

Meta në "luftë" me SHBA

Teksa gëzon mbështetjen ruse, Presidenti ka nisur një sulm të paparë ndaj reformës në drejtësi dhe ndërkombëtarëve. Edhe pse reforma ka 3 vite që është miratuar, presidenti tani e ka gjetur kohën për të lëshuar sulme dhe akuza ndaj saj. Por Meta ka marrë përgjigje shumë të forta nga SHBA. Më i fundit ishte Ndihmës Sekretari Amerikan i Shtetit Philip Reeker, i cili në një takim me ministrin në detyrë Gent Cakaj, deklaroi se reforma në drejtësi nuk ka kthim pas. “Shtetet e Bashkuara të Amerikës konsiderojnë se reforma në drejtësi s’mund të jetë subjekt i asnjë kompromisi dhe ajo përbën një model për rajonin dhe përtej”, tha Cakaj. Pra, duket qartë se kemi një luftë mes Metës dhe amerikanëve. Plani i presidentit

Luan Rama foto me Putin

Ilir Meta dhe partia e tij kanë kthyer sytë nga Rusia prej disa vitesh. Disfata që pësoi në zgjedhje LSI ishte një goditje mjaft e fortë, pasojat e sa cilës u rritën nga dita në ditë dhe për këtë arsye partia e presidentit hodhi sytë nga Rusia. Rama vendosi në 2017 të shkrijë LSI duke i marrë të gjithë elektoratin dhe kjo vuri në alarm të gjithë krerët e saj. Pakti Rama-Basha pa praninë e Ilir Metës u iniciua nga SHBA dhe sinjali i atëhershëm ishte i qartë për LSI. Kjo bëri që shpresa e vetme e Metës dhe

njerëzve të tij të jetë Moska. Në tetor 2017 nënkryetari i kësaj partie, Luan Rama, zhvilloi një vizitë në Rusi, në kuadër të Asamblesë së Përgjithshme të Unionit Ndërrparlamentar. Por ajo që ra në sy është se Luan Rama në rrjetet sociale postoi një foto me Presidentin rus Vladimir Putin, shoqëruar me mbishkrimin: “Shën Petërsburg: me Presidentin e Federatës Ruse, Vladimir Vladimiroviç Putin, në qytetin e tij të lindjes, pas seancës solemne të Asamblesë së Përgjithshme të Unionit Ndërrparlamentar”.

ishte që ta nxjerrë reformën në drejtësi si një projekt të Soros dhe jo të amerikanëve. Dihet rivaliteti mes presidentit Donald Trump dhe Soros. Presidenti Meta mendoi se do fitonte simpatinë e

administratës së Trump me këtë lëvizje, por duket se ka dështuar. Si Matthew Palmer ashtu dhe Reeker i kanë dalë hapur, të cilët janë po përfaqësues të administratës së Trump.

Zjarret, Meta në sulm ndaj qeverisë

Presidentit Ilir Meta duket se nuk heq dorë për të shfrytëzuar gjithçka për të sulmuar qeverinë. Dje ai ka reaguar dhe për situatën zjarreve duke kërkuar më shumë masa. Në një njoftim të Presidencës thuhet se Presidenti Meta është duke ndjekur me shumë shqetësim situatën aktuale të shkakuar nga përhapja masive e zjarreve në disa qarqe të vendit, veçanërisht në Gjirokastër dhe Lezhë. Presidenti Meta inkurajon personelin e Forcave të Armatosura dhe të Ministrisë së Brendshme, njësitë e Emergjencave Civile, si dhe drejtuesit e pushtetit vendor në këto qarqe, për marrjen e menjëhershme të të gjitha masave efektive të emergjencës, për të neutralizuar vatrat e zjarrit dhe për t’u ndodhur pranë qytetarëve të cilët mund të rrezikohen nga përhapja masive e tyre. Presidenti Meta duke theksuar rëndësinë e ruajtjes së mjedisit dhe të natyrës, u bën thirrje dhe nxit institucionalisht autoritetet qendrore e vendore, për koordinimin në kohë, me qëllimin përbalimin me efektivitet të situatës.

Shqipëri-Danimarkë, bashkëpunim mes organeve ligjvënëse

Bashkëpunimi sa më i ngushtë mes organeve ligjvënëse të Shqipërisë dhe Danimarkës ishte në qendër të seminarit të zhvilluar gjatë kësaj jave në Kopenhagë, ku morën pjesë zyrtarë të lartë të Shërbimeve të Parlamentit të Danimarkës (Folketinget) dhe të Kuvendit të Shqipërisë. Seminarin u përqendrua në çështje të lidhura me zhvillimin e burimeve njerëzore dhe shkëmbimin e përvojave më të mira në këtë fushë, por gjatë tij u fol edhe për vendosjen e një bashkëpunimi sa më të ngushtë mes organeve ligjvënëse të të dyja vendeve. Një plan veprimi më i hollësishëm për këtë qëllim do të hartohet në vjeshtë pas takimeve që do të mbajnë zyrtarët e parlamenteve të të dyja vendeve. Vizita e zyrtarëve të lartë të Shërbimeve të Kuvendit të Shqipërisë në Danimarkë dhe seminarin i mbajtur atje u mbështetën nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe u zhvilluan në kuadrin e projektit “Mbështetje për parlamentin dhe edukimin qytetar”, i cili zbatohet nga Prezenca, me fonde zvicerane.

politike

Lulzim Basha: Kur të vijmë në pushtet do ndalojmë simbolet komuniste dhe nderimin e xhelatëve të diktaturës

Kreu demokrat Lulzim Basha ka premtuar se PD do propozojë ndalimin e simboleve të komunizmit dhe nderimin për xhelatët e diktaturës. Demokrati ka reaguar në kuadër të Ditës Evropiane e Kujtimit të viktimave të sistemeve totalitare. Basha është shprehur se kur Partia Demokratike të vijë në pushtet do të votojë në Parlament me votë të lirë disa akte që lidhen me periudhën 45 vjeçare të drejtuar nga diktatori Enver Hoxha. Këto akte janë: Ndalimin dhe kriminalizimin e simboleve të komunizmit, dhe nderimin për xhelatët e dik-

taturës, që kanë për qëllim të fshijnë çdo kujtesë të sakrificës dhe rezistencës për liri. Ndalimin e nderimit të viktimave të komunizmit, për të sprapsur revanshin komunist, i cili u rilind dhe u materializua, me vendimin kriminal për të hequr dhe kufizuar dëmshpërblimin për pasardhësit e të ekzekutuarve. Angazhimin ligjor dhe financiar për gjetjen dhe nderimin e të ekzekutuarve pa gjyq që sot janë pa varr dhe eshtrat e të cilëve nuk gjenden. Ndër të tjera Basha nuk ka lënë pa përmendur edhe kryeministrin e vendit Edi Rama,

të cilin e ka akuzuar se ka kthyer policinë politike, prokurorinë dhe drejtësinë private dhe burgosjet dhe gjyqet politike. "Kjo e keqe do të ndalet me çdo kusht e me çdo çmim dhe shqiptarët e bashkuar do ta fitojnë betejën për vlerat themelore të demokracisë, votën e lirë, dhe nderimin e trajtimit dinjitoz të të përndjekurve politikë dhe të gjithë shqiptarëve të ndershëm", ka deklaruar dje Basha. Në fillim të fjalës së tij ai ka kujtuar viktimat duke thënë se sipas tij nuk ka paguar askush më shumë se sa shqiptarët nga regjimet totalitare.

"Krimi komunist shqiptar është krimi më i rëndë komunist në Evropë, por akoma më e rëndë se ky krim, është zhdukja e gjurmëve të krimit. Mosgjetja e eshtrave të mbi 4500 të ekzekutuarve me dhe pa gjyq, ka në themel kompleksin e xhelatëve, për të zhdukur bashkë me kundërshtarët e tyre politikë, edhe gjurmët e krimit të tyre", ka thënë ndër të tjera Basha. Kreu i demokratëve ka deklaruar në emër të PD-së se shpreh ndjesën e tij për pamundësinë për të bërë diçka për nderimin e sakrificës së të përndjekurve politikë.

PD: Kajmaku të japë dorëheqjen, i dënua për vepra të rënda

Dekriminalizimi, Prokuroria nis verifikimet për Kajmakun, Partia Demokratike hetime paralele për katër kryebashkiakët e tjerë

Arbjona ÇIBUKU

Prokurori ka nisur verifikimet për kryebashkiakun e Vorës Agim Kajmakun, pas akuzave të PD se ka qenë i dënua në Greqi. Sipas burimeve, pritet që të merren shenjat e gishtave për Kajmakun në mënyrë që të verifikohet nga "Interpol Athina" nëse është apo jo i dënua në Greqi. Sipas burimeve, PD do të presë konkluzionet e Prokurorisë ndërkohë që po kryen verifikime paralele për katër emra të tjerë. Një burim në PD i tha gazetës se bëhet fjalë për 4 kryebashkiakët të cilët po ashtu dyshohet se janë të dënua jashtë vendit. Ashtu siç ndodhi me Valdrin Pjetrin, PD ka nisur tentativat për të gjetur vendimin e dënimit për Kajmakun, por dhe për emrat e tjerë. Vetë Lulzim Basha e bëri të qartë se dekriminalizimi do të jetë beteja e radhës e PD-së, pasi sipas demokratëve, shumë kryebashkiakë rezultojnë të dënua apo të dëbuar nga shtete të huaja.

Reagon PD

Partia Demokratike ka reaguar sërish ditën e djeshme për Kajmakun. Në një deklaratë për mediat Sekretari për Çështjet Ligjore në PD, Çlirim Gjata ka ritheksoar se Kajmaku ka qenë i dënua dhe dëbuar nga Greqia. Ndër të tjera ai i ka kërkuar kryeministrin të vendit Edi Rama që të reagojë duke dhënë sqarime në lidhje me Kajmakun, ndërkohë që i ka kërkuar këtij të fundit të japë dorëheqjen. "Valdrin Pjetri, kandidati trafikant i Ramës dhe Doshit, nuk është rast i izoluar. Një pjesë e kandidatëve të Ramës kanë probleme me drejtësinë, për shkak të së shkuarës kriminale apo të lidhjeve me krimin. Rama i promovon dhe iu jep mbështetje. Rama e di që dhe Agim Kajmaku i Vorës ka probleme me drejtësinë. Ai duhet të japë menjëherë dorëheqjen. Rama dhe Balluku e dinë se ai ka probleme me drejtësinë greke. Rama po përpiqet të blejë kohë për kriminelin tjetër që i është zbuluar. A është dënua, dëbuar, arrestuar dhe shpallur në kërkim në Greqi për vepra të rënda penale dhe a e ka fshehur këtë Agim Kajmaku? Ata duhet t'i thonë shqiptarëve të vërtetën. Do ketë vetëm një

BASHA: RAMA ISHTE NË DIJENI TË RASTIT TË KAJMAKUT



"Rasti i Agim Kajmakut, një tjetër individ me precedentë penalë në Greqi, që Rama dhe persona të tjerë përgjegjës në kupolën e lartë socialiste kanë pasur dijeni të plotë. Edhe ai ka mohuar precedentin penal në shtetin fqinj, fakti është se ai është një person me precedent penal të hapur me drejtësinë greke. Ky fakt dihet nga Edi Rama, i komunikuar atij nga partnerët

ndërkombëtarë dhe ai ka zgjedhur ta kandidojë për Bashkinë e Vorës. Sa të tjerë nga këta kryebashkiakë janë me precedentë penalë? A nuk është kjo një provë se kriza politika dhe kushtetuese ka një burim, kriminalizimin e plotë të politikës me Edi Ramën në krye. Ai nuk përfaqëson më interesat e socialistëve, por të kriminelëve", ka deklaruar ditë më parë Basha.



PD KËRKON VERIFIKIM PËR KAJMAKUN

"Nisur nga interesi i lartë publik që paraqet kjo çështje, Partia Demokratike e Shqipërisë pret një verifikim dhe reagim institucional të shpejtë nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme, me synimin që të arrihet qëllimin primar që ka ligji i dekriminalizimit. Konkretisht, qëllimi i ligjit është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore,

përfundim", ka thënë për mediat Gjata. Gjatë fjalës së tij, Gjata ka përmendur largimin e Ramës, pasi ky i fundit cilësohet nga blutë si kryeministri që ka vetëm një ofertë për qytetarët: krimin dhe hajdutërinë. "Pse Edi Rama dhe Belinda Balluku vendosën veton duke shpërfillur PS të Vorës, kur socialistët protestuan para 30 qershorit për kryebashkiakun me probleme të Ramës dhe Ballukut? Strategjia

e Edi Ramës për të mbrojtur Agim Kajmakun me betimin se ai as nuk është i dënua, as nuk është i dëbuar nga Greqia nuk ka asnjë vlerë. Ajo është një strategji e dështuar, që do të ketë vetëm një përfundim: Edi Rama do të largohet me turp si kryeministri i cili ka vetëm një ofertë për qytetarët: krimin dhe hajdutërinë", ka thënë dje Gjata. Ndërkohë kujtojmë se ditën e djeshme kryebashkiaku i Vorës që

u akuzua nga Partia Demokratike nuk i ka pranuar akuzat dhe i ka mohuar kategorikisht ato. Madje Kajmaku i ka paraprirë këtyre akuzave pasi ditë më parë ai kishte postuar në profilin e tij në Facebook një shpjegim ku shkruante se e dinte që në një moment PD do e sulmonte. Kajmaku i ka quajtur akuzat e ardhura nga demokratët si sulm politik që i bëhet atij duke vijuar të mos i pranojë ato.

Balla i përgjigjet opozitës për HEC-ët në Holtë

Kreu i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla i është përgjigjur akuzave të PD-së që sipas të cilave investitori i HEC-it ishte mik i Ballës. Taulant Balla ka postuar dje një video ku tregon se ky HEC po prishet dhe ndërkohë i është kundërpërgjigjur akuzave të ardhura nga Partia Demokratike. "Fillon prishja e digës së HEC pranë kanionit të Holtës. Si thanë gojëprishurit e opozitës rrugore dhe organi i tyre zyrtar RD që investitori është mik i Taulant Ballës?!" - shkruan Balla, bashkëngjitur videos në Facebook, nga prishja e digës së HEC në kanionin e Holtës. Diga e betonit pranë kanionit të Holtës e cila u prish dje, ishte parashikuar për t'u bërë hidrocentral. Këtë janar u anulua leja për ndërtimin e këtij HEC-i, ndërsa dje nisi shembja e digës së ndërtuar në dalje të kanionit. Kryebashkiaku i Gramshit Klodian Taçe ka reaguar duke thënë se ka ikur koha kur vendi përbuzej dhe pasuritë e shumta natyrore përdoren për përfitime personale të një grupi të caktuar personash.

Jep dorëheqjen kryetari i Këshillit Bashkiak Shkodër

Kryetari i Këshillit Bashkiak Shkodër Suel Hadri ka dhënë dorëheqjen ditën e djeshme, ky vendim i tij vjen vetëm disa ditë pasi u bë konstituimi i këshillit bashkiak. Suel Hadri ka nisur një shkresë drejtuar Këshillit Bashkiak Shkodër dhe kryebashkiakes në detyrë Voltana Ademi, ku ka njoftuar se do të japë dorëheqjen për arsye personale. "Unë Suel Hadri me funksion sekretar i Këshillit Bashkiak Shkodër, ju njoftoj se, për arsye të mia personale, jap dorëheqjen nga funksioni i sekretarit të Këshillit Bashkiak Shkodër", shkruhet në letrën që ka dërguar Hadri. Siç duket Hadri nuk i bën me dije arsyet e largimit të tij por kujtojmë se Hadri nuk pranoi të drejtonte mbledhjen në konstituimin e këshillit të ri bashkiak të përbërë nga socialistët. Edhe pse dorëheqja e tij është dhënë për raste personale, dyshimet janë se demokratët po largohen për shkak se fati i Bashkisë Shkodër nuk dihet si do shkojë. Ndërkohë, gazeta ka mësuar se në bashkitë e tjera shumë po kalojnë me PS.

politike

www.sot.com.al

I nxehti rikthen zjarret në vend, zjarrfikësit betejë me flakët në Shëngjin, probleme dhe në disa zona në jug

I nxehti i gushtit ka rikthyer vatrat e zjarreve në vend. Ashtu si çdo vit, në disa zona kanë shpërthyer flakët, duke bërë që të dalin në terren me qindra forca zjarrfikëse. Në Shëngjin situata ka qenë më kritike. Që të enjten mbrëma kanë nisur flakët në një masiv shkurresh e dru-rësh dhe kanë vijuar edhe dje, duke mbërritur deri në afërsi të portit. Kështu janë rrezikuar varrezat e qytetit, por edhe banesat e bizneset që operojnë në zonën pranë malit. Banorët e Shëngjinit thonë se ndihen të rrezikuar nga zjarri, teksa thonë se kjo situatë po ndikon edhe

në largimin e pushuesve nga kjo zonë turistike. Që prej momentit të rënies në zjarrin në zonë kanë mbërritur forcat zjarrfikëse, shërbimi pyjor dhe ushtria. Ata po punojnë për mbajtjen nën kontroll të flakëve të cilët rrezikojnë zonën e banuar. Zjarri vijon me intensitet të lartë, ndërsa deri më tani janë djegur një sipërfaqe e konsiderueshme me shkurre dhe pisha. Një zjarr i madh u shfaq dje edhe në masivin pyjor me pishë në fshatin Patin të Bashkisë së Klosit. Vatra e zjarrit u përhap me shpejtësi për shkak të erës. Të parët që kanë nisur ndërhyrjen për

shuarjen e flakëve kanë qenë banorët të zonës. Zjarrfikësit detyrë kryesore kishin mbrojtjen e banesave dhe atje kanë vendosur edhe një automjet. Pas disa orësh, flakët janë vënë nën kontroll. Një zjarr i përmasave të mëdha ka djegur edhe një territor kullote mbi malin e Shëndëllisë në kufirin mes Bashkisë së Memaliajt dhe asaj të Tepelenës. Zjarri që ndodhet në lartësinë 1300 metra ka shpërthyer disa predha të Luftës së Dytë Botërore, por pa rrezik për popullsinë. Sipas kreut të zjarrfikëseve në Tepelenë, Veleđin Abazi zjarri vetëm po mbahet në mbikëqyrje

në distancë sepse ndodhet shumë larg zonave të banuara. Zjarri aktualisht po përparon në lartësinë e malit mes Damësit dhe Beçishtit, mbi fshatin Malas i braktisur kohë më parë. Dje Tirana u solidarizua me Shëngjinin dhe Bashkinë e Lezhës për të përballuar situatën e vështirë të shkaktuar nga zjarri masiv që kanë përfshirë pyllin me pisha në afërsi të portit. Bashkia Tirane nisur pikërisht nga situata shqetësuese në terren ka nisur zjarrfikëset e saj për t'i ardhur ndihmë mjeteve të tjera të bashkisë Lezhë dhe Emergjencave Civile që po luftojnë me flakët.

Dekriminalizimi, zbardhen shifrat e Prokurorisë së Përgjithshme

Zbardhet raporti i dekriminalizimit, 39 funksionarë të lartë rezultojnë të dënuar, 31 nën hetim për falsifikim të të dhënave

Rigels SELIMAN

Përveç Valdrin Pjetrit, duket se edhe shumë emra të tjerë rezultojnë në shkelje të ligjit të dekriminalizimit. Partia Demokratike detyroi kandidatin e Partisë Socialiste në Shkodër që të refuzojë mandatin e kryebashkiakut, ndërsa gazeta ka mësuar se ka pasur edhe raste të ngjashme, sidomos në administratë. Gazeta ka siguruar raportin vjetor të Prokurorisë së Përgjithshme, sa i takon bilancit të dekriminalizimit, ku rezulton se gjatë vitit 2018 janë gjetur me probleme plot 39 funksionarë. Sipas asaj që thuhet në raport, funksionarët e lartë rezultojnë se kanë qenë të dënuar. "Për 39 subjekte, Sektori i Verifikimit të Integritetit në Prokurorinë e Përgjithshme ka vendosur se përfshihen në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit 138/2015 si dhe Vendimit të Kuvendit Nr. 17/2016. Për 8 subjekte ose 20.5 % të rasteve, përfshihen në fushën e veprimit të nenit 2, pika 1, germa a) të ligjit 138/2015. "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; Për 1 subjekt ose 2.5 % të rasteve, përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, pika 1, germa b) të ligjit 138/2015; Për 8 subjekte ose 18 % të rasteve, përfshihen në fushën e veprimit të nenit 2, pika 1, germa c) të ligjit 138/2015; Për 14 subjekte ose 36 % e rasteve, përfshihen në fushën e veprimit të nenit 2, pika 1, germa c) të ligjit 138/2015; Për 8 subjekte ose 20.5 % të rasteve, përfshihen në fushën e veprimit të të Vendimit Nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë për arsye të mosdeklarimit të të dhënave në lidhje me dënimet penale", thuhet në raport.

31 nën hetim për falsifikim të të dhënave

Në raportin vjetor të Prokurorisë së Përgjithshme, sa i takon bilancit të dekriminalizimit thuhet më tej se janë plot 31 funksionarë të lartë që janë nën hetim për falsifikim të të dhënave. Sipas raportit të siguruar nga gazeta, në sitë në total kanë hyrë 147 persona për verifikim, ku për 31 zyrtarë materialet janë referuar në prokurori. "Nga 147 vendime "Për miratimin e rezultateve të verifikimit" të cilat ju janë njoftuar institucioneve përkatëse, 31 materiale referuese, i janë dërguar për kompetence Prokurorive të Juridiksioneve përkatëse pasi kanë

PROKURORIA: PËR 2018 KEMI VERIFIKUAR 185 PERSONA

"Sektori i verifikimit të Integritetit, i ngritur pranë Prokurorisë së Përgjithshme me prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore, ka krijuar një praktikë dhe vendim-marrje të konsoliduar. Sektori i Verifikimit të Integritetit pranë Prokurorisë së Përgjithshme pas një eksperience prej rreth 3 vitesh ka krijuar një praktikë dhe vendim-marrje të konsoliduar. Për vitin 2018 janë administruar 185 raste për verifikim të thelluar, nga të cilët për 147 raste ka përfunduar procesi. Nga 147 vendime "Për mira-

timin e rezultateve të verifikimit", të cilat u janë njoftuar institucioneve përkatëse, për 31 subjekte materialet referuese i janë dërguar për kompetence prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm pasi ka rezultuar, se këta shtetas kanë deklaruar të dhëna të pavërteta/rreme në formular, duke konsumuar veprën penale të "Falsifikimit të vulave, të stampave ose formularëve" parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal", thuhet në raportin e prokurorisë.



rezultuar, se këta shtetas kanë deklaruar të dhëna të pavërteta/rreme në formular duke konsumuar veprën penale të "Falsifikimit të vulave, të stampave ose formularëve" parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal", thuhet në raport. Po ashtu, në raportin vjetor të Prokurorisë së Përgjithshme, sa i takon bilancit të dekriminalizimit thuhet se është gjetur me shkelje edhe një zyrtar të lartë. "Gjatë vitit 2018 ka përfunduar verifikimi për 45 zyrtarë të lartë. Nga të cilët, për 44 prej tyre, është vendosur se nuk përfshihen brenda sferës së ndalimeve, ndërsa për 1 prej tyre pas verifikimit të të dhënave kanë rezultuar se përfshihet në fushën e veprimit sipas ligjit 138/2015", thuhet në raportin e Prokurorisë së Përgjithshme. Ndërkohë, në raportin e Prokurorisë bëhet me dije se janë kryer verifikime për plot 185 zyrtarë, kërkesa këto të bëra nga tre institucione. "Në vijim të

DEKRIMINALIZIMI, AKUZA: KEMI BASHKËPUNUAR ME KQZ

"Prokuroria e Përgjithshme ka kryer verifikim të thelluar të të kaluarës kriminale të funksionarëve publikë, edhe për vitin 2018, si dhe ka vijuar punën intensivisht në funksion të qëllimit dhe frymës së ligjit. Për këtë qëllim, ka bashkëpunuar me organet ligjzbatuese brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për sigurimin e informacionit të domosdoshëm që garanton verifikim të thelluar dhe për të evidentuar të

gjitha rastet kur funksionarit publik duhet t'i ndalohet të ushtrojë funksionet e tij publike. Gjithashtu, me asistencën e OSBE-së, janë organizuar takime ndërmjet përfaqësuesve të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, të cilat do të vijojnë dhe në të ardhmen, me synim rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional, evidentimin e problematikave, unifikimin e praktikave, etj", thuhet në raportin e prokurorisë.

punës së këtij sektori për vitin 2018, janë administruar, 185 raste për verifikim të thelluar. Departamenti i Administratës Publike ka kërkuar verifikim të thelluar për 137 subjekte. Komisioni Qendror i

Zgjedhjeve ka kërkuar verifikim të thelluar për 5 subjekte. Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2018, ka kërkuar verifikim për 43 subjekte vetëdeklaruese", thuhet në raportin e Prokurorisë së Përgjithshme.

Raporti i BE: Në Shqipëri lumenjtë janë të ndotur

Një raport i fundit i Bashkimit Europian, në lidhje me situatën e lumenjve, thotë se lumenjtë shqiptarë kanë nivelin më të lartë të ndotjes në Europë. Për gati 30 vite, në lumenjtë tanë kanë përfunduar lloj-lloj hedhurinash, që nga ambalazhet e qeset plastike e deri tek mbetjet industriale. Rezultatet e analizave u publikuan nga Eurostat në kuadër të monitorimit të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Sipas institucioneve të Bashkimit Europian që kanë kryer studimin lumenjtë shqiptarë janë të ndotur me kimikate dhe fosfate. Në 1 litër ujë ndodhen 7 miligramë biokimikate, ndërkohë që në një lumë të pastër niveli i kimikateve nuk shkon më shumë se 1 miligramë. Shqipëria ka diferencë të madhe edhe me Rumaninë, vend tjetër me nivelin më të lartë, me 3,5 miligram për një litër ujë. Gjithashtu, Shqipëria paraqitet keq edhe sa i përket pranisë së fosfateve. Niveli i fosfatit në lumenjtë shqiptarë është gati sa dyfishi i mesatares në lumenjtë europiane.

Zyrtarë e Ndhmës Ligjore, Gjonaj: Janë trajtuar 820 raste

Gjatë vitit 2019 në Zyrrën e Ndhmës Ligjore, pranë Ministrisë së Drejtësisë, janë trajtuar 820 raste nga 814 të zgjidhura. Kjo u bë e ditur dje nga ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj në rrjetet sociale, e cila tha se edhe përmes Zyrrës së Ndhmës Ligjore, në vijim të jemi çdo ditë pranë qytetarëve tanë duke i ofruar falas të gjitha shërbimet e nevojshme që thjeshtojnë aksesin në sistemin e drejtësisë, për të gjetur këshillimin e duhur ligjor: "E mbështetur financiarisht nga fondacioni "Shoqëria e Hapur për Shqipërinë", kjo zyrrë përmes punës së saj të përditshme ka mundur që të paktën 820 qytetarë të marrin ndihmën juridike parësore nëpërmjet këshillimeve, përpilim kërkesash dhe asistim në plotësimin e kërkesave për Ndhmë Dytësore Falas. Bilanci i kënaqshëm i gjashtëmuorit të parë paraqitet si një motivim më shumë për të vijuar në ofrimin e këtij shërbimi nëpërmjet drejtorisë së re të ndihmës juridike", deklaroi Gjonaj.

politike

KRIIK: 30 qershori hodhi në erë ligjet dhe institucionet, s'ka më pushtet vendor, reforma zgjedhore domosdoshmëri

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK Albania), e cila është një nga organizatat e pavarura në Shqipëri dhe që monitoron rregullisht proceset zgjedhore, ka mbajtur një qëndrim publik lidhur me zgjedhjet e 30 qershorit të këtij viti për pushtetin lokal. Kjo organizatë e cilëson procesin e 30 qershorit si "hedhje në erë" të gjithë ligjeve për zgjedhjet dhe balancimin e institucioneve. Në një deklaratë me nota kritike për gjithë klasën politike, theksohet se procesi i 30 qershorit ka shkatërruar gjithë praktikën disaveqare institucionale dhe ligjore. "30 qershori si dështim i klasës politike

dhe kërcënim ndaj demokracisë" me anë të të cilit evidenton se Procesi i 30 qershorit 2019, i konsideruar "Zgjedhje" apo "Votime", ka passjellë tanimë mandatimin e qeverisjes vendore të re, pavarësisht se është e pamundur të vlerësohet si një proces zgjedhor ku u evidentua shprehja e vullnetit të lirë e demokratik. Në konsideratën e KRIIK, në vijueshmëri të monitorimit të kryer për rreth një dekadë, ky proces i ashtuquajtur zgjedhor shënoi përmbylljen e një serie dështimesh të klasës politike vendase, ku ky dështim i fundit i faturoi vendit edhe dështimin në tre përpjekje madhore institucionale: -mungesë të kapacitetit

ligjor-institucional për të mbajtur zgjedhje me integritet; -zhbërjen e qeverisjes vendore si një pushtet i decentralizuar si dhe - pamundësinë e një dialogu serioz politiko-institucional, mungesa e të cilit ka sjellë radikalizimin e përballes politike duke u përpjekur për të instaluar një krizë kushtetuese permanente", thuhet në raport. Më tej, KRIIK thekson se në kushtet aktuale, Shqipëria ka nevojë për një Kod të ri Zgjedhor: "Në situatën aktuale, në gjykimin e KRIIK, për hir të nulizimit të precedentëve absurdë dhe antiligjorë të vendosur tanimë, nevojitet të merret në konsideratë shkrija e trupës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

dhe e Kolegjit Zgjedhor, si dhe nisja e punës për hartimin e një Kodi të Zgjedhor të ri. Pas disa përpjekjesh për reformë zgjedhore, të dështuara në dakordësi bi-partizane dhe në kontekstin e sotëm institucional gati kritik, ndërmarra e reformës zgjedhore është e një rëndësie aspak të lehtë, por ndërkohë përbën një domosdoshmëri urgjente. Reforma zgjedhore nevojitet të jetë e vetmja sipërmarrje që të konkurojë në vëmendje me reformën në drejtësi dhe me Luftën ndaj korrupsionit dhe krimin të organizuar, duke kaluar kësaj në plan të dytë sipërmarrjet e tjera madhore të shtetit shqiptar", deklaroi KRIIK.

■ Basha pritet të përdorë si "kleçkë" integrimin për t'u ulur në tryezë me Ramën

Integrimi, gjermanët dhe OSBE gati të marrin në dorë situatën në shtator, tentativa për të negociuar mes PD-PS për zgjidhjen e krizës

Rigels SELIMAN

Shtatori pritet të sjellë zhvillime të forta, sa i takon krizës politike në vend. Zgjedhjet vendore të 30 qershorit kaluan, ndërsa kriza politike vijon të mbetet ende prezente në vend, ku asnjë nga palët nuk hap rrugë. Por sytë tani janë kthyer nga ndërkombëtarët, të cilët sipas burimeve pritet të zbarkojnë në shtator, me qëllim gjetjen e gjuhës së përbashkët mes Partisë Demokratike dhe Partisë Socialiste. Këtë sinjal e ka dhënë edhe vetë kryedemokrati Lulzim Basha, i cili edhe pse këmbëngulte se nuk do të ulej në tryezë me kryeministrin Edi Rama, tanimë duket se është tërhequr. Basha duket se do të përdorë si preteks integrimin, në mënyrë që të ulet në një tryezë me Ramën, ku padyshim gjermanët dhe OSBE tanimë janë gati të marrin në dorë situatën. Madje, faktin se Basha ka ndryshuar kurs e vërteton edhe një deklaratë e tija e bërë dy ditë më parë, pas takimit me ambasadorin e ri të Gjermanisë në vendin tonë. Basha theksoi se Partia Demokratike do dalë me një platformë kombëtare për të zgjidhur krizën. "Koha nuk pret. Jemi në një moment shumë delikat, ndaj, ashtu siç kam paralajmëruar, Partia Demokratike dhe opozita e bashkuar, gjatë javëve në vijim, do të shpalojnë një platformë masash, për Shqipërinë si e gjithë Evropa, si një ofertë kombëtare, si një plan kombëtar, për të mos humbur më shumë kohë dhe mundësi të çmuar", deklaroi ai. Pra, kjo deklaratë e Bashës, jonetim që dëshmon faktin se ai është distancuar nga Meta, por tregon hapur se ai do të përdorë integrimin si "kleçkë" për t'u ulur në tryezën e negociatave me kryeministrin Edi Rama, me qëllim zgjidhjen e krizës. Po ashtu, edhe OSBE është ofruar për të ndërhyrë, pasi ka shprehur gadishmërinë për të asistuar reformën zgjedhore, ku në komision është lënë një vend edhe për Partinë Demokratike.

Gjermanët gati të marrin në dorë situatën në shtator

Ndërkohë, ajo që e vërteton më së miri se ndërkombëtarët tanimë janë gati për të mësyrë në Shqipëri, në mënyrë që t'i japin fund krizës politike që ka kapluar vendin prej gati 6 muajsh,

KRIZA POLITIKE, BASHA: NDËRKOMBËTARËT, JANË TË MIRËPRITUR

Kryetari i PD, Lulzim Basha deklaroi pak kohë më parë se është gati për negociatave me ndihmën e ndërkombëtarëve, në mënyrë që kriza politike që ka kapluar vendin të marr fund. "Jam njohur këto 24 orë me qëndrimet e partnerëve ndërkombëtarë. U kam komunikuar miqve ndërkombëtarë se mirëpres angazhimin e tyre për zgjidhjen e krizës politike në vend. PD dhe opozita kanë qenë dhe janë gati të përfshihen në një proces të vërtetë politik me ndihmën e partnerëve tanë ndërkombëtarë. Ai (Rama) hodhi poshtë sot ofertat publike për një angazhim të faktorit ndërkombëtar. PD-ja mirëpret çdo angazhim të faktorit ndërkombëtar për të zgjidhur këtë krizë të thellë. Në momentin që do të kemi një proces të hapur negociatash do iu informoj", deklaroi Basha.

KADILLI: NDËRMJETËSIMI I TË HUAJVE DO ZGJIDHTE KRIZËN


Ish-deputeti i Partisë Demokratike, Fatbardh Kadilli gjatë një prononcimi për gaztën "Sot", deklaroi pak ditë më parë se në kushtet kur kriza politike po thellohet dhe mazhoranca qeverisëse nuk hapë rrugë, sipas tij, çdo tentativë e ndërkombëtarëve për të zbutur tonet dhe zgjidhur krizën është e mirëpritur. "Zgjidhja e krizës politike është detyrë e vet shqiptarëve, e shoqërisë dhe politikës. Është provë e dobësisë së demokracisë shqiptare që ende kemi nevojë për ndërmjetës të jashtëm. Por, në kushtet kur njera palë, ajo që ka dhe më shumë mjete dhe mundësi, mazhoranca nuk jep shenja reflektimi, çdo angazhim nga partnerët perendimor është i mirëpritur", deklaroi ish-deputeti i Partisë Demokratike, Fatbardh Kadilli.

Boçi: Në Shqipëri demokracia është "vlarë"

Ish-deputeti i Partisë Demokratike, Luçiano Boçi ka bërë ditën e djeshme një analizë të thellë, sa i takon situatës politike në të cilën ndodhet vendi. Përmes një statusi në rrjetet sociale, Boçi ka ngritur alarmin se demokracia në Shqipëri nuk ekziston. "Sistemi demokratik njihet për avantazhet e veta sociale e ekonomike, në raport me të gjitha sistemet e tjera. Demokracia, fjalë që vjen nga greqishtja (demo-popull, kraci-rend) përcaktohet si një formë qeverisjeje në të cilën shumica e njerëzve ushtrojnë sovranitetin e tyre ose drejtpërdrejt nëpërmjet referendumeve, ose në mënyrë jo të drejtpërdrejt nëpërmjet zgjedhjes së përfaqësuesve ku baza themelore është vota e lirë. Vendosja e saj në Shqipëri mbetet një nga arritjet më të mëdha historike dhe kombëtare. Por sot, gati pas 30 vitesh është shumë e vështirë të flasim për një demokraci të vërtetë e funksionale. Deformimi i saj në thelb është spektakolar", deklaroi Boçi.

Gjunksi: Dosja "184" po varrosët nga Marku

Transferimi i dosjes "184" nga Prokuroria e Krimeve të Rënda për në Prokurorinë e Dibrës, për ish-deputetin e Partisë Demokratike, Xhemal Gjunksi është varrosje e saj për mos ndëshkimin e ministrave dhe ish-ministrave, deputetëve e zyrtarëve të PS. Gjatë një prononcimi për mediat, ai deklaroi dje se kjo është një tentativë për varrosjen e kësaj dosjeje përpara krijimit të SPAK. "Kjo dosje ka 3 vjet që është hapur, dhe është PD që ka kallëzuar dhe listuar blerjen masive të votave në Dibër. Në momentin që Prokuroria e Krimeve të Rënda pranoi marrjen e përgjimeve, ku ranë rrjetë edhe Rama, Gjijnurit, Pjerin Ndreu e Ulsi Manja, në këto moment, gjithçka është e bërë sipas ligjit, por kemi përfundimin e përgjimeve, dhe ndaj këtyre elementeve që përbëjnë krimin elektoral, janë pjesë e hetimit dhe duhet të kishin shkuar përpara drejtësisë. Në këto kushte është absurde që transferohet dosja në Dibër, një Prokurori që nuk ka aspak burime", deklaroi Gjunksi.



është deklarata e Bashës. Ky i fundit dy ditë më parë zbuloi se në shtator Gjermania pritet që të bëjë tentativa për të zgjidhur krizën. "Unë u jam shumë mirënjohës partnerëve tanë perendimorë, Gjermanisë, ambasadorin e ri të së cilës pata kënaqësinë ta pres sot, dhe personalitetëve të larta gjermane që do të vizitojnë Shqipërinë në javët e ardhshme. Janë ndër të parët që kanë ngritur zërin mbi domosdoshmërinë e kapërcimit të kësaj krize për të siguruar integrimin evropian të vendit. Kanë patur, kanë dhe do të kenë tek Partia Demokratike, tek opozita e bashkuar dhe tek unë personalisht, një faktor,

jo vetëm të interesuar, por të gatshëm të hedhë çdo hap të mundshëm për zgjidhjen e kësaj krize sipas parimeve, normave dhe standardeve evropiane", nënvizoi Basha. Megjithatë, mbetet për t'u parë në ditët në vijim se çfarë do të ndodhë më konkretisht.

Kriza politike, demokratët: Ndërkombëtarët të mirëpritur

Por të njëjtin mendim me Bashën, duket se ndajnë edhe vetë ish-deputetët e Partisë Demokratike, të cilët janë të hapur që ndërkombëtarët të ndërhyjnë për zgjidhjen e krizës. Gjatë një prononcimi për gazetën "Sot", ish-deputeti i PD, Luçiano

Boçi deklaroi pak ditë më parë se në kushtet kur kryeministri Rama nuk reflekton dhe kriza politike po thellohet, ndërhyrja e partnerëve evropianë dhe amerikanë, sipas tij, do të ishte e dobishme. "Ndërkombëtarët e kanë pasur si hapësirën ashtu dhe kohën për të reaguar për zgjidhjen e krizës. Deri tani kanë preferuar të përdorin gjuhën e drunjtë të veshur me terma "quasi" institucionale, duke menduar se po shkojnë drejt një detante politike. Efekti është krejt kundërt. Kriza është thelluar. Mendoj se ndërkombëtarët duhet të ushtrojnë përgjegjësitë që u takojnë", deklaroi Boçi.

politike

www.sot.com.al

Shqiptarët shpenzuan 144 mln euro për rikonstruksionin e banesave dhe bizneseve gjatë 4 viteve të fundit

Shqiptarët kanë harxhuar gjatë periudhës 2014-2018 mbi 144 milionë euro për rikonstruksionin e banesave. Sipas shifrave të publikuara nga INSTAT, shpenzimet për rikonstruksionin të banesave dhe bizneseve kanë nisur të ekspozohen pas shtërngimeve ligjore kundër ndërtimeve pa leje në vitin 2014. Ndryshimi i ligjit ka specifikuar lejen edhe për rikonstruksione të brendshme, mosmarrja e së cilës i penalizon deri në ndjekje penale të interesuarit. Për këtë arsye pas vitit 2014 kanë nisur të reflektohen me saktë shpenzimet që

kyhen edhe për rikonstruksionin e banesave. Vlera totale e rikonstruksioneve në ekonomi përgjatë 4 viteve të fundit arriti në 370 milionë euro, por pjesa më e madhe vlerës rreth 226 milionë euro klasifikohen si shpenzime publike që shkuan kryesisht rikonstruksione në ujësjellsa dhe godina publike. Përgjatë katër vjeçarit të fundit vlera më e lartë për rikonstruksion në ekonominë shqiptare arriti në vitin 2017 me mbi 14 miliardë lekë ose 110 milionë euro, 6,5 miliardë lekë shkuan për rikonstruksion banesash dhe bizneseve. Më tej përgjatë vitit 2018

shihet se vlera e rikonstruksioneve në ekonomi ka rënë me 30 për qind. Rënia është reflektuar si për bizneset ashtu edhe për banesat, teksa shihet se e njëjta tendencë ka vijuar edhe për vitin 2019. Në tremujorin e parë vlera e lejeve të dhëna për rikonstruksione ka rënë me 41 %. Teksa vlera e rikonstruksioneve ka pësuar ulje nga viti në vit, shpenzimet për ndërtesa të reja po rriten vit pas viti. Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike në Tiranë, sipas INSTAT, ishte gati 18 miliardë lekë (141 milionë euro) në tremu-

jorin e parë, nga 14.3 mld lekë në tremujorin e fundit 2018 (rritje 22%). Dy vitet e fundit, lejet e ndërtimit kanë shënuar rritje të dukshme në kryeqytet. Për të gjithë vitin 2018 janë dhënë leje me sipërfaqe prej 940 mijë metra katrorë, nga 521 mijë vitin e mëparshëm, me një rritje prej 80%. Vetëm në tremujorin e katërt janë dhënë leje për një sipërfaqe ndërtimi prej 456 mijë metra katrorë, ose 70% e sipërfaqes së dhënë gjithsej në vend për leje ndërtimi për këtë periudhë. Ritmi i lartë i tremujorit të katërt 2018 vijoi dhe në janar-mars të këtij viti.

Dalin të tjera dokumente që nxjerrin zbuluar Bankën e Shqipërisë

Thellohet skandali me kreditë e “Veneto Banka”, ja arsyet pse Banka e Shqipërisë nuk shpalli falimentin

Kliti TOPALLI

Thellohet akoma dhe më tepër skandali me falimentimin e “Veneto Banka”. Dokumentet që na kanë rënë në dorë së fundmi, tregojnë qartë pse Banka e Shqipërisë fshehu procesin e falimentimit të Grupit Veneto Banka në Itali. Nëse homologia e saj, Banka Qendrore e Italisë disponon një sërë shkresash dhe dekretesh të publikuara edhe në Fletoren Zyrtare të Qeverisë Italiane për falimentimin e “Veneto Banka”, në Shqipëri nuk gjejmë as edhe një dokument të vetëm. Madje Banka e Shqipërisë vazhdon ende të heshtë përballë çdo publikimi që ne po bëjmë së fundmi. Hesht ndoshta sepse e kupton që gjithë ky proces nga ana e saj si institucion i Bankës së Shqipërisë, u trajtua thjesht si një kalim aktiviteti bankar, nga një bankë në tjetrën, pra si një proces normal përthithje mes dy bankave. Nëse për llogaritë bankare apo depozitat e klientëve pranë “Veneto Banka”, procesi shkoi pjesërisht i rregullt, këtë nuk mund ta themi për kreditë e klientëve të kësaj banke. 100 milionë euro ishte shuma e portofolit të kredive të “Veneto Banka”, nga ku 25 milionë euro ishin kreditë e provigjionuara nga ana e Bankës së Shqipërisë. Të gjitha këto para cash provigjionimesh që justifikojnë rrogat e larta dhe shpërblimet e punonjësve të saj, si dhe shifrat in bonus, fitimet që raporton rregullisht çdo vit institucioni i Gent Sejkos. Ndërkohë që 50 milionë euro ishte totali i shumës së kredive të këqija. E gjitha kjo do të thotë se 50% e aktivitetit të kredihënies së “Veneto Banka” ka qenë shumë i keq, me risk mjaft të lartë për të gjithë sistemin bankar shqiptar. A ishte kjo arsyeja pse Banka e Shqipërisë anashkaloi procedurat e falimentimit të Veneto Banka në Shqipëri? Pra edhe duke shkëlur “me të dyja këmbët” ligjin për funksionimin e një Banke të Nivelit të Dytë, kur gjysma e aktivitetit të saj bankar, kredihënës, rezultoi të jetë me humbje. Ndaj edhe Banka e Shqipërisë nxitoi të fshinte nga Regjistri i Kredive të gjitha të dhënat e klientëve të “Veneto Banka”, duke u vendosur atyre statusin 5, “kredi e paguar”. Kjo në të dyja rastet, si kur kreditë e klientëve ishin (2018), tek

JA SI BANKA U LA 1 VIT PA DREJTOR

Gazeta tregoi ditë më parë me shifra konkrete se si një vit para se të nisnin procedurat e falimentit, “Veneto Banka”, çoi kreditë e këqija nga 17 për qind në 42 për qind, për shkak të përfitimit të kompensimeve nga italianët. Por po ashtu treguan dhe përgjegjësinë e BSH në këtë mes. Gent Sejko lejoi që “Veneto Banka” për gati një vit të ishte pa Drejtor të Përgjithshëm, pra pa CEO. Pierluigi Caferri u largua në fund të 2017 duke marrë rreth 100 mijë euro dëmshpërblim dhe


pastaj banka mbeti pa drejtues. Banka e Shqipërisë miratoi në heshtje ikjen e Drejtorit të Përgjithshëm të “Veneto Banka”. Këtë vendim e miraton më pas vetë QKB, e cila regjistron sërish një Shoqëri Aksionere me Këshill Drejtues funksional, me anëtarë dhe me aksione të përcaktuara se kush është pronari, por çuditërisht në mungesë të Administratorit që në këtë rast është Drejtori i Përgjithshëm. Kjo i hapi rrugë batërdisë me kreditë dhe bilancet.

Zyrtarë e aplikimit për karta ID, të hapura dhe të shtunë

Zyrtarë e aplikimit për dokumente identiteti do të qëndrojnë të hapura edhe të shtunave, me qëllim që qytetarët dhe emigrantët të kenë më shumë mundësi aplikimi dhe njëherësh të kursejnë kohë të vlefshme. Zyrtarë e shërbimit të qytetarëve në Policinë e Shtetit si dhe zyrtarë e Gjendjes Civile do të jenë gjithashtu të hapura të shtunave, duke krijuar kështu lehtësira për çdo shtetas që ka nevojë për rinovimin e dokumenteve të identitetit. Ministria e Brendshme u bën thirrje të gjithë qytetarëve që këtë vit u skadojnë dokumentet e identitetit, të aplikojnë për karta ID dhe pasaporta biometrike, pasi që nga muaji tetor 2019, do t’ju kushtëzohet shërbimi pa u pajisur me kuponin e aplikimit. Sipas tyre duhet të aplikojmë shpejt që të shmangim radhët. Aplikimet e para për karta identiteti nisën në vitin 2009 dhe ata që i kanë marrë në fillim do të duhet t’i rinovojnë pasi nuk ofrohet shërbime nga zyrtarë e shteti, deri të bankat e institucionet tjera.

AKU ndalon hyrjen e 387.1 ton mish nga Brazili

Nga kontrollat e kryera nga AKU në Pikën e Inspektimit Kufitar Durrës gjatë ditëve të fundit kanë konkluduar se disa ngarkesa me produkte importi janë të pasigurta për konsum njerëzor dhe si rrjedhojë kanë vendosur për kthimin e tyre në vendin e origjinës. Më konkretisht: Tre ngarkesa me sasi totale 74.946 ton “Mish Derri” me origjinë nga Kanadaja, importuar nga subjekti “FRIGO ALB shpk”, rezultuan se nuk përmbushin kërkesat ligjore të sigurisë ushqimore dhe kishin mangësi në besueshmërinë e dokumentacionit shoqëruar. Dy ngarkesa me sasi totale 52.257 ton “Mish Vçi” me origjinë nga Brazili, importuar nga subjekti “Apetit shpk”, në regjim tranzit në territorin e Shqipërisë me destinacion final Kosovën, rezultuan me mangësi dhe mospërputhje thelbësore në dokumentacionin shoqëruar të mallit. Më herët, analizat e kryera për disa nga ngarkesat me produkte ushqimore mish të importuar rezultuan me ngarkesë mikrobiologjike dhe si rrjedhojë, produkti ushqimor importuar me këto ngarkesa është i pasigurt dhe i papërshtatshëm për konsum njerëzor.



Ja çfarë ka ndodhur me “Veneto Banka”

Gazeta tregoi dje sesi kjo bankë kaloi te “Intesa San Paolo” dhe u bë një maskaradë me kreditë e shqiptarëve. Kushdo që kishte 1-2 muaj vonesa u kualifikuan te kreditë e këqija, ndërsa “Intesa” vuri në lëvizje kompaninë “SGA” për të mbledhur borxhet e “Veneto Bank” në Shqipëri, pra për t’u sekuestruar asetet shqiptarëve. Duke

qenë se kjo e fundit nuk ka autoritet në vendin tonë, kontaktoi kompaninë “Tranzit Shpk”, shoqëri offshore me seli në ishujt Cayman. Pronari i saj figuron dhe pronar i “Abi Bank”. Por ai që ka lejuar gjithë katrahurën është Gent Sejko. Gazeta ka siguruar vendimin e Guvernatorit, i cili i hapi rrugë kalimit të “Veneto Bank” te “Intesa San Paolo”.

“Veneto Banka” dhe më pas kaluan tek Shoqëria që realizoi falimentin, “LCA Veneto Banca spa”, në shifrën totale 25 milionë euro. Ashtu edhe në rastin kur kreditë e klientëve ishin (2019), tek Intesa Sanpaolo Bank dhe kaluan tek LCA Veneto Banca spa po në vlerën e 25 milionë euro. Kush i pagoi këto para për kreditë e klientëve të Veneto Banka? A duhet të kenë të drejtë të dinë klientët shqiptarë të një banke shqiptare se kush dhe sa pagoi për kredinë e tyre?

Problemet

Janë plot 50 milionë euro që ashtu si “kreditë e paguara” të pasqyruara në Raportin e Kredisë së Bankës së Shqipërisë, që nuk raportohen gjëkund edhe fiskalisht, që natyrisht nuk pasqyrohen në asnjë bilanc, rrjedhimisht duke shmangur tatimin. Se çfarë

përgjigje do t’i japë Banka e Shqipërisë Ministrisë së Drejtësisë, në shkresën zyrtare që ne disponojmë, kjo mbetet për t’u parë në ditët në vijim. Por edhe se çfarë do t’u thonë prokurorëve, të cilët kanë në dorë ashtu si edhe ne si media, dokumente shumë të rëndësishme që implikojnë institucionin e Gent Sejkos në këtë aferë të pastër

kundër klientëve shqiptarë të një banke shqiptare, gjithashtu edhe shtetit shqiptar, këtë do ta shohim gjatë procesit hetimor. Nëse Banka e Shqipërisë ka një dokument, apo një shkresë zyrtare apo Vendim Bordi apo Asambleje të Veneto Banka, për kreditë e këqija të kësaj banke, ne ftojmë ta publikojë sa më parë.

e k o n o m i

■ Ndryshojnë masat e përfitimit edhe për personat kujdestarë

Zbardhet udhëzimi, rriten pagesat për personat me aftësi të kufizuara, ja përfitimet sipas kategorive

Mimoza IBRA

Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale ka vendosur të rrisë pagesat për personat me aftësi të kufizuara, por edhe për personat që ju shërbejnë atyre. Në Qendrën e Botimeve Zyrtare janë botuar disa udhëzime të ministres Ogerta Manastirliu, të cilat tregojnë sesi do të ndryshojnë pagesat sipas kategorive. Në udhëzimin e parë thuhet se masa e përfitimit për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001, bëhet 10.653 lekë në muaj. Në VKM e cituar masa e pagesës për invalidët, paraplegjikë ose tetraplegjikë, ishte 70 për qind e pagës minimale të punonjësit buxhetor dhe ndryshonte sa herë ndryshonte kjo pagë. Por tani paga do të jetë 10.653 lekë në muaj. Ndërsa kujdestari i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik do të përfitojë 11.190 lekë në muaj, nga 70% të pagës minimale të punonjësit buxhetor që përfitonte më parë. Ndryshime në pagesë ka edhe për personat të cilëve iu është kufizuar aftësia, si pasojë e dëmtimeve fizike, shqisore, të intelektit, psikiko/mendore, të lindura apo të fituara gjatë jetës nga aksidente, sëmundje, të përkohshme apo të përhershme, që nuk vijnë nga shkaqe, që lidhen me punësimin, e vërtetuar kjo nga Komisioni Mjekësor i Aktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP). Ata tani do të përfitojnë 10.653 lekë në muaj, nga 6.800 lekë në muaj që ishte sipas vendimit nr. 618 datë 7.9.2006. Të njëjtën masë, pra 10.563 lekë në muaj, përfiton edhe kujdestari i personit me aftësi të kufizuar. "Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8, të VKM-së nr. 618, datë 7.9.2006, bëhet 10.653 lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2 të vendimit dhe 11.190 lekë në muaj për kujdestarin", thuhet në udhëzimin e tretë të Ministrisë së Shëndetësisë. Pra, personat



paraplegjikë e tetraplegjikë, të cilët deklarohen, me vendim të Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Aftësisë për Punë do të përfitojnë 10.653 lekë në muaj, nga 6.800 lekë në muaj që ishte më parë. Nga ana tjetër, masa e përfitimit për shkak të verbërisë bëhet 12.092 lekë në muaj nga 70% e pagesës minimale shtetërore që ishte e përcaktuar më parë. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i të verbrit.

Ndryshimet e tjera

Ministria e Shëndetësisë ka bërë edhe disa ndryshime të tjera. Sa i takon pagesës bazë për shkak të aftësisë së kufizuar do të jetë 10.871 lekë në muaj nga 150% e shumës së pensionit social, që ishte e përcaktuar në VKM nr. 431, datë 8.6.2016. Ndërkohë, masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar për individët që kërkojnë të vlerësohen për herë të parë do të përfitojnë 6.523 lekë në muaj nga 60% të pagesës bazë që përfitonin deri dje. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar për personat mbi 18

vjeç me kufizime mesatare që kërkojnë të vlerësohen për herë të parë që deri dje përfitonin 80% të pagesës bazë, tani do të përfitojnë 8.697 lekë në muaj. Nga ana tjetër, masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar për personat mbi 18 vjeç me kufizime të thella që kërkojnë të vlerësohen për herë të parë që përfitonin 100% të pagesës bazë tani do të përfitojnë 10.871 lekë në muaj. Me udhëzimin e ri, personat mbi 18 vjeç me kufizime të rënda që kërkojnë të vlerësohen për herë të parë përfitojnë 13.045 lekë. Më parë ata përfitonin 120% të pagesës bazë. Po ashtu, masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar për fëmijët me kufizime të lehta do të jetë 4.892 lekë në muaj nga 75% e shumës së përcaktuar për personat madhorë me kufizime të lehta që përfitonin më herët.

Kategoritë e tjera

Një tjetër kategori që përfshihet nga ndryshimet e Ministrisë së Shëndetësisë janë fëmijët me kufizime mesatare që kërkojnë të vlerësohen për

herë të parë. Me vendimin nr. 431 datë 8.6.2016 ata përfitonin 75% të shumës së përcaktuar për personat madhorë me kufizime mesatare. Por tani do të përfitojnë 6.523 lekë në muaj. Nga ana tjetër, masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar për fëmijët me kufizime të rënda që vlerësohen për herë të parë është përcaktuar 8.153 lekë në muaj, nga 75% e shumës së përcaktuar për personat madhorë me kufizime të rënda që përfitonin më parë. Sakaq, për fëmijët me kufizime të thella që po ashtu vlerësohen për herë të parë është përcaktuar të përfitojnë 9.785 lekë në muaj. Edhe ata deri dje merrnin 75% të shumës së përcaktuar për personat madhorë me kufizime të thella. "Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 16, të kreut IV, të VKM-së nr. 431, datë 8.6.2016, të ndryshuar, për shërbimet gjithëpërfshirëse të ndihmës personal, është 13.045 (trembëdhjetë mijë e dyzet e pesë) lekë në muaj për personat e përcaktu-

Në udhëzimin e parë thuhet se masa e përfitimit për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001, bëhet 10.653 lekë në muaj. Në VKM e cituar masa e pagesës për invalidët, paraplegjikë ose tetraplegjikë, ishte 70 për qind e pagës minimale të punonjësit buxhetor dhe ndryshonte sa herë ndryshonte kjo pagë.

ar në pikën 2, germa "a", të kreut I të vendimit", thuhet në një pikë tjetër të udhëzimit të Ministrisë së Shëndetësisë. Pra, shuma e pagesës për shërbime gjithëpërfshirëse për ata që vlerësohen për herë të parë është përcaktuar të jetë 13.045 lekë në muaj, nga 120% e pagesës bazë të aftësisë së kufizuar që ishte e përcaktuar më herët. Së fundmi, masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar për shërbime të herëpërhershme për individët që kërkojnë të vlerësohen për herë të parë do të jetë 8.697 lekë në muaj. Deri dje kjo masë ishte 80% e pagesës bazë të aftësisë së kufizuar.

Mblidhet Këshilli Tatimor, diskuton për "Fiskalizimin"

■ Këshilli Tatimor zhvilloi dje një diskutim mbi projektligjin "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit". Të pranishëm në diskutim ishin edhe zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë, Elton Haxhi dhe Drejtoresha e Përgjithshme e Tatimeve, Delina Ibrahimaj. Gjatë prezantimit të projektligjit, zv.ministri Haxhi vuri theksin në risitë e tij, që synojnë një kontroll më të mirë të transaksioneve të tatimpaguesve. "Ndryshimi i këtij sistemi adreson edhe disa çështje të tjera të

rëndësishme, qoftë në aspektin e kontrollit tatimor, ashtu edhe në vlerësimin e riskut, si dhe në një kontroll të disa komponentëve të tjerë që kanë të bëjnë me gjendjen parave kesh, me regjistrin e tatimpaguesve, apo edhe me regjistrin e aktiveve afatgjatë, materiale apo jo materiale", u shpreh z. Haxhi. Ndërkohë, Drejtoresha e Përgjithshme e Tatimeve, Delina Ibrahimaj, vlerësoi konsultimin e projektligjit për Fiskalizimin në Këshillin Tatimor, në funksion të përmirësimit të draftit.

Ligji i ri i Ministrisë së Mjedisit, taksa e mbetjeve sipas sasisë

■ Ministria e Mjedisit do të përdorin instrumente ekonomike dhe masa të tjera financiare për të siguruar zbatimin e hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve, që sipas legjislacionit në fuqi nis me parandalimin e gjenerimit të tyre. Gjithçka përcaktohet në ndryshimet e ligjit "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të nxjerrë për konsultim publik, ku ndër masat e sugjeruara parashikohet vendosja e detyrimeve financiare dhe kufizimeve për depozitimin dhe djegien e mbetjeve, që nxisin paran-

dalimin dhe riciklimin e mbetjeve, duke e mbajtur depozitimin si opsionin më pak të preferuar për menaxhimin e mbetjeve. Gjithashtu, parashikohet aplikimi i skemave "Paguaj-si-hedh", që ngarkojnë financiarisht prodhuesit e mbetjeve në bazë të sasisë së mbetjeve të krijuara dhe nga ana tjetër ofrojnë stimuj për ndarjen në burim të mbetjeve të riciklueshme dhe për zvogëlimin e mbetjeve të përziera. Të tjera masa parashikojnë vendosjen e stimujve fiskalë për dhurimin e produkteve.

3.3 milionë turistë vizituan Shqipërinë në 7 muaj

■ Shifrat e korrikut dëshmuar se sezoni veror po jep një shtysë turizmit hyrës edhe për këtë vit. Instituti i Statistikave raportoi se Shqipërinë e vizituan afro 1.2 milionë turistë të huaj, në rritje me 14.5% krahasuar me korrikun 2018. Numri i përgjithshëm të vizitorëve për 7-mujorin arriti në 3.3 milionë, 12% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Efektin kryesor në rritjen e turizmit gjatë sezonit e ka dhënë shtimi i ndjeshëm i vizitorëve nga Kosova. Për korrikun, numri i tyre u rrit me 25%, ndërsa për 7-mujorin kaloi pragun e një milionëve. Në

raport me vitin e kaluar, numri i vizitorëve nga Kosova është rritur me afro 14% dhe ata përbëjnë rreth një të tretën e numrit të përgjithshëm të vizitorëve të huaj. Rritje dyshifrore për korrikun regjistroi edhe numri i turistëve nga Anglia, Gjermania dhe Zvicra. Turizmi nga vendet e Evropës Perëndimore ngelet në rritje të kënaqshme edhe për këtë vit, megjithatë turizmi hyrës vazhdon të mbështetet kryesisht në hyrjet e shtetasve nga vendet fqinje. Vizitorët nga vendet kufitare përbëjnë rreth 60% të numrit total të vizitorëve të huaj për këtë vit.

rajon & bote

Zjarret në Amazonë/ Merkel e Macron kërkojnë diskutim në G7

Kancelarja gjermane Angela Merkel ka mbështetur dje thirrjen e presidentit Emmanuel Macron për të futur çështjen e zjarreve në Amazonë në axhendë e samitit të G7 në fundjavë pasi Macron tha se situata përbente një krizë ndërkombëtare. Zëdhënësi i kancelares Steffen Seibert, tha për gazetaret në Berlin: "Masa e zjarreve në pyjet e Amazonës është shokuese dhe kërcënuese jo vetëm për Brazilin por për të gjithë planetin. Në takimin e G7 në fundjavë kancelaria është e bindur se kjo emergjencë duhet të përfshihet në diskutime". Por reagimi fillestar i Macron solli një reagim të ashpër nga presidenti brazilian Jair Bolsonaro që akuzoi për sjellje kolonialiste ndaj një çështjeje të brendshme të Brazilit dhe të shteteve të tjera të Amazonës.



Rusi, Putin kërkon "reagim simetrik" ndaj testeve rakitore të SHBA

Presidenti rus Vladimir Putin urdhëroi dje ushtrinë të kryejë "reagime simetrike" ndaj testimin nga SHBA të një rakete që më parë ndalohej nga traktati i braktisur i armëve mes dy superfuqive. Putin raportohet se ka urdhëruar një analizë "të nivelit të kërcënimit ndaj vendit tonë pas veprimeve të SHBA, dhe të merren masa të plota për përgatitjen e një reagimi simetrik", sipas citimeve të fjalës së tij në këshillin tus të sigurisë që u mbledh në Moskë të premtën. Të hënën Pentagoni tha se kishte testuar një raketë që goditi objektivin e saj për më shumë se 500km fluturim, në testimin e parë që prej largimit të tij nga traktati i armëve bërthamore me Rusinë. Putin tha se testimi konfirmonte se SHBA do të tentonte të vendosë raketat e ndaluara në Evropë.




Trump fton kompanitë amerikane të largohen nga Kina

Kriza tregtare/ Kina njofton rritje tarifash në 75 miliardë dollarë për produktet amerikane

Andi LAMKO

Kina ka njoftuar dje ngritje tarifash për produkte amerikane në vlerë 75 miliardë dollarë, në kundërpërgjigje të rritjes së fundit të tarifave nga administrata Trump, duke thelluar konfliktin tregtar dhe teknologjik mes dy ekonomive më të mëdha të botës, që nëse vazhdon kështu do të shkaktojë ulje të tregtisë dhe rritje të varfërisë në të gjithë shtetet. Pekini njoftoi gjithashtu rritjen e tarifave të importit për veturat amerikane dhe pjesët e këmbimit, duke nisur respektivisht nga 1 shtatori dhe 15 dhjetori. Zhvillimet vijnë në një kohë kur Uashingtoni i kërkon Pekinit të reduktojë suficitin e tij tregtar dhe të reduktojë planet për krijimin e kompanive konkurruese në fushën e robotikës, makinave elektrike dhe industri të tjera të teknologjisë. Konflikti mes të dyjave ka goditur prodhuesit në të dyja vendet. Ndërkohë SHBA dhe Kina nuk i kanë ndryshuar planet për të zhvilluar një tjetër raund bisedimesh tregtare muajin e ardhshëm. Këshilltari ekonomik i Shtëpisë së Bardhë Larry Kudloë tha se diskutimet e kësaj jave midis negociatorëve në nivel zëvendësash ishin konstruktive.

Trump: Nuk kemi nevojë për Kinën
Presidenti amerikan porositi dje kompanitë amerikane të shikojnë mënyra për të mbyllur operacionet e tyre në Kinë, dhe për të prodhuar më shumë produkte të tyre në Shtetet e Bashkuara. Presidenti nuk mund të detyrojë kompanitë të braktisin Kinën por nuk dha detaje sesi do të procedojë



me këtë urdhër. "Kompanitë tona të mëdha amerikane janë porositur që menjëherë të fillojnë të kërkojnë alternativa kundrejt Kinës, duke përfshirë sjelljen dhe prodhimin e produkteve tuaja në SHBA", ka shkruar Trump. "Ne nuk kemi nevojë për Kinën dhe, sinqerisht, do të ishte shumë më mirë pa të", shtoi ai. Komentet e tij shkaktuan rënie e tregjeve amerikane të aksioneve dje paradite. Ekspertët thonë se administrata mund të përdorë politikën e taksave, tarifave apo sanksionet për të ulur ose eliminuar aktivitetin e kompanive amerikane në Kinë, por do të duheshin shumë vite që këto politika të japin rezultat nëse zbatohen. Disa vende si Vietnam dhe Meksika kanë përfituar nga lufta tregtare mes dy gjigantëve, sepse shumë kompani amerikane po i zhvendosin atje operacionet e prodhimit që i kanë mbyllur në Kinë për shkak të

tarifave. Trump përsëriti argumentin se Amerika prej vitësh humbet trilionë dollarë në tregtinë me Kinën dhe se ka lejuar Kinën të vjedhë pasurinë intelektuale amerikane.

Ekspertët: Kompanitë amerikane do të vuajnë pasojat
Ekspertët të Fondit Monetar Ndërkombëtar paralajmëruan dje se konsumatorët dhe importuesit amerikanë do të paguajnë më shumë si rezultat i tarifave të administratës ndaj mallrave kineze dhe se ato nuk do të mund të zgjidhin imbalancat tregtare mes dy ekonomive, për të cilat ankohej Trump. Ekspertët Gustavo Adler, Luis Cubeddu e Gita Gopinath argumentonin në një koment se vendosja e tarifave është një praktikë kundër-produktive ndaj mbivlerësimit të valutës, pasi sipas tyre, tarifave dhe ratat e këmbimit funksionojnë ndryshe. Gustavo Adler

Ngritja e tarifave bilaterale nuk ka gjasa të reduktojë imbalancat e përgjithshme tregtare, por vetëm të kalojë një masë të tregtisë në vende të tjera. Më shumë gjasa ka të dëmtohen rritja ekonomike e vendeve dhe ajo globale nga dëmtimi i besimit të biznesi dhe të zinxhirit global i furnizimit...

është zv. kryetar i degës së kërkimeve në FMN, Luis Cubeddu drejton divizionin e hapur ekonomik, tha Gita Gopinath krye-ekonomist. "Konsumatorët dhe importuesit në SHBA do të mbajnë barrën e tarifave. Arsyeja është se vlera e altër e dollarit ka vetëm një efekt minimal mbi çmimet në dollarë të eksportuesve kinezë. Ngritja e tarifave bilaterale nuk ka gjasa të reduktojë imbalancat e përgjithshme tregtare, por vetëm të kalojë një masë të tregtisë në vende të tjera", shkruajnë autorët, duke shtuar se më shumë gjasa ka të dëmtohen rritja ekonomike e vendeve dhe ajo globale nga dëmtimi i besimit të biznesi dhe të zinxhirit global i furnizimit, duke rritur kostot për prodhuesit dhe konsumatorët.

Fushata Kosovë, Nisma dhe AKR nënshkruajnë për koalicion

Nisma Socialdemokrate dhe Aleanca Kosova e Re, nënshkruajnë marrëveshje për koalicion parazgjedhor. Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj tha se ky koalicion parazgjedhor, do të jetë "faktori përcaktues" për Qeverinë e ardhshme të Kosovës. "Nisma dhe AKR do të jenë faktori kryesor në qeverisjen e ardhshme. Ky koalicion do të jetë përcaktues i Qeverisë së ardhshme të Republikës së Kosovës", tha Limaj dhe shtoi se presin edhe parti të tjera të bashkohen.

Kosnett: Një person nga Kosova është ekstraduar në SHBA

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Philip Kosnett ka thënë dje se një person nga Kosova është ekstraduar në SHBA. Përmes një postimi në Twitter, Kosnett ka thënë se ekstradimi i tij, shënon edhe zbatimin për herë të parë të Marrëveshjes për Ekstradim ndërmjet Kosovës dhe SHBA, e finalizuar në qershor. "Në qershor SHBA-ja dhe Kosova përfunduan Marrëveshjen e Ekstradimit. Sot ne e përdorëm atë për herë të parë për të kthyer një të arratisur", tha ai.

Rrufetë vrasin katër persona në Poloni, një në Sllovaki

Të paktën katër njerëz gjetën vdekjen dhe më shumë se 100 të tjerë janë lënduar në goditjet e rrufesë gjatë një stuhie në Poloni, tha kryeministri Mateusz Morawiecki. Rrufeja më e keqe ra mbi një grup alpinistësh në majën e Giewont. Gjithashtu raportohet se një person i pestë u vra në Sllovakinë fqinje. Të paktën një nga viktimat u tha se ishte një fëmijë. Incidenti më i rëndë ndodhi të enjten në majën e malit Giewont 1,894m, ku është vendosur një kryq metalik.

Mattarella: Italia po shkon drejt zgjidhjes së krizës

Presidenti i Italisë Sergio Mattarella pas bisedimeve me forcat politike për dy ditë radhazi, doli dje para medias për të deklaruar se po shkohet drejt një zgjidhje të krizës. Mattarella deklaroi se gjatë bisedimeve me forcat politike i është propozuar nga disa prej tyre krijimi i një qeverie të re. Ai ndoshta i referohej negociatave midis Lëvizjes 5 Yjet dhe të majtëve të Partisë Demokratike për të aprovuar koalicionin. Por në një tjetër zhvillim, kreu i Lega-s, Matteo Salvini tha dje se është

i hapur për rinisje të koalicionit me aleatët e vjetër Lëvizja 5-Yje, nëse ata e heqin dorë nga ruajtja e kontrollit të financave nga Brukseli. Zhvillimet vijnë në një kohë kur presidenti Mattarella i ka dhënë politikës pesë ditë për të arritur marrëveshje të shmangies së zgjedhjeve të parakohshme. "Nëse 5-Yje dëshirojnë të avancojnë me koalicionin, me një grup të ri e të përmirësuar për kalimin e buxhetit ambicion, ne jemi gati të diskutojmë partneritetin", tha Salvini.

Britania e Madhe do të kthejë emigrantët që hyjnë nga Franca

Britania e Madhe do të kthejë emigrantët, që në mënyrë të paligjshme, përpichen të kalojnë kanalin e La Manshit nga Franca, tha të premtën kryeministri britanik, Boris Johnson. "Ne do t'ju kthejmë përsëri", tha Johnson, kur u pyet se cili ishte mesazhi i tij për emigrantët e paligjshëm, pasi autoritetet zunë një varkë emigrantësh në brigjet e jugut të Anglisë. "Mbretëria e Bashkuar nuk duhet të konsiderohet si një vend, ku ju mund të vini në mënyrë të paligjshme", tha

Johnson. Rreth 65 persona që kanë mbërritur në Britaninë e Madhe, në mënyrë të paligjshme, me anije të vogla, janë kthyer në vendet evropiane, tha ministria e Brendshme. Gjatë këtij viti, më shumë se 950 njerëz, përfshirë të paktën 80 fëmijë, kanë kaluar kanalin që lidh Francën dhe Britaninë e Madhe, përmes anijeve të vogla. Britania është nën presion për të fituar mbështetje mbi marrëveshjen e Brexit por deri tani nuk ka pranuar kushtet e Bashkimit Evropian.

Koreja e Veriut quan Pompeo 'helmues' i diplomacisë

Kryediplomati i Koresë së Veriut quajti sot sekretarin amerikan të shtetit Mike Pompeo, një "toksinë rezistente" që vetëm komplikon bisedimet e denuklearizimit, dhe shtoi se Korea e Veriut është e gatshme dhe për dialog edhe për konfrontim. Ministri i Penianit, Ri Yong-ho, iu referua komenteve të fundit të Pompeo në intervistat me mediat ku ka thënë se sanksionet ndaj Veriut do të mbeten deri në marrjen e veprimeve konkrete për denuklearizimin. "Ai është i pacipë që

nxjerr fjalë të tilla dhe që ne na lënë në dyshim nëse mund të zgjidhim diçka me këtë person", tha Ri duke shtuar se Pompeo vetëm komplikon bisedimet e denuklearizimit, dhe shtoi se Korea e Veriut është e gatshme dhe për dialog edhe për konfrontim. Ministri i Penianit, Ri Yong-ho, iu referua komenteve të fundit të Pompeo në intervistat me mediat ku ka thënë se sanksionet ndaj Veriut do të mbeten deri në marrjen e veprimeve konkrete për denuklearizimin. "Ai është i pacipë që

kronike

Mes të arrestuarve, babai i autorëve të krimit të rëndë

Zbardhet vrasja e 26-vjeçarit, djemtë e pronarit të vilës vranë punëtorin e kondicionerit se rridhte uji, 4 në pranga

Elvis MYRTA

Indrit Celaj, 26-vjeçari i plagosur me plumb në kokë të enjten, nuk ka mundur ta fitojë luftën me vdekjen, duke e humbur atë në orët e para të mëngjesit të djeshëm. 24 orë pas krimit të rëndë Policia e Tiranës ka mundur të zbardhë krimin e rëndë, duke shpallur në kërkim dy djemtë e pronarit të vilës trekateshe, si autorë të dyshuar. Gjithashtu uniformat blu të kryeqytetit vunë në pranga 4 persona, për moskallëzim krimi dhe pengim të zbardhjes të së vërtetës, mes të arrestuarve është edhe babai i dy autorëve të vrasjes së punëtorit të kondicionerëve. Më pranga përfunduan Lorenc Veliaj, 27 vjeç dhe Edmond Sula, 43 vjeç, të cilët akuzohen për veprat penale "Vrasja me dashje" në bashkëpunim, "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit" dhe "Përkrahja e autorit të krimit", Ferdinand Bakalli 41 vjeç dhe Luan Çaka 36 vjeç të cilët akuzohen për "Moskallëzim krimi" dhe "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës". Ata dyshohet se kanë qenë prezent në momentin që ka ndodhur ngjarja dhe nuk kanë njoftuar policinë. Indrit Celaj u vra nga dy vëllezërit, pasi kondicioneri që ai kishte montuar pikonte. Të pakënaqur nga puna e tij dy vëllezërit Kusi, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, e kanë qëlluar me plumb në kokë 26-vjeçarin.

Zbardhja e ngjarjes

Sipas hetimeve, dy vëllezërit Griseldo dhe Albano Kusi, 31 dhe 28 vjeç, pasi qëlluan punëtorin në bashkëpunim me njëri-tjetrin, duke e lënë fillimisht të plagosur rëndë, kërcënuan një tjetër punëtor që shoqëronte Indrit Çelën për riparimin e kondicionerit me të cilin kishin lidhje shoqërore, duke i kërkuar të pranojë para autoriteteve se është ai personi që plagosi 26-vjeçarin. Por Lorenc Veliaj, 27 vjeç u largua nga vendi i ngjarjes, për shkak se rezultoi të ishte në kërkim policor për vepra të tjera penale. Pas punës hetimore të policisë, Lorenc Veliaj u arrestua mbrëmjen e djeshme, shumë orë pas krimit, ku me dëshminë e tij ka zbardhur gjithçka ndodhi. Ai deklaroi se ishin vëllezërit Griseldo dhe Albano Kusi që në bashkëpunim me njëri-tjetrin qëlluan me armë punëtorin, pas një debati se po pikonte ujë kondicioneri.



Sipas hetimeve, dy vëllezërit Griseldo dhe Albano Kusi, 31 dhe 28 vjeç, pasi qëlluan punëtorin në bashkëpunim me njëri-tjetrin, duke e lënë fillimisht të plagosur rëndë, kërcënuan një tjetër punëtor që shoqëronte Indrit Çelën për riparimin e kondicionerit me të cilin kishin lidhje shoqërore, duke i kërkuar të pranojë para autoriteteve se është ai personi që plagosi 26-vjeçarin...

Ai tha se vëllezërit, i kërkuar që të pranonte se ishte ai personi që plagosi me armë Indrit Çelën, që sot ndërroi jetë. Por Veliaj ka rrëfyer gjithçka para hetuesve. Në këto kushte, Veliaj u vu në pranga si person në kërkim për veprat e tjera që rëndonin ndaj tij: "Kundërshtim me dhunë i punonjësit të Policisë së Rëndit publik", "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit" dhe "Shkatërrimi i pronës", për të cilat Gjykata e Tiranës i kishte vendosur masën e sigurisë "arrest me burg". Teksa vëllezërit bashkëpunëtorë në vrasje janë vënë në kërkim për krimin e rëndë dhe për armëmbajtje pa leje.

Nga vrasje, në plagosje e grabitje, ja krimet e vëllezërve Kusi

Dy vëllezërit që kryen krimin dy ditë më parë në vilën e tyre, Griseldo Kusi dhe Albano Kusi nuk janë emra të panjohur për drejtësinë shqiptare. Ty dy vëllezërit janë të përfshirë në shumë ngjarje kriminale si vrasje, plagosje e tentativë vrasje. Aktivitetit i tyre kriminal

ka nisur në vitin 2010, ku akuzohen për vepra të rënda penale. Ata janë arrestuar dhe kanë marrë dënime të lehta nga gjykatat edhe pse akuzoheshin për vrasje dhe për vrasje të mbetur në tentativë. Konkretisht Albano Kusi ka vranë me armë zjarri Shkëlqim Nozlli, ngjarje kjo e ndodhur në 16 tetor të vitit 2010, ndërkohë që trupi i viktimës u gjet dy ditë më vonë në Qafë-Kërrabë. Pas hetimeve rezultoi se zanafilla ishte një borxh i papaguar mes viktimës dhe Albano Kusit edhe pazaret për blerjen e drogës. Sipas vendimit të gjykatës, motivi i ngjarjes ishte një borxh prej 650 eurosh që i kishte viktimia. Sipas Kusit këto para viktimia ia kishte kthyer e më pas ia kishte kërkuar sërish. Viktima Nozlli u kishte premtuar dy punonjësit të policisë shitjen e dy pistoletave nga 1 mijë euro secila. Sipas vendimit të masës së sigurisë, ditën e ngjarjes Nozlli ka takuar policët. Nozlli ka takuar njërën nga pistoletat ai u ka marrë atyre shumë e 1750 eurove. Më pas u ka thënë se

do të takonte kushërinë e tij Kusin për të marrë pistoletën tjetër. Sipas hetimeve Nozlli ka takuar Kusin dhe me anë të një taksie kanë udhëtuar drejt Qafë-Kërrabës, ku pas dy ditësh Nozlli u gjend i vdekur. Gjatë deklarimeve në polici, Kusi ka pranuar se ka qenë ai autor i vrasjes se Nozllit. Kusi pretendon se viktimën e kishte të afërt dhe se ky i kishte borxh shumë prej 650 eurosh. Ditën e ngjarjes ata janë takuar së bashku dhe kanë shkuar në Kërrabë pasi viktimia i ka thënë Kusit se atje do të gjente shumë e parave për t'ia kthyer. Gjatë rrugës Kusi pretendonte se viktimia ia ka dhënë paratë. Më pas, kur kanë arritur në Kërrabë viktimia i ka marrë Albanos një pistoletë që ky i fundit e mbante pa leje për shkak të hasmërive që kishte fisi i tij dhe nën kërcënimin e pistoletës viktimia ka kërkuar të marrë sërish paratë e dhëna disa çaste më parë. Në përleshje Albano Kusi pretendonte se arma është shkrehur pa dashje dhe Nozlli ka rënë për tokë i vdekur. Po ashtu, po në këtë vit Albano së bashku me disa persona të tjerë grabitën një kazino. Nga kjo grabitje ka mbetur i plagosur me armë zjarri punonjësi i sigurisë në këtë kazino, Nexhat Muca 34 vjeç. Por për kryerjen e veprave të rënda penale nuk mbetet pas as vëllai tjetër i tij, Griseldo Kusi. 31-vjeçari në vitin 2011 është arrestuar nga policia pasi ka tentuar të vrasë shtetasin Maksut Hysa. Ngjarja ndodhi në fshatin Mnik të Tiranës, ku Griseldo Kusi ka tentuar të vrasë Maksut Hysin. Po ashtu në vitin 2012 Griseldo ishte bërë pjesë e një tjetër historie kriminale. Kjo ngjarje ka ndodhur në janar të 2012 ku Griseldo Kusi ka tentuar të

BABI I 26-VJEÇARIT: SIKUR TË KISHA FUQI, NUK E DI SE ÇFARË DO TË BËJA

Familja Çelaj në fshatin Ngraçan të Fierit ka hapur dyert e mortit, ndërkohë babai i të riut u shpreh për mediat që kjo që i ndodhi atij mos i ndodhte njeriu dhe se ishte një fatkeqësi jo vetëm për të, por për të gjithë shoqërinë e vendit tonë. Kjo është një fatkeqësi e madhe në Shqipëri. Ti nishesh në punë dhe kthehesh i vdekur është fatkeqësi" të thotë Baftjari, babai i Indritit. Ai madje tregoi se vdekjen e djalit e mori vesh nga media. "Kjo është fatkeqësi e madhe. Djali ishte në punë, punonte me kondicionerë se ka mbaruar edhe elektri. Montonte kondicionerët." Ai tha se "djali im është vranë në 11 paradite, unë e mora vesh në orën 19:00 në darkë. Rrallë gjën djalë si ai, nuk dinte të ofendonte, ishte i matur. Ma morën djalin në moshë të re". Mes dhimbjes i ati i 26-vjeçarit duket se nuk ka besim as të drejtësia. "Po që se janë këta politikanë që janë në këto 30 vjet, të ndyrë, të fëlliqur, Shqipëria nuk bëhet", tha ai i revoltuar, duke mos pasur besim as te drejtësia.

ELVIS GURRA: JAM PAGUAR PËR VRASJE NGA ANËTARË TË FAMILJES KUSI

Akuzat për familjen Kusi sa vinë e shtohen si të përfshirë në ngjarje të ndryshme kriminale në kryeqytet. Elvis Gurra, i dënuar me 20 vite burg për një tentativë vrasjeje, ka denoncuar në media se është paguar nga anëtarë të familjes Kusi, disa vite më parë për vrasjen e dy personave. Përmes telefonit ai ka thënë se dy vëllezërit i kanë ofruar një shumë të madhe parash prej 70 mijë euro për të vranë dy persona, vrasje e cila ka mbetur në tentativë. Sipas Gurra për këtë ngjarje ai ka marrë vetëm 3 milion lekë. Gurra ka deklaruar se materialet i ka referuar në prokurori, por askush nga vëllezërit Kusi nuk është thirrur ndonjëherë. Ndër të tjera Gurra zbuloi se Festim Dushku e ka lidhur me vëllezërit Kusi, ndërkohë që ka shtuar se i ka denoncuar për disa vite rresht, por askush nuk i ka shoqëruar. Ai ka hedhur dhe akuza edhe ndaj organeve të drejtësisë dhe politikës duke thënë se ka tentuar të bashkëpunojë me prokurorinë, por ata janë të korruptuar. Gjithashtu ai është shprehur se këtë familje e mbështet një njeri me pushtet.

DYSHOHEN PËR "PASTRIM PARASH", FAMILJA KUSI PREJ DY VITESH NËN HETIM

Detaje të reja kanë dalë në dritë nga ngjarja tronditëse në kryeqytet, kur dy fëmijët e pronarit Bujar Kusi, kanë vranë punonjësin e kondicionerit, sepse ky i fundit pikonte. Burime zyrtare bëjnë me dije se prej vitit 2017, familja Kusi është nën hetim nga Prokuroria e Krimeve të Rënda për "Pastrim Parash". Një grup i madh personash nga ky fis vijoje në të jenë në hetim, duke qenë se akuzohet për një "grup të strukturuar kriminal", për disa ngjarje të ndodhura në kryeqytet. Ndërkohë, ka mjaftuar kjo ngjarje, për të mësuar se një pjesë e punimeve në këtë ndërtesë, ku do të bëhej një lokal në pronësi të Bujar Kusit, ishin pa leje. Një grup me punonjësit të IKMT-së kanë mbërritur në godinë, për të bërë verifikimin e ndërtesës. Lidhur me këtë ngjarje po hetohet një punonjësi i bashkisë sepse duhet të kishte pezulluar punimet, sepse ai kishte tejkalluar lejen që i kishte dhënë bashkia. Ndërkohë, ndërtesa ishte e gjitha me leje.

vrasë me armë zjarri Boiken Spahiun, duke qëlluar katër herë në drejtim të tij. Ky i fundit arriti të shpëtojë me një plumb në shpatull. Ngjarja ndodhi rreth orës 01:30 të natës, kur Spahi po kthehej në shtëpi me makinën e tij tip "Benz" me targë TR 3582 S. Sapo ka kaluar semaforin në rrugën "Muhamet Gjollështa". Sipas policisë në atë kohë u tha se atentati u bë për shkak të prishjes së

pazareve të drogës. Por paravarsisht këtyre krimeve të vëllezërve Kusi, drejtësia i ka lënë të lirë duke dhënë dënime minimale. Dy vëllezërit me krime të rënda mbi supë, kanë shkaktuar kështu edhe krimin e radhës, duke i marrë jetën 26-vjeçarit Indrit Çelaj, pasi kishte shkuar në vilën e familjes Kusi për të rregulluar kondicionerin. Ndërkohë që ata janë përsëri në lirë edhe pse në kërkim nga policia.

Çekaj apelon menjëherë vendimin: Më rrezikohet jeta

Kokaina në Durrës, Gjermania ndez dritën jeshile për ekstradimin e Arbër Çekajt në Shqipëri, ja detajet

Elvis MYRTA

Kur ka kaluar rreth një vit e gjysmë nga arrestimi i Arbër Çekajt në Gjermani, 40-vjeçari pritet të ekstradohet në vendin tonë. Ka qenë shkalla e parë e një gjykate gjermane ajo e cila ka pranuar kërkesën e palës shqiptare për ekstradimin e tij. Arbër Çekaj refuzon të ekstradohet në vendin tonë, për këtë ka kërkuar dhe azil në Gjermani, nëpërmjet avokatit të tij ka apeluar vendimin. Tashmë do të jetë Gjykata e Apelit gjermane ajo që do të vendosë nëse 39-vjeçari, i konsideruar nga ish ambasadori Donald Lu si "peshku i madh", do të ekstradohet apo jo drejt vendit tonë. Vendimi për ekstradimin është dhënë nga drejtësia gjermane rreth 20 ditë më parë nga Gjykata Penale e Dusseldorf. Edhe në këtë seancë, Arbër Çekaj ka kërkuar të mos ekstradohet me argumentin se në Shqipëri i rrezikohet jeta. Procesi në Gjermani i ka hapur rrugën edhe atij në Shqipëri pasi mësohet se Çeka ka marrë informacionin se është në një proces gjyqësor dhe e ke dhënë OK-in për zhvillimin e seancave ndaj tij. Për sasinë më të madhe të drogës të kapur ndonjëherë në vendin tonë, prokuroria ka ngritur akuza ndaj tre personave, shoferit të kontenerit, menaxherit të firmës dhe administratorit. Seanca e radhës ndaj të pandehurve do të zhvillohet në 16 shtator. Ndërkohë që, prej më shumë se 1 viti Arbër Çekaj i njohur ndryshe edhe me mbiemrat Kuliçaj dhe Jansen po mbahet në Gjermani ku edhe u arrestua një vit më parë, ndërsa autoritetet shqiptare tashmë janë duke pritur ekstradimin e tij.

Mbyllja e hetimeve

Në fund të majit të këtij viti Prokuroria e Krimeve të Rënda ka mbyllur hetimet dhe ka dërguar për gjykim dosjen e 613 kg kokainë të kapura në kamionin me banane në Durrës rreth një vit më parë. Për këtë çështje, organi i akuzës ka çuar si të pandehur Arbër Çekaj, Armando Pezaku



dhe Donaldo Lushaj. Ndaj tyre prokuroria ka ngritur akuzën për trafikim ndërkombëtar të lëndëve narkotike në kuadër të grupit të strukturuar kriminal. Tashmë do të jetë gjykata që do të vendosë nëse do ta pranojë apo jo për gjykim dosjen ndaj tyre. Armando Pezaku ishte shoferi i trailerit që transportonte ngarkesën me banane në të cilën u kap sasia rekord e drogës. Ndërsa Donald Lushaj ishte menaxheri i firmës "Arbri Garden" në pronësi të Arbër Çekaj, që kishte porositur ngarkesën nga Kolumbia. Çekaj ndodhet në Gjermani, ku edhe atje ka një hetim nga autoritetet pasi dyshohet se ai është i përfshirë në aktivitet kriminal edhe në territorin e tyre. Në shkurt 2018 u kapën rreth 613 kg kokainë në Maminas në kontenerët e bananeve të Arbri Garden në pronësi të Arbër Çekaj, "Last Snow", apo "Bora e fundit" ishte operacioni i Policisë së Shtetit, ku u sekuestruan 613 kg kokainë me vlerë tregu 180 milionë euro dhe solli arrestimin e dy 25-vjeçarëve Donaldo Lushaj dhe Armando Pezaku, mëngjesin e 27 shkurtit. Droga mbërriti në Portin e Durrësit, më 19 shkurt, ndërsa operacioni u krye, më 27 shkurt, kur edhe u magazinua në ambientet e firmës "Arbri Garden" shpk. Kokaina e kapur prej 613

Tashmë do të jetë Gjykata e Apelit gjermane ajo që do të vendosë nëse 39-vjeçari, i konsideruar nga ish ambasadori Donald Lu si "peshku i madh", do të ekstradohet apo jo drejt vendit tonë. Vendimi për ekstradimin është dhënë nga drejtësia gjermane

kg e vendosur në pako të vogla u shkarkuan nga një anije që vinte nga Kolumbia nëpërmjet Italisë dhe Maltës, e më pas me anije ka mbërritur në Portin e Durrësit në Shqipëri, në datën 19 shkurt 2018. Hetimet kanë dokumentuar se lënda narkotike ishte e fshehur në kontener me dyshe me dyfishitë, të ngarkuar me banane. Operacioni ka nisur gjatë mbërritjes së datës 27 shkurt 2018, në Portin Detar të Durrësit, në momentin që ngarkesa e ligjshme me banane, u mor në dorëzim nga firma porositëse "Arbri Garden" shpk, me pronar

shtetasin Arbër Çekaj. Sasia e lëndës narkotike ishte e paketuar në 528 pako, të mbështjella me letër natriban me kode të vendosura nga trafikantët. Konteneri i mbërritur në Portin e Durrësit, u mbajt nën vëzhgim të pandërprerë deri sa mbërriti në magazinat e firmës, nga strukturat e Policisë së Shtetit. Shërbimet e Policisë kanë rrethuar në perimetrimin e jashtëm objektin e më pas kanë ndërhyrë në brendësi të magazinës. Pas kontrollit të intërsishëm të kontenerit, kanë bërë të mundur gjetjen dhe sekuestrimin e lëndës narkotike.

Droga e kapur në Peloponez, Policia e Shtetit: Nuk ka lidhje me Shqipërinë

Policia e Shtetit ka reaguar pas publikimit të lajmit në mediat greke se një mjet lundrues i kapur në Peloponez me lëndë narkotike, dyshohet se ka ardhur nga Shqipëria. Mësohet se policitë e të dyja vendeve kanë shkëmbyer informacion, dhe të ndaluarit janë shtetas nga Ukraina. Nga verifikimi i bërë në regjistrat e PKK Sarandë, Himarë, Vlorë, Porti Jahteve Oriku dhe QNOD, për disa muaj, mjeti lundrues "Veleria MY DREAM" i kapur me drogë dhe dy personat ukrainas në bord, nuk kanë hyrje-dalje në Shqipëri. Njëkohësisht gjatë kësaj periudhe nuk është konstatuar as nga QNOD e as nga Policia Kufitare asnjë rast i dyshimtë, i ndonjë mjeti lundrues që të ketë lundruar në drejtim të Greqisë, apo të vendeve të tjera fqinje, sqaron policia. Më tej nënvizohet se Policia Kufitare shkëmben në vijimësi informacion me homologët, me qëllim parandalimin dhe goditjen e rasteve të trafikimit të lëndëve narkotike nëpërmjet kufijve.

Në kërkim për falsifikim dokumentesh, ekstradohet nga SHBA 32-vjeçari

Një shtetas i dënuar në Shqipëri për falsifikim të dokumenteve është ekstradohet nga SHBA. 32 vjeçari me inicialet D. M., ishte dënuar dhe në SHBA, ku ka kryer 5 vite burg për veprën penale "Vjedhja me armë, kryer në bashkëpunim". Në Aeroportin "Nënë Tereza" me ndihmën e Agjencisë për Emigracionin dhe Doganave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ICE-ERO), Shërbimi Diplomatik i Sigurisë në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Tiranë (DSS), u ka dorëzuar specialistëve të Z.Q.K. Interpol Tirana 32-vjeçarit me inicialet D. M. Ky shtetas ka vuajtur dënimin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pasi ka qenë i dënuar me 5 vjet burg nga Gjykata e Illinois/SH.B.A, me vendim penal nr. 10CR217, datë 11.05.2011, për veprën penale "Vjedhja me armë, kryer në bashkëpunim". Gjithashtu ky shtetas është shpallur në kërkim ndërkombëtar, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka dënuar për veprën penale "Falsifikimi i vulave, stampave ose formularëve".

Në kërkim për trafik droge, ekstradohet nga Gjermania 21-vjeçari

Një i ri është ekstraduar dje nga Gjermania drejt vendit tonë, pasi ishte shpallur në kërkim për trafik droge. Policia njofton se është ekstraduar 21-vjeçari me inicialet A. Xh., lindur në Gjoricë të Epërme, Dibër. I riu ishte shpallur në kërkim për veprën penale nga autoritetet tona për veprën penale, "Trafikim të lëndëve narkotike" në bashkëpunim, mbetur në tentativë. Gjykata e Tiranës për këtë të arrestuar kishte caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg" për veprën penale "Trafikim i lëndëve narkotike" në bashkëpunim, mbetur në tentativë. Sipas njoftimit të policisë në datë 29.04.2017 oficerët e policisë kufitare kanë sekuestruar 104,75 kg kanabis sativa, të cilën shtetasi me inicialet A. Xh., ka tentuar ta trafikojë nëpërmjet kufirit tokësor drejt Maqedonisë së Veriut. Interpol Tirana vijon bashkëpunimin me homologët për kapjen e personave në kërkim ndërkombëtar brenda dhe jashtë vendit, me qëllim përballjen e tyre me drejtësinë e vendeve të cilat i kanë shpallur në kërkim.

Vetëdorëzohet administratori i "Gega Oil", gjykata e liron menjëherë

Gjykata e Tiranës ka caktuar masën e sigurisë detyrim për tu paraqitur kundrejt garancisë pasurore për administratorin e Gega Oil, Paulin Gegën. Kujtojmë se ky i fundit u shpall në kërkim nga policia rreth dy javë më parë me urdhër të Prokurorisë së Tiranës dhe mësohet se ai është vetëdorëzuar ditën e mërkurë. Edhe në një reagim për mediat në datën 10 gusht, administratori i Gega Oil, tha se nuk ishte në arrati por me pushime me familjen dhe se do të ishte i gatshëm për drejtësinë. Gjatë seancës për masën e sigurisë, Gega u përfaqësua nga avokati Artan Hajdari, ndërsa përfaqësues i akuzës ishte prokurori Kolë Hysenaj. Duke iu

referuar njoftimit të Policisë së Shtetit, hetimi për Paulin Gegën, nisi për veprat penale "Fshehja e të ardhurave", "Ndryshimi në aparatet matëse" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale". Policia tha dy javë më parë se në datë 7 gusht kishte kryer kontrole për veprimtarinë e tatimpaguesit "Gen Klaudis Sha", në vijim të zbatimit të Planit të Masave kundër Informalitetit dhe Evazionit Fiskal në sektorët e Turizmit, Ndërtimit, Hidrokarbureve, Tregtimit të mallrave me akcizë. Nga kontrolli tatimor, sipas bluve janë gjetur pompa, të cilat në shkelje të ligjit, funksiononin në regjim manual dhe për këtë arsye, është kryer bllokimi i tregtimit

të karburantit nga ky subjekt. Pas bllokimit, policia tha se janë kryer hetime që kanë çuar në konkluzionin se administratori i kompanisë, shtetasi Paulin Gega, përmes subjektit "Gen Klaudis Sha" që njihet me emrin tregtar "Gega Oil", ka kryer evazion fiskal në përmasa të konsiderueshme. Pas referimit të policisë, prokuroria nxori një urdhër ndalimi për Gegën, i cili rezultoi se ishte larguar nga vendi në datë 09.08.2019. "Shtetasi Paulin Gega u shpall në kërkim për veprat penale "Fshehja e të ardhurave", "Ndryshimi në aparatet matëse" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale", njoftoi policia rreth dy javë më parë.



kronike

34-vjeçari futej natën në banesa dhe vidhte orëndi

Ishte kthyer në makthin e Durrësit, arrestohet hajduti serial, brenda një muaji vodhi 13 banesa

Elvis MYRTA

Një 34 vjeçar u kap "mat" dhe nga policia, teksa kishte hyrë për të vjedhur një banesë, vetëm pak pasi kishte grabitur një tjetër. Ndërkohë që pas arrestimit në flagrancë, hetimet zbuluan se i riu është autor i të paktën 13 vjedhjeve në qytetin bregdetar të Durrësit. Në prangat e uniformave blu të qytetit bregdetar përfundoi shtetasi me inicialet D. A., 34-vjeç. Arrestimi i tij u bë në sajë të finalizimit me sukses të operacionit "Periferi". Ky person ka qenë i dënuar me parë për vjedhje. Sipas policisë, hajduti futej në shtëpi gjatë orëve të natës dhe merrte sende me vlerë, celularë, plazma, bizhuteri dhe para. Në cilësinë e provës janë sekuestruar materiale telefona celularë dhe vlera monetare. Kanë qenë Specialistët për Hetimin e Krimin në Komisaratin e Policisë Durrës në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, të cilët pas një pune profesionale dhe hetimore kanë zbardhur vjedhjet që shtetasi me inicialet D. T., ka realizuar.

Vjedhjet e kryera nga 34-vjeçari

Nëpërmjet një deklarate për mediat, policia e qytetit bregdetar të Durrësit tha se pas arrestimit të 34-vjeçarit nga kryeqyteti ka zbardhur dhe dokumentuar plot 13 vjedhje që ky shtetas ka bërë. Sipas uniformave blu i riu ka kryer edhe dy vjedhje brenda një dite. Ai hynte në banesat që kishte piketuar për të vjedhur, në kohën kur pronarët e tyre nuk ndodheshin aty apo kur binin për të fjetur gjumë. Sipas hetimeve policore, mësohet se vjedhjen e parë ai e ka bërë më datë 04.07.2019. Natën e nxehtë të katër korrikut, në lagjen Nr. 15, Durrës 34-vjeçari,



Ky person ka qenë i dënuar me parë për vjedhje. Sipas policisë, hajduti futej në shtëpi gjatë orëve të natës dhe merrte sende me vlerë, celularë, plazma, bizhuteri dhe para. Në cilësinë e provës janë sekuestruar materiale telefona celularë dhe vlera monetare...

dyshohet se ka vjedhur banesën në pronësi të shtetasit me inicialet A. T., ku ka marrë një televizor plazma. Tre javë më pas, më konkretisht më datë 28.07.2019, në fshatin Xhafzotaj, Durrës, ai do të bënte goditjen e radhës. Sipas policisë dhe provave të mbledhura, dyshohet se ai ka vjedhur vlera monetare në banesën e shtetasit me inicialet Z. I. 34-vjeçari do të qëndronte dy javë pushim duke mos kryer më asnjë vjedhje. Por në muajin gusht, muaj në të cilin shumë turistë vizitojnë qytetin e Durrësit 34-vjeçari do të kryente disa vjedhje të njëpasnjëshme. Më datë

10.08.2019, në lagjen Nr. 18 Durrës dyshohet se ka vjedhur në banesën e shtetasit me inicialet E. M., 20 vjeç, një telefon celular dhe vlera monetare. Pas 24 orësh ai ka hyrë në banesën e shtetasit me inicialet G. V., ku dyshohet se ka vjedhur një televizor. Por ai nuk është ndalur me kaq, pasi më datë 11.08.2019, dyshohet se ka vjedhur një televizor në banesën e shtetasit me inicialet L. K.. Më datë 20.08.2019, gjatë natës, ky shtetas dyshohet se ka tentuar të vjedhë banesën e shtetasit A.M., banues në lagjen Nr.14/1. Një ditë më pas, më datë 21.08.2019, gjatë natës, në Arapaj,

Durrës, 34-vjeçari i vënë dje në pranga, dyshohet se ka vjedhur një televizor plazma dhe disa bizhuteri në banesën e shtetasit me inicialet N. A. Po natën e 21 gushtit, ky shtetas ka hyrë në banesën e shtetasit me inicialet B. C., e cila ndodhet në lagjen Nr. 15, Durrës, ku ka tentuar të vjedhë në këtë banesë, por pa ja arritur qëllimit. Duke mos arritur të vjedhë në banesën e shtetasit B. C., i riu po në lagjen nr.15 ka hyrë banesën e shtetasit me inicialet Z. M., ku ka vjedhur një televizor plazma. Pas vjedhjes së dy banesave dhe tentativës së një tjetre, një ditë më pas, gjatë natës së datës 21 gusht po në lagjen nr. 15, i riu dyshohet se ka vjedhur sërish një televizor plazma. Më datë 22.08.2019, gjatë natës, në fshatin Rrashbull, Durrës dyshohet se ka vjedhur me thyerje banesën e shtetasit me inicialet A. Q. dhe ka marrë disa bizhuteri. Sapo mbaroj punë në banesën e shtetasit të lartpërmendur ai nuk është larguar nga fshati Rrashbull, por ka thyer banesën e shtetasit me inicialet R. S. dhe ka marrë dy telefona celularë dhe vlera monetare.

Të fshehur në trajlerin me portokaj, kapen 8 afganë në kufi

Tetë afganë janë ndaluar nga policia kufitare në tentativë për të kaluar në mënyrë të paligjshme në territorin shqiptar. Burime zyrtare bënë me dije dje se Policia Kufitare e Kakavijës së bashku me doganën e Kakavijës dhe forcat e FRONTEX kanë kapur tetë shtetasit afganë të cilët kishin hipur në trajlerin e një mauneje e cila vinte nga Greqia, e mbushur me portokaj. Gjithë udhëtimin afganët e kanë kaluar duke ngrënë portokaj, ku për dy prej tyre ishin krijuar edhe probleme shëndetësore, të diarresë. Shoferi i kamionit është një 21-vjeçar nga Mali i Zi me inicialet B. R.. Ai është shoqëruar në ambientet e komisarariatit të Kakavijës, ku ka dëshmuar se nuk kishte dijeni që në trajlerin mbushur me portokalle të ishin edhe emigrantët e paligjshëm. Kamioni është bllokuar ndërsa shoferi malazez po merret në pyetje nga autoritetet. Ndërkohë mësohet se afganët po marrin trajtim shëndetësor dhe me ushqime, ndërsa pasi gjëndja e tyre të stabilizohet ato do të deportohen në Greqi.

Mat, plagosi me çifte 60-vjeçar, arrestohet në Lezhë autori

Një 35-vjeçar është arrestuar nga policia për shkak mbrëmjen e së enjtes rreth orës 22:10 në fshatin Baz ka plagosur me armë gjahu 60-vjeçarit me inicialet A. Gj.. Në prangat e uniformave blu të Matit përfundoi shtetasi me inicialet F. Gj., 35 vjeç. I plagosuri fillimisht është dërguar në spitalin rajonal të Burrelit dhe pas marrjes së ndihmës mjekësore atje u transportua për në spitalin e Traumës në Tiranë, për një mjekim më të specializuar për shkak të plagëve të marra. Burime nga bluzat e bardha të Traumës bëjnë me dije se i moshuari ndodhet nën kujdesin e mjekëve dhe fatmirësisht është jashtë rrezikut për jetën. Autori i plagosjes së 60-vjeçarit, pasi kreu krimin është larguar menjëherë nga vendi i ngjarjes. Ai u vu në pranga nga Policia në Lezhë, ndërsa tashmë do të përballlet me drejtësinë për plagosjen. Blutë thonë se ndërkohë po vijoje punën për sqarimin e shkaqeve të konfliktit që përfundoi me përdorimin e armës së zjarrit.

Vodhën makinën me vlerë 100 mijë euro, pranga dy shqiptarëve

Dy të rinj shqiptarë janë arrestuar nga autoritetet italiane me akuzën e vjedhjes së banesave, kryesisht në zonën e Veriut, në Milano. Për të çuar deri në fund planin e tyre për të vjedhur një shtëpi, ata grabitën një makinë BMW, me vlerë 100 mijë euro. Njëri prej policëve të komisarariatit të Cinisello Balsamo, ndërsa po shkonte në punë vuri re dy burrat që ishin në BMW-në 645, e parkuar në oborrin e një banese në, ku shoferi mbante një dorezë. Nga verifikimi i targës, zbulohet se ajo është e vjedhur nga një Fiat, ndërsa BMW-ja ishte vjedhur në Breshia më 9 gusht, ndërsa ishte në pritje të regjistrimit, shkruan "Il Giornale". 27-vjeçari u arrestua menjëherë, ndërsa miku i tij arriti të shpëtojë për rreth njëqind metra përgjatë Rrugës "Aosta", ku u arrestua pas një përlëshje, nga e cila mbeti i lënduar edhe një agjent policie. Në makinë u gjetën mjete të ndryshme të përdorura nga hajdutët për të kryer vjedhje, ndërsa në shtëpi u zbuluan sendet e vjedhura përfshirë varëse dhe orë të shtrenjta.

Plagosi 25-vjeçarit se i ngacmoi të dashurën, i riu arrestohet pas një viti

Një 23-vjeçar është arrestuar nga policia për shkak se ishte shpallur në kërkim për një plagosje me armë zjarri të ndodhur rreth një vit më parë. Në prangat e uniformave blu të kryeqytetit përfundoi Albert Gjonpalaj. Në momentin e arrestimit të riut i është gjetur me vete edhe një pistoletë, e cila ishte mbushur me 5 fishekë. Arrestimi i tij ka ardhur edhe falë bashkëpunimit të policisë me qytetarët, i cili ndodhej në një lokal në rrugën "Teodor Keko". 23-vjeçari nuk është një emër i panjohur për drejtësinë, pasi ai rezultoi i dënuar më parë për edhe për vjedhje me dhunë. Gjithashtu mësohet se Gjonpalaj ishte akuzuar edhe për një grabitje të ndodhur tek ish-hotel

"Sheratoni", ku u morën 180 mijë dollarë, por më pas ishte liruar për mungesë provash. I arrestuari do të përballlet me akuzat për veprat penale "Vrasja me dashje, e mbetur në tentativë" në bashkëpunim dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit". Më 13 maj të vitit 2018, Gjonpalaj se bashku me një tjetër person, i identifikuar si Xhoni Hitaj zbrazën karikatorin e pistoletës ndaj shtetasit me inicialet A. B., dhe me pas u larguan nga vendi i ngjarjes me një makine tip "Opel", të ndihmuar nga një person tjetër, i cili kishte lidhje shoqërore me autorët. Hitaj, i cili është me origjinë nga Librazhdi, rezultoi person me precedentë të mëparshëm

penalë. Mësohet se ai është arrestuar në vitin 2016 për kanosje të tre personave. 23-vjeçari, së bashku me një shokun e tij, ishin konfliktuar me tre të rinj në rrugën "Nuçi Naçi" në kryeqytet dhe i kishin kërcënuar me armë. Në atë kohë, Policia i gjeti atij një pistoletë me 10 fishekë dhe materialet iu referuan Prokurorisë për kanosje dhe armëmbajtje pa leje. Këta dy shtetas, në bulevardin "Bajram Curri" pas një konflikti për motive të dobëta kanë tentuar të vrasin me armë zjarri shtetasin me inicialet A. B., 25 vjeç, banues në Tiranë. Mësohet se motivi i sherrit që çoi në përdorimin e armeve ishte se i plagosuri kishte ngacmuar të dashurat e dy autorëve.



Ja zhvillimet në Shqipëri para rënies së komunizmit

Amerikanët zbardhin detajet e zhvillimeve më 1990, ja si Ramiz Alia nisi të jepte sinjale se do linte pushtetin, nga vota e fshehtë, te kufizimi i posteve në parti

Amerikanët kanë hedhur dritë mbi zhvillimet e vitit 1990, të cilat i paraprinë rrëzimit të regjimit komunist. Gazeta "New York Times", ka treguar se si Ramiz Alia që në këtë vit po jepte sinjale se po i vinte fundit diktaturës. Ata kanë renditur disa prej zhvillimeve që solli ai.

Shqipëria nis epokën e ndryshimit 20 qershor 1988

Disa vjet më parë udhëheqësit në Shqipëri, vendi më i izoluar i Evropës, ndaluan praktikën e detyrimit të të huajve të disinfektoshin para se të hynin në vend, që nuk ishte shumë si sinjal i parë, por të paktën ishte një fillim. Vaska me disinfektant në kufirin me Jugosllavinë ishte bërë për t'u mbrojtur nga sëmundjet, por diplomatët thonë se ishte një mesazh për përcmimin ndaj botës së jashtme, nga Moskë, në Uashington deri në Pekin. Tashmë sinjalet kanë ndryshuar pak. Shqipëria mbetet vendi i vetëm ateist në botë dhe statujat e Stalinit ende dominojnë qytetet e vendit, ashtu si Policia Sekrete që shtrëngon fort frerët ndaj disidencës. Megjithatë udhëheqja në Tiranë ka nisur hapjet duke vendosur marrëdhënie me Spanjën, Gjermaninë Perëndimore e Kanadanë. Më vonë, këtë vit kryeministri grek Andreas Papandreu do të bëhet udhëheqësi i parë i Perëndimit që viziton vendin komunist që prej marrjes së pushtetit të partizanëve komunistë të Enver Hoxhës. Sipas specialistit britanik Geoffrey Stern, ka gjithashtu shenja modeste të zbutjes së kontrollit ekonomik brenda vendit. Stern tha në një intervistë telefonike se ndryshe nga vende të tjera komuniste, njëfarë transparence e re e Shqipërisë nuk përshatet plotësisht me parimin e "glasnost" të mbrojtur nga udhëheqësi sovjetik Mikhail S. Gorbachev. Tiranë është prishur me Bashkimin Sovjetik në 1961 dhe nuk ka pasur më të bëjë me Moskën. Stalini tashmë dënohet si diktator në BRSS ndërsa në Shqipëri ai është ende pjesë e zburimeve shtëpiake. "Nisja e procesit të reformave mund të shihej në Shqipëri që para ardhjes së Gorbachov," thotë Stern. Sipas tij një nga arsyt është prishja e marrëdhënieve me Kinën dhe ndalimi i ndihmës së saj ekonomike. Stern thotë se teknikët kinezë kur u larguan morën me vete planet e projekteve industriale që po ndërtonin, prandaj Shqipëria po kërkon tjetërkund teknologji për t'i përfunduar ato. Kur Hoxha vdiq në 1985, u zëvendësua nga Ramiz Alia, ideologu i partisë që po kërkon ndryshimin. "Kemi një seri lëvizjesh drejt decentralizimit, drejt ndryshimit të pagave mes profesioneve, duke nisur nxitjet profesionale, edhe pse në fazat e para", thotë Stern. Ka konsensus mes studiuesve të Shqipërisë se ashtu si Gorbachov, dhe Alia përballet me rezistencë nga figurat konservatore të stabilimentit, të cilët janë mbledhur rreth vejjshës



Prej kohësh në qeverinë shqiptare nuk ka pasur Ministri të Drejtësisë. Të dyshuarit thjesht arrestoheshin, akuzoheshin dhe nxirreshin para gjyqit ose prokurorëve shtetërorë. Por së shpejti do të krijohet Ministria e Drejtësisë dhe avokatët e mbrojtjes do të lejohen të përfaqësojnë të akuzuarit që prej momentit të arrestimit.

së Hoxhës. "Alia po has rezistencë për lëvizjet," tha një diplomat perëndimor. Vendi prej 3 milionë banorësh ruan ende traditat e tij komuniste; praktikimi i fesë ndalohet, ashtu si automobilat privatë, si dhe shënimi me kryqe i varrezave të pakicës kristiane. Ndërsa për të ndaluar depërtimin e të huajve, Kushtetuta shqiptare ndalon huat nga vende të huaja. Ajo është vendi më i varfër në Evropë dhe në treg ka mungesa të produkteve bazë si qumështi. Turistët lejohen vetëm në grupe të shoqëruara, ndërsa ata që kanë mjekër duhet të vizitojnë berberin në pikën kufitare për një rruajtje të detyruar. Historikisht, Italia ka qenë dritarja e Shqipërisë ndaj Perëndimit prej televizionit të saj, ndërsa së fundmi është hapur një linjë tragetesh përmes Adriatikut. Por edhe Greqia vitet e fundit ka nisur të konkurrojë

si mike e Tiranës në hapjen e saj të kujdesshme me botën e jashtme. Zyrtarët grekë për shembull, marrin meritat e bindjes së Shqipërisë për të marrë pjesë në Konferencën Ballkanike të Beogradit në shkurt. Greqia ka interes të veçantë ndaj Shqipërisë prej minoritetit të saj atje që sipas saj arrin në 200 000 në jug. Kryeministri Papandreu është përpjekur të joshë Tiranën vitet e fundit me ato që kundërshtarët e tij thonë se janë tolerime të panevojshme, pa marrë garanci për të drejtat e minoritetit grek-folës. Tashmë Greqia ka hequr dorë nga pretendimet territoriale për jugun e Shqipërisë. Në të njëjtën periudhë, vizitorët grekë në Shqipëri u rritën me 1,265 në vitin 1985 në rreth 6,000 vitin e kaluar. Numri i shqiptarëve grekë që lejoheshin të vizitonin Greqinë u rrit nga 42 në vitin 1983 në më shumë se 500 në 1987.

Shqipëria nxiton drejt asaj që quan 'demokratizim' 22 mars 1990

Pa shumë zhurmë Shqipëria ka nisur një program afatgjatë të asaj që udhëheqja e vendit quan "demokratizim" të institucioneve sociale ekonomike të vendit. Tipare të këtij programi përfshijnë proces zgjedhor për drejtorët e ndërmarrjeve industriale dhe bujqësore në fshat, debate publike për ndryshime në arsim dhe decentralizim në sistemin e ashpër të planifikimit ekonomik për t'i dhënë më shumë fuqi autoriteteve lokale. Pas 45 vjet politikash staliniste presidenti Ramiz Alia, kryetar i Partisë Komuniste, ka nisur të zgjerojë marrëdhëniet e vendit me Perëndimin dhe Lindjen si dhe duke zbutur politikën e brendshme.

Avokat për të akuzuarit

Zyrtarët thonë se ndryshime po ndodhin dhe në sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Prej kohësh në qeverinë shqiptare nuk ka pasur Ministri të Drejtësisë. Të dyshuarit thjesht arrestoheshin, akuzoheshin dhe nxirreshin para gjyqit ose prokurorëve shtetërorë. Por së shpejti do

të krijohet Ministria e Drejtësisë dhe avokatët e mbrojtjes do të lejohen të përfaqësojnë të akuzuarit që prej momentit të arrestimit. Përveç kësaj sipas zyrtarëve do të reduktohet numri i krimeve të dënueshme me vdekje, teksa parlamenti po punon për kodin e ri penal. Ndryshime të tjera janë njoftuar nga President Alia në një fjalim të 22 janarit në Komitetin Qendror të partisë, ku ai foli me simpati ndaj ndryshimeve që po ndodhin në Evropën Lindore vitin e kaluar, të cilat sollën rënien e komunizmit në Poloni, Hungari, Gjermaninë Lindore, Çekoslovaki, Bullgari e Rumeni. Alia ka thënë në janar se qeveria e tij do të ndjekë rrugën e "demokratizimit" duke ruajtur esencën e socializmit për të "evituar vuajtjet dhe fatin e kombeve të tjera të Evropës Lindore". Është ende herët për të gjykuar se sa të vërteta janë këto pretendime dhe në Shqipëri nuk mund të merret kollaj informacion. Por ajo që Alia ka ndërmend për vendin e tij është njëfarë revolucioni gradual, për të parandaluar që vendi të mbetet prapa zhvillimeve në Evropën Lindore. Një zyrtar tha për zhvillimet në Shqipëri: "Është në fakt momenti për të bërë ndryshime. Ne nuk kopjojmë evropiano-lindorët, kemi mënyrën tonë, por nuk e harrojmë mjedisin ndërkombëtar". "Ne nuk duam të zhdukim socializmin. Kemi marrë masa të shumta për të parandaluar atë që ndodhi në Evropën Lindore, po përpiqemi të gjejmë zgjidhje origjinale sepse në këto raste nuk mund të përdorësh teorinë". I pyetur nëse kishte opozicion ndaj ndryshimeve në Shqipëri, zyrtari përsëriti idetë e Alias duke thënë se "krijohen pengesa nga burokracia e cila është e vendosur thellë në shtet". Burokracia duket se është fjala në kod për stalinistët e vjetër të aparatit që janë mësuar t'i bëjnë gjërat sipas modelit Enver Hoxha, udhëheqësit të vjetër komunist që vdiq në 1985.

Popullata e re

Këto janë disa nga ndryshimet që janë aplikuar ose pritet të kryhen së shpejti në Shqipëri:

* Zgjedhje me votë të fshehtë në këshillat bashkiakë, ndërmarrje, ferma, Parlament dhe në organizatat.

* Kufizim me 10 vjet të mandatëve në poste qeveritare, me analizë të performacës pas pesë vjetëve dhe mundësinë e shkarkimit nga kolegët. Mandati i zyrtarëve të partisë kufizohet në 5 vjet, kurse ai i deputetëve të parlamentit në 12 vjet.

* Transferim i autoritetit të ministrive te zyrtarët lokalë apo ndërmarrjet individuale.

* Nisja e motivuesve të prodhimit në industri e bujqësi, duke lejuar lëvizjet e çmimeve për disa mallra konsumi.

Udhëheqja Alia duket se po i bazon reformat e saj në të rinjtë e Shqipërisë, duke parë dhe që mosha mesatare në vend është 27 vjeç. Në një takim me nxënës e studentë këtë muaj të transmetuar në televizion Alia tha: "Të rinjtë janë një forcë revolucionare. Jeta e të rinjve duhet jetuar dhe debati revolucionar duhet zhvilluar, për të evituar shtypjen e të rinjve nga manifestimet e burokracisë dhe formalizimit".

20 prill, 1990

Qeveria e Shqipërisë, një nga regjimet më radikale komuniste në botë, ka sinjalizuar sot se dëshiron të ketë marrëdhënie me Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimin Sovjetik. Ndryshimi i politikës publike të armiqësisë me Moskën e Uashingtonin kërkoi rreth tre dekada, teksa presidenti Ramiz Alia tha se si rezultat i zhvillimeve ndërkombëtare "ka rihyrë në axhendë problemi i rivendosi së marrëdhënieve me SHBA dhe Bashkimin Sovjetik". Në një fjalim të gjatë të martën në Komitetin Qendror të partisë, i cili u publikua sot nga Agjencia telegrafike Shqiptare, Presidenti Alia përmendte "boshllëkun e gjerë" që ndante vendin e tij me dy superfuqitë dhe shtoi se miqësia do të pritet me miqësi.

Oferta që prej 1974

"Nëse tani Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik, siç pretendojnë ata, dëshirojnë të ndryshojnë qëndrimin ndaj Shqipërisë, ne nuk kemi arsye të mos e mirëpresim," tha Alia, Sekretari i Parë i partisë prej pesë vitesh. Sipas zyrtarëve të Departamentit të Shtetit nuk ka pasur diskutime direkte mes zyrtarëve të dy vendeve për marrëdhëniet diplomatike, edhe pse Shtetet e Bashkuara kanë bërë oferta të vazhdueshme për hapje me Shqipërinë që prej vitit 1974. Më e fundit ishte më 28 nëntor, Ditën Kombëtare të Shqipërisë, kur shërbimi shqip i Zërit të Amerikës transmetoi një deklaratë të drejtorit të çështjeve të Evropës Lindore në DASH, James W. Swihart, i cili tha se "sigurisht që ne nuk shikojmë pengesa" në vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Tiranën si dhe shtoi se administrata është "është gjithmonë e gatshme për dialog".

k o m e n t e & a n a l i z e

Basha na thuaj një ofertë të ndërkombëtarëve refuzuar nga Rama!

Nga Bardhyl BEJKO

Studio më e freskët televizive me moderator Çim Pekën nuk kishte si të çelte siparin ndryshe, veç me të intervistuarin e parë, kryetarin e PD-së, Lulzim Basha. Deri këtu nuk ka asgjë të keqe dhe nuk mund të paragjykohet se ky televizion është i sponsorizuar nga opozita apo familjar që e kanë udhëhequr atë ndër vite. Edhe nëse është i tillë pak rëndësi ka. Le të jetë një zë opozitar, i fuqishëm, alternativë dhe të kompensojë sadopak boshllëkun e mungesën e opozitës në institucione. Këtu nuk ka vend as për incidentin e rrëzimit të studios gjatë intervistës. TV-të tek ne zor të mbeten njëqind për qind të paanshme. Themelore është të mos jenë totalisht të njëjës palë dhe të të shndërrohen në tellall a gramafona të liderëve përkatës. Duke lënë mënjanë pavarësinë e mediave vizive, le të ndalemi tek një pjesë e intervistës së zotit Basha. Jo për fabulën e mollëve të kalbura me korbin grabitqar që fluturoi mbi shportën plotë dhe përzgjedhi, jo mollët e cilësisë së parë, bio-t, ato ekstra, siç janë vetëcilësuar deputetët mandat-djegur dhe larguar nga tempulli i demokracisë demonstrativisht, po Rudina Hajdarin e kritikun e ashpër Murizin e Kokën, si të blerë nga Rama. Në psikikën e kryedemokratit, është ngulitur thellë ideja, se ata që nuk iu bindën, janë të blerë dhe sponsorizuar nga mazhoranca, ashtu sikundër ata që u futën pas divorcit të partisë që kryeson me Kuvendin. Të gjithë këta deputet të blerë? Sa shumë i kanë kushtuar Ramës! Bëhet fjalë për individë të përzgjedhur me dorën e tij ata që sot i anatemon dhe i barazon me kalbësira, si ushqim për shpendët më grabitqarë, korbin e zi që përfaqëson sjellësin e fatkeqësive midis kolonisë së shpendëve. Po etiketimi i "dezertorëve" nuk është asgjë para justifikimit të mungesës së marrëveshjes dhe dialogut apo kthimit në institucione me braktisjen flagrante dhe pa asnjë arsye madhore apo parimore, po për të vetmen logjikë, se pasi ka bërë llogaritë ka dalë humbës dhe për këtë arsye e largoi partinë drejtë rrugës dhe shesheve. Kur u pyet për qëndrimin e partisë që kryeson, si do jetë platforma në muajin shtator dhe cila do jetë strategjia politike që do ndjekë, si do luftojë për t'iu qasur institucioneve dhe të rifitojë e rehabilitojë staturën e politikanit vizionar dhe partisë demokratike, si një force politike moderne dhe luajale, siç ka qenë në vitin 1990, e transformuar sot në parti jashtë sistemit, pa u menduar asnjë sekondë, Basha deklaroi, para shqiptarëve, se të gjitha u bënë pasi Rama nuk la mundësi të tjera. Na i mbylli shtigjet. I blindoi portat, se ai nuk iu përgjigj asnjë oferte të ndërkombëtarëve. Shqiptarët kur dëgjojnë këtë deklaratë të kryepozitarit të thënë nga kolltuku i studios së TV-së, me një vetësiguri absolute, vënë buzën në gaz dhe sigurisht e gjykojnë Bashën si një individ jo koherent, siç duhet të jetë një kryetar partie dhe pretendent për kolltukun e kryeministrit, po të papërgjegjshëm, gënjeshtar, mashtrues dhe hipokrit që nuk i jep vlerë fjalës dhe nuk ka raporte korrekte me të vërtetën. Të flasësh për oferta të kundërshtuara të ndërkombëtarëve, sikur kryeministri u ka ngritur prita propozimeve racionale të SHBA dhe BE-së dhe u ka thënë jo ofertave të tyre në drejtim të zgjidhjes së krizës që realisht është krizë e vet opozitës dhe jo e sistemit, kur realisht je ti dhe partia që drejton së bashku me forcat e tjera në koalicion që nuk ke dëgjuar askënd që të ka



ftuar për respektim të institucioneve, demokracisë, kushtetutës, për t'u bërë pjesë integrale e reformave të mëdha. Je ti që i shmangesh çdo këshille dhe sugjerimi nga ata që e kanë orientuar demokracinë në Shqipëri kah progresit dhe janë bërë garantët e rrugëtimit drejt Evropës. Është vërtetë e dhimbshme, e papranueshme, e shëmtuar dhe jashtë çdo logjike të një politikani që e mban veten të moderuar dhe me pretendime të mëdha për t'u sjell shqiptarëve, një rend të ri, "Republikën moderne", pa oligarkë, pa korrupsion dhe të gënjeshtër nën dritën e prozhektorëve. Të vepros në këtë mënyrë kur shitesh si misionar për t'u dhënë të gjithëve drejtësi e dhe mirënie. Kronikat e kohës, sot shkruhet në mijëra mënyra. Politika bëhet faqe të gjithëve. Është nën vëzhgimin e rreptë dhe sytë e medias vizive dhe asaj të shkruar. Qëndrimet e secilit janë të monitoruara nga qytetarët. Të sinkronizuara në filmimet e shumta. Të incizuar nga qindra kamera që qëndrojnë mbi kokën e secilit politikan. Në këtë kontekst, deklaratat e mospranimit dhe refuzimit të ofertave të miqve dhe ndërkombëtarëve nga Rama që i ka kundërshtuar dhe ai ka nxitur bojkotin e protestat pasi nuk i ka lënë mundësi tjetër PD dhe opozitës, është jashtë logjike, një lojë si në filmat e animuar. Cilën ofertë ka refuzuar Rama? Në këto dy-tre vite në Shqipëri është duke u hartuar një reformë tërësore e drejtësisë. Kush ka refuzuar dhe mosvotuar ligjet dhe platformat e serviuara nga institucionet e SHBA dhe BE-së? Rama në lidhje me reformën në drejtësi, ka deklaruar se është dakord me çdo platformë opozitare. Mjafton të ketë firmën dhe vulën e SHBA-së. Është refuzim apo pranë pa kushte deri në ekstrem një qëndrim i tillë?! Në sallën e Parlamentit deputetët e PD-së dhe LSI-së, gjatë tërë kohës nuk kanë debatuar. Ata kanë sulmuar dhe futur në sallë frymën e konfliktit fizik. Kanë shkruar të armatosur. Atje ku debatohet e përgatiten ligjet, armët kanë zvendësuar ligjëratat. Kanë sulmuar me veze, me bojë, me çizme, shishe, flakadan, deri edhe me gaz me ngjyrë mazhorancën. A u penguan qoftë edhe njëherë të vetme të flasin çfarë të duan dhe si kohë më shumë se mazhoranca? Kur është refuzuar Basha, Berisha apo Kryemadhi një herë të vetme? Atëherë kush i refuzoi e nuk i dëgjojnë ndërkombëtarët? Kush i injoroi ftesat pafund për mos ti djegur manadatet, Rama apo Basha me koalicionistët e tij që aplikuan brex pa marrëveshje me padurim dhe e shpallën këtë braktisje si fitore të demokracisë, vetëm se ikën nga salla e Kuvendit? Jo njëherë, po dhjetëra herë nga përfaqësues të lartë të SHBA-së, si Ndhimës Sekretari Jashtëm amerikanë Palmer, britanikët, homologët e

Gjermanisë, Italisë, përfaqësuesit më të rëndësishëm të BE dhe KE-së, Mogherini, Fleckenstein, Hann, e shumë personalitete kërkuan që opozita të qëndronte në institucione, të vepronte si një parti demokratike, larg mentalitetit të luftës dhe betejave në rrugë. Ofertat ndërkombëtare u kundërshtuan fuqimisht, pa asnjë pendesë, pikërisht nga Basha. Dhe sot e shet këtë refuzim si mospranim nga mazhoranca. Kulmin, hedhja poshtë e ofertave dashamirëse për ta vendosur sistemin politik dhe faktorët vendim-marrës në shina, ishte qëndrimi flagrant i bojkotit të zgjedhjeve të 30 qershorit dhe rrëmujës para dhe pas votimeve. Besoj se askush nuk ka harruar si Lulzim Basha me koalicionistët, në sinkron me LSI-në e Metën, refuzuan prerazi pjesëmarrjen në zgjedhjet e pushtetit lokal, duke krijuar një precedent të panjohur në vendet demokratike. Kush nuk iu drejtua Bashës dhe nuk e këshilloi të mos kryente një akt të tillë të panjohur më parë? Kush nga zyrtarët më të lartë të partive aleate të tij, deri tek partitë e majta e të qendrës, institucionet e politikë-bërjes së BE-së e OS-BE-së nuk i kërkuan me forcë Bashës të tërhiqej nga aventurat e braktisjes flagrante të zgjedhjeve?! Po ai nuk i dëgjoji. Zërat e ndërkombëtarëve i la të endeshin nëpër mjegullën detare, si zëri i Sirenavë të Odiseut të legjendës, nga frika se mund të ta robëronin kryepozitarin dhe ta kthenin në bregun e realizmit. Po edhe këto oferta, i denigroi, i përbuzi. Me fodullëk e çoi partinë, jo në kutitë e votimit, po depove të dinamitit dhe molotovëve. Ushtria e militantëve në vend të shkonte në zgjedhje, marshoi rrugëve dhe bllokoi KZAZ-të e QV-të, dogji e shkatërroi shkolla për ti zhbërë zgjedhjet. Vazhdimisht, zërat e arsyeshëm të Perëndimit i kanë ofruar zgjidhje demokratike pa dhunë Bashës. Po ai i ka injoruar me shpresën se kështu ishte më komod. Se në këtë mënyrë fitonte famë dhe respekt, si qëndrestar që nuk pyet, jo të këtushmit, po deri fuqitë që i japin tonin politikës së globit. Sa oferta ka djegur Basha? Sa funksionarëve të huaj miq, iu ka mbyllur portat para fytyrës?! Nuk ka një qëndrim të vetëm, ku partia e Bashës të ketë thënë: "Yes Sir! Faleminderit zotëri! Jemi gati për t'iu bashkuar institucioneve. Të hymë në gara dhe të japim kontributin tonë për rrugëtimit drejt BE-së." Përditë refuzime. Bllokada. Kundërshtimi. Ultimatumet. Zmbrapsje. Mospëlqime. Asnjëherë dakordësi. Po cila është rruga Basha? Si do silltet në shtator? Do pranohet oferta e brendshme dhe ato ndërkombëtare apo do jetë refraktar, mur që nuk luan, në rrugë? Dhe në fund të lajë gojën si gjithnjë: Rama nuk pranoi asnjë ofertë të PD-së. Refuzoi faktorin ndërkombëtar. Kjo nuk e bën më të moderuar as më të fortë Lulzim Bashën!

Të flasësh për oferta të kundërshtuara të ndërkombëtarëve, sikur kryeministri u ka ngritur prita propozimeve racionale të SHBA dhe BE-së dhe u ka thënë jo ofertave të tyre në drejtim të zgjidhjes së krizës që realisht është krizë e vet opozitës dhe jo e sistemit, kur realisht je ti dhe partia që drejton së bashku me forcat e tjera në koalicion që nuk ke dëgjuar askënd që të ka ftuar për respektim të institucioneve, demokracisë, kushtetutës, për t'u bërë pjesë integrale e reformave të mëdha. Je ti që i shmangesh çdo këshille dhe sugjerimi nga ata që e kanë orientuar demokracinë në Shqipëri kah progresit dhe janë bërë garantët e rrugëtimit drejt Evropës. Është vërtetë e dhimbshme, e papranueshme, e shëmtuar dhe jashtë çdo logjike të një politikani që e mban veten të moderuar dhe me pretendime të mëdha për t'u sjell shqiptarëve, një rend të ri, "Republikën moderne", pa oligarkë, pa korrupsion dhe të gënjeshtër nën dritën...

■ Misionet arkeologjike kërkojnë të zbulojnë gjëra të reja që hedhin dritë për qytetin antik

Francezët dhe italianët “zbërthejnë” arkeologjinë shqiptare, misione germimi në Apoloni dhe Rubik

Arkeologjia shqiptare është vënë në “lupën” e francezëve dhe italianëve. Prej disa ditësh misione arkeologjike nga Franca dhe Italia kanë nisur gërmimet në Apoloni dhe Rubik për të ndihmuar në zbulimet e reja që do të hedhin dritë në studimin e qytetit antik. Në fakt, që nga viti 1992 ekspeditat janë një bashkëpunim shqiptaro-francez, të cilat kanë në fokus zonën e Akropolit dhe pjesën e sipërme të agorasë së qytetit të Apolonisë. Lidhur me këto misione germimi ka reaguar edhe ambasada e Italisë ditën e djeshme. Përmes një postimi në rrjetet sociale, ambasada italiane ka shpërndarë foto nga puna e ekspertëve që po japin kontributin e tyre. Sipas ambasadës, grupi i ekspertëve italianë është i përqendruar tek zona e Rubikut për të nxjerrë në pah pasuritë minerare të asaj zone. “Projekti “Të dhëna arkeologjike dhe të teledetektuara për studimin e peizazheve minerare në Shqipëri”, financuar nga Ministria e Jashtme Italiane do të përqendrohet veçanërisht në zonën e Rubikut me qëllim njohjen e pasurisë minerare shqiptare dhe stimulimin e interesit kundrejt pikave më të rëndësishme. Grupi i punës përbëhet nga arkeologë, topografë dhe gjeologë me përvojë, të koordinuar nga Dr. Pasquale Merola, drejtues i misionit dhe aero-topograf i CNR. Udhëtimi i parë i punës drejt Shqipërisë parashikohet në data 1-5 tetor 2019”, thuhet në reagimin e ambasadës italiane. Pak ditë më parë gërmimet në parkun arkeologjik të Apolonisë nxorën në sipërfaqe një granatë dore që mendohet se i përket Luftës së Parë Botërore. I gjithë territori u rrethua me perimetër sigurie dhe pranë vendit ku është gjetur granata shkuan edhe forcat policore. Në vendin e ngjarjes ishte edhe ekspedita franceze e cila po gërmonte në atë zonë.

Gërmimet e para

Gërmimet e para në Apoloni filluan nga arkeologu austriak Camilo Praschniker në vitin



Prej disa ditësh misione arkeologjike nga Franca dhe Italia kanë nisur gërmimet në Apoloni dhe Rubik për të ndihmuar në zbulimet e reja që do të hedhin dritë në studimin e qytetit antik. Në fakt, që nga viti 1992 ekspeditat janë një bashkëpunim shqiptaro-francez, të cilat kanë në fokus zonën e Akropolit dhe pjesën e sipërme të agorasë së qytetit të Apolonisë...

1916-1918. Arkeologu francez Leon Rey, i filloi gërmimet në vitin 1924 deri më 1938 në qendrën monumentale të Apolonisë. Gërmimet sistematike filluan nga shqiptarët në 1947 nga arkeologu Hasan Ceka, pjesë e Institutit të Arkeologjisë në Tiranë. Gërmimet u realizuan dhe vazhduan me një bashkëpunim shqiptaro-rusë nga 1958-1960, me arkeologët Selim Islami, Hasan Ceka dhe V. Blavatski. Pas vitit 1961 gërmimet u realizuan nga Instituti i Arkeologjisë në Tiranë me një sërë arkeologësh si: Hasan Ceka, Aleksandra Mano, Burhan Dauti, Vangjel Dimo, Bashkim Vrekaj, Lami Koco etj.. Që nga viti 1992 ekspeditat janë një bashkëpunim shqiptaro-francezë të cilat kanë në fokus zonën e Akropolit dhe

pjesën e sipërme të agorasë së qytetit të Apolonisë. Më herët në parkun arkeologjik të Apolonisë, në Fir nisi ekspedita arkeologjike shqiptaro-franceze, e cila i përqendroi gërmimet tek banesat romake të shekullit të III pas Krishtit, ku është zbuluar busti i një atleti dhe busti në bronz i një femre. Arkeologu shqiptar, Lami Koçi u shpreh pak kohë më parë se në parkun arkeologjik të Apolonisë ka ende për të gërmuar, pasi pjesa më e madhe e saj është ende e pazbuluar. Po arkeologu ngriti si shqetësim faktin se për të kryer të tilla gërmimesh nevojitet një buxhet i lartë. “Por për të kryer gërmime të shumta kërkohen investime dhe mbështetje financiare më të mëdha”, u shpreh arkeologu Lami Koçi.

Pas “Derë e hapur”, filmi “The Van” në garë mes 14 filmash për “Zemrën e Sarajevës”

Filmi “The Van” po garon me 14 filma të tjerë për të fituar “Zemrën e Sarajevës”. Lajmi është bërë i ditur nga ministrja e Kulturës, Elva Margariti. Përmes një postimi në rrjetet sociale, Margariti deklaroi se kjo garë nuk është vetëm për të fituar çmimin, por për të vijuar garën më pas edhe për çmimet Oscar. “Pas konkurrimit në Cannes, ku garonte mes 9 filmave më të mirë nga e gjithë bota, dhe pas fitores së çmimit si filmi më i mirë i shkurtër në Molise Cinema Film Festival, “The Van”, filmi me regji të Erenik Beqirit është në garë për “Zemrën e Sarajevës”. Ai konkurren mes 14 filmash nga e gjithë Europa,

jo thjesht për një çmim, por për t’u kualifikuar në një garë më të madhe, atë të Çmimeve Oscar. Suksese Erenik! Jemi krenarë për ty!” tha ministrja e Kulturës, Elva Margariti. Filmi “The Van” (Furgoni), nga Erenik Beqiri konkurren për herë të parë në festivalin e filmit në Kanë në kategorinë e filmave me metrazh të shkurtër në maj të këtij viti.

Filmi flet për një djalë rreth të 20-ve i cili ka si qëllim të emigrojë jashtë vendit. Në mënyrë që të fitojë lekët e duhura sa me shpejt, ai pranon të bëhet pjesë e disa ndeshjeve që zhvillohen brenda një furgoni. Rregullat e furgonit janë të thjeshta, dyert mbyllën dhe furgoni nis në një trajektore rutinë, duke u kthyer në pikën e nisjes. Dyert hapen dhe nga aty mund të dalë vetëm një fitues. Kujtojmë që dy ditë më parë ishte edhe filmi “Derë e hapur” i cili garon në Festivalin e Sarajevës. Personazhi kryesor është Elma. Ajo është një vajzë shqiptare që jeton ilegalisht në Itali. Elma mban në bark një fëmijë , por babai i fëmijës gjendet në burg. Autoritetet italiane e deportojnë atë në Shqipëri. Kur kthehet, Elma ndodhet në udhëkryq dhe nuk di kujt t’i drejtohet për ndihmë. Ajo vendos të shkojë tek motra e saj e madhe, Rudina. Të dyja motrat nisin një rrugë të gjatë me makinë dhe drejtohen për tek shtëpia e babait të tyre tradicional.



Aktorja Ilire Vinca mbështet shembjen e Teatrit Kombëtar

■ Aktorja dhe regjisorja Ilire Vinca ka dalë në mbështetje të shembjes së Teatrit Kombëtar. Qëndrimin e saj e bëri të ditur ditën e djeshme kryeministri Edi Rama në rrjetet sociale. Sipas këtij qëndrimi, për aktoren, teatri i ri do të krijonte më shumë mundësi. “Po të kishte mundësi të ndërtohej një teatër i ri në vendin ekzistues do të ishte mrekulli. Teatri është zhvilluar shumë në vendet tjera për nga ana teknike, ç’ka iu mundëson artistëve të sjellin në jetë kreativitetin e tyre, madje edhe

i frymëzon për gjetje të reja. Përveç kësaj, një teatër i ri do të krijonte mundësi edhe teknike për punëtorët e teatrit dhe organizimin e shfaqjeve. Nga ana tjetër, edhe për audiencën do të ishte një freski. Uroj të bëhet sa më shpejt”, citoi kryeministri Rama, qëndrimin e aktore dhe regjisores Vinca. Prej disa ditësh kryeministri shpërndan qëndrime të aktorëve dhe regjisorëve të ndryshëm, si për të mbështetur aksionin që qeveria ka nisur për të shembur teatrin aktual dhe ndërtimin e një të riu.

Marrëveshja mes GKA dhe universitetit për studentët nis zbatimin

■ Nis jetëzimi i marrëveshjes së nënshkruar mes Galerisë Kombëtare të Arteve dhe Universitetit të Arteve të Bukura ndërmjetësuar nga Ministria e Kulturës në kuadër të paktit për universitetin. Koordinator i projektit, Ermir Hoxha tha dje për mediat se 10 studentë kanë shfaqur interes që në fazën e parë për pozicionin e vëzhguesit në sallat e ekspozimit. Ata do të sigurojnë dhe mbrojnë veprat e artit në salla nga dëmtimet me dashje apo pa dashje gjatë orarit të vizitave.

“Ky bashkëpunim shihet edhe si një hap i rëndësishëm për integrimin e të rinjve në institucionet hije renda”, theksoi Hoxha. Studentët do të jenë pjesë e projekteve të ndryshme jo vetëm në shërbime, por edhe në koncepte artistike. Nga ana tjetër ky angazhim konvertohet edhe në kredite. Në muajt në vijim projekti do të zgjerohet dhe do të jetë i hapur për të gjithë studentët, të cilët do duan ta përqafojnë këtë bashkëpunim, pasi institucionet nuk kanë vënë afat kohorë në marrëveshje.

Ministria e Mjedisit dëgjesë për nxjerrjen e gurëve dekorativë

■ Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Përfundimit të Ministrisë së Mjedisit kanë organizuar dje një dëgjesë publike me përfaqësues të firmave të nxjerrjes së gurit dekorativ në fshatin Novaj. Vendi i zgjedhur për takimin ishte fshati Kapinovë, ndërsa pjesëmarrja e punonjësve të Bashkisë së Poliçanit në këtë takim u bë shkak për debatet e ashpra që u krijuan mes palëve në fillim të takimit. Për gati 30 minuta dëgjesa publike u shndërrua në një arenë të ashpër de-

batesh. Pronarët e firmave të gurit dekorativ e kanë cilësuar formal dhe pa kuptim të ashtuquajturën dëgjesë publike, pasi siç u shprehën vetë ata në takim, firmat e kanë fituar gjyqin me ADZM-në dhe Ministrinë e Mjedisit. Pas vendimit të Gjykatës Administrative që rrëzoi VKM-në e qeverisë për shpalljen e Malit të Tomorrit “Park Kombëtar”, pronarët e firmave kanë kërkuar rishpallimin e menjëhershëm të punës në zonën e Novajt dhe arsyet se përse po pengohen me polici për të filluar punën.

Çudira tek Luftëtari, shkarkohet Dalipi një ditë para ndeshjes, vjen Duro

Kategoria Superiore startoi zyrtarisht dje me kryendeshjen Kukësi-Partizani, por nga ana tjetër, një pjesë e skuadrave gjenden në krizë ende pa nisur mirë gara dhe dy prej tyre mund të konsiderohen Flamurtari e Luftëtari. Ky i fundit ka bërë një lëvizje që i ka habitur të gjithë, pasi ndryshon trajnerin 24 orë para se të nisë gara dhe në Gjirokastër duket se ky sezon do të prodhojë çudira të mëdha. Dhe në fakt, nuk kanë fund çuditat te Luftëtari i këtij sezoni. Sepse, siç thamë, vetëm një ditë para ndeshjes debutuese në kampionat ndaj Tiranës, bluzinjtë kanë ndryshuar trajner. Klevis

Dalipi i cili kishte rreth një muaj që stërviste Luftëtarin është larguar nga stoli i skuadrës gjirokastrite duke dhënë dorëheqjen pas disa mosmarrëveshjeve me drejtuesit e klubit. Në vend të ish-trajnerit të Partizanit te bluzinjtë është emëruar menjëherë Klodian Duro i cili në këto 3 javë e gjysmë ka mbajtur rolin e drejtorit sportiv te Luftëtari. Largimi i Dalipit një ditë para startit të kampionatit ka ardhur si një rrufe në qiell të hapur. Drejtuesit e Luftëtarit nuk kanë arritur marrëveshjen mbi termat e kontratës dhe kjo është arsyeja që mëngjesin e kësaj të premtjeje, 43-vjeçari nga

Elbasani ka braktisur skuadrën. Tashmë detyrën e vështirë për të ringritur Luftëtarin do ta ketë ish-mesfushori i kombëtares shqiptare Klodian Duro. Kështu, drejtimi i skuadrës i është besuar Klodian Duros. Ish-trajneri i Kukësit dhe Kamzës në Kategorinë Superiore, tashmë do të nisë një aventurë të re në Gjirokastër. Duro do të synojë që të mbajë Luftëtarin në Superiore edhe sezonin e ardhshëm, ndërkohë që puna e tij nis që sot, ndërsa ndeshja e parë e Duros luhet nesër. Luftëtari do të debutojë në kampionat ndaj Tiranës në "Selman Stërmasi".



■ Gol, kartonë të verdhë e të kuq, rivalitet e në fund fitore për Kukësin, që e nis sezonin me fitore


Kukësi hakmerret ndaj Partizanit, fiton 1-0 në një duel që i pati të gjitha

Adriatik BALLA

Kampionati i 81-të kombëtar i futbollit, Kategoria Superiore, startoi dje me kryendeshjen e javës së parë, atë ndaj Kukësit dhe Partizanit, mbyllur me fitoren e verilindorëve 1-0. Ishte një hakmarrje e fortë e skuadrës kuksiane, për humbjen që i shkaktoi Partizani një javë më parë në finalen e Superkupës së Shqipërisë, në kohën shtesë (4-2), duke bërë që jo vetëm t'i thyente të kuqtë në një duel direkt mes rivalësh për titull, por njëherësh një duel domethënës për startin e garës, pasi kampionët në fuqi, "demat e kuq", e nisnin me humbje këtë sezon. Pra Kukësi fitoi dhe mori tri pikë në duelin e zhvilluar me të kuqtë në "Elbasan Arena", ndërsa "demat" e nisnin me humbje, por në një kampionat me katër faza, ku ka shumë duela direkte, gjithçka është e rikuperueshme dhe e hapur. Sot pritet të luhen katër takimet e tjera të javës së parë, ku veçanërisht me interes pritet Tirana, e cila ka bërë goditje të forta në këtë merkato vere.

Ndeshja/ Partizani "shkurorëzohet, Kukësi hakmerret për Superkupën"

Dje startoi zyrtarisht gara për edicionin e ri dhe nisi nga stadiumi i ekipit kombëtar në "Elbasan Arena". Pas një ceremonie të organizuar nga FSHF-ja në stadiumin e Elbasanit, startoi edhe sfida e që pa fillimisht Kukësin të bënte presion lart dhe të tentonte të vërë në vështirësi kampionët në fuqi të Shqipërisë. Me kalimin e minutave



verilindorët morën kontrollin e lojës dhe arritën t'i afrohen disa herë rrezikshëm portës së "të kuqve", të cilët nga ana tjetër tentuan të organizohen me kundërsulm, por pa qenë të rrezikshëm. Minuta e 39-të solli edhe rastin vendimtar të takimit, kur Limaj kapi topin para rumunit Boldor në zonë dhe arriti t'i "vjedhë" një 11-metërshtet. Trajneri Duro ia besoi penalltinë Vasil Shkurtajt, i cili u tregua i saktë përballë Alban Hoxhës dhe arriti të kalojë verilindorët në avantazh, duke shënuar njëkohësisht golin e parë të kampionatit. Pjesa e dytë nisi me dy ndërrime për Partizanin, me trajnerin Lerda që tentoi të përforcojë repartin e avancuar, për të ndryshuar edhe shifra e rezultatit, ndërsa në minutën e 62-të të dy skuadrat mbetën me nga 10 lojtarë. Sulmuesi Solomon, i hedhur në fushë në fillim të pjesës

së dytë, u përplas me mbrojtësin Bruno Lulaj, ndërsa arbitri Enea Jorgji vendosi t'i dërgojë të dy në dhomat e zhveshjes për reagimet dhe kundër-reagimet jospportive ndaj njëri-tjetrit. Minutat në vijim panë më kërkues Partizanin, që duke shfrytëzuar një gjendje fizike më të mirë se kundërshtari, zhvendosi lojën në gjysmefushën e veri-lindorëve dhe kërcënoi disa herë kuadratin e mbrojtur nga Ilir Avdyli. Pas 6 minutave shtesë, arbitri Jorgji vërsheleu tre herë për të sinjalizuar përfundimin e takimit të parë të sezonit 2019-2020, që shkoi në favor të verilindorëve, të cilët treguan që në fillim se do të jenë favoritët kryesorë për titullin kampion. Gol, penallti, kartonë të kuq, grintë dhe rivalitet të lartë sportiv. Ndeshja e parë e sezonit të ri i pari të gjitha, ndërsa përveç marrjes së 3 pikëve të para, Kukësi

KATEGORIA SUPERIORE

JAVA E PARË

Të premtën	
Kukësi-Partizani	1-0
Të shtunën	
Vllaznia-Laçi	16:00
Skënderbeu-Luftëtari	19:00
Tirana-Luftëtari	19:00
Teuta-Bylis	19:00

bëri edhe një lloj "hakmarrjeje" ndaj Partizanit, për disfatën në Superkupën e Shqipërisë, një javë më parë. Për ekipin e Safet Gjicit ky ishte vërtet një start domethënës, ndërkohë që të kuqtë shfaqën edhe një herë dobësi në sulm, duke u konfirmuar se nuk kanë alternativa të mira në vijën e parë ofensive.

Abazaj: Ja pse nuk luajta ndaj Partizanit

Një nga afrimet më të bujshme të Kukësit, Kristal Abazaj, në prag të sfidës me Partizanin për mikrofonin e "Supersport", ka pohuar: "Besoj se pas një periudhë të gjatë, javën që vjen do të jem në fushë pasi për shkak të dokumentacionit nuk do të luaj ndaj Partizanit. Do të jap më të mirën time që skuadra të arrij më të mirën në realizimin e synimeve. Mendoj se kam bërë një zgjidhje të mirë që të fitoj minuta dhe të kap formën time më të mirë". "Kukësi ka objektiva madhorë ndaj kam ardhur këtu, kështu që shpresoj që të fitoj titullin dhe të luaj në Europë me Kukësin", tha Kristal Abazaj, sulmuesi që u rikthye në Shqipëri pas eksperiencave jo të suksesshme në Belgjikë dhe në Kroaci.

LËVIZJA

Kosova merr edhe Dresheviqin, tjetër përforcim për Europeanin

"Futbollisti shqiptar, që është për-caktuar të luajë për Kosovën, Ibrahim Dresheviq, i lindur në Suedi, ka marrë dje edhe zyrtarisht lejen e FIFA-s për ta përfaqësuar Kosovën në nivel ndërkombëtar". Këtë e konfirmoi Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi. FFK-ja thotë se institucionet shtetërore përshpejtuan dukshëm procedurat për pajisjen e Dresheviqit me shtetësinë dhe pasaportën e Kosovës dhe në këtë formë mundësuan që lënda e kompletuar e futbollistit të shqyrtohej me shpejtësi nga FIFA që mori vendimin e prituri. Në këtë formë Dresheviq do të jetë në dispozicion të selektorit Bernard Shalond që nga ndeshjet e shtatorit.

KLUBI

Flamurtari bën goditjen e radhës, një ditë para ndeshjes

Flamurtari vijon me prezantimet e reja nga dita në ditë dhe tashmë skuadra vlonjate duket se po merr formë. Ditën e sotme, klubi vlonjat ka prezantuar një tjetër futbollist dhe bëhet fjalë për një talent që vjen si përforcim për mesfushën. Romedo Llapi është afrimi më i ri në skuadrën e parë, duke qenë se ishte pjesë e të rinjve të Flamurtarit. Mesfushori i lindur në vitin 2002, shihet si një nga mesfushorët më të mirë në moshat e Flamurtarit, gjë e cila i ka shtyrë drejtuesit t'i ofrojnë një kontratë me ekipin e parë. "Romedi Llapi është zyrtarisht futbollist i Flamurtari Football Club. Mesfushori i dalë nga akademja U17 Flamurtari F.C nga sot i bashkohet ekipit të parë.

KOSOVË

Drenica poshtëron Llapin, tripletë për rikthim dinjitoz në garë

Pas humbjes ndaj Feronikelit, Drenica ka gjetur fitoren e parë në kampionatin kosovar, në ndeshjen ndaj Llapit. Sfida e parë e javës së dytë përfundoi me rezultatin 3-0 për Drenicën, që arriti të zgjidhë fatin e takimit vetëm në pjesën e dytë, kur edhe shënoi të tre golat. Harmon zhbllkoi sfidën në minutën e 52-të, ndërsa Mziu arriti të dyfishojë shifrat 10 minuta më vonë. Golin e sigurisë për Drenicën e shënoi Elshani në minutën e 73-të, ndërsa Llapi nuk arriti të tregojë asgjë në këtë takim. Java e dytë e IPKO Superligës së Kosovës do të vijojë sot me dy takime dhe të dielën me dy ndeshje të tjera, ndërsa sfida mes Prishtinës dhe Dukagjinit është shtyrë për më 25 shtator.



Suksesi/ Talenti i kombëtares U-19 firmos për 3 vite në Angli

Ka plot lojtarë shqiptarë që kanë talent dhe kualitet e mundësi të luajnë në kampionatet elitare europiane, duke u bërë shembuj për bashkëmoshatarët e tyre. Rezart Rama, një nga lojtarët më të talentuar të Kombëtares të moshave, ka bërë sot hapin e madh në karrierë. Ish-kapiteni i Shqipërisë U-17 dhe së fundmi U-19 ka firmosur për tri vite te klubi anglez që militon në "Championship", Nottingham Forest. "Panorama Sport" zbulon ek-

skluzivisht se prej tre ditësh lojtari ndodhet në Angli, ku kaloi me sukses vizitat mjekësore dhe sot do të prezantohet edhe zyrtarisht nga klubi anglez. Rama nuk ka mbushur ende 19 vjeç, ndërkohë që së fundmi ka luajtur me Olimpiakos U-19. Pozicioni i tij natyral është mesfushor shkatërrues, ndërsa mund të luajë edhe në qendër të mbrojtjes. Rama është titullar i padiskutueshëm i Kombëtares U-19 dhe tashmë gjasat janë që pas këtij trans-

ferimi të grumbullohet direkt nga trajneri Edi Reja. Mësohet se Rama ka prishur kontratën me Olimpiakosin dhe pasi ka dalë i lirë si lojtar, është transferuar me parametra zero te Notingham Forest. Një rol të rëndësishëm për këtë lëvizje pati edhe menaxheri shqiptar i FIFA-s, Anxhelos Veizi, i cili njihet për lidhjet që ka tek Olimpiakosi, ndërsa menaxhon edhe sulmuesin tjetër të kampionëve grekë, Emiliano Bullari, i cili është pjesë e Shqipërisë U-21.

Hysaj mbetet i Napolit, e zbulon menaxheri i futbollistit kuqezi

Shkodrani Elseid Hysaj ishte gjatë gjithë kësaj vere në faqet e para të shtypit sportiv italian, si një prej lojtarëve që kishte më shumë shanse të ndryshonte ambient, nisur dhe nga fakti se trajneri i Napolit, Karlo Anceloti, nuk e kishte shqiptarin në planet e tij taktike të sezonit të ri. U bënë disa përpjekje nga menaxherët, por në fund Hysaj nuk ka lëvizur, të paktën jo deri tani, pavarësisht se Atletico e Madridit, Tottenhami e madje dhe Junajtid kishin shprehur interesim për të. Duket se edhe pista "Roma" po shuhet ngadalë dhe siç shkruajnë medimet sportive italiane Hysaj ka gjasa të mbetet përfundimisht pjesë e Napolit edhe për sezonin

tjetër. Pra, në fillim shkodrani i Kombëtares së Shqipërisë, Elseid Hysaj, lakohej shumë këtë merkato dhe shihej si futbollisti që kërkohet nga shumë skuadra si në Spanjë, ashtu edhe në Itali e në Angli. Megjithatë, gjithçka ka marrë fund dhe e ardhmja e Hysajt mbetet e pandryshuar të paktën deri në janar, kur do të hapet sërish merkatoja. Ka qenë vetë agjenti i tij Mario Xhufredi, ai që tha se Hysaj do të jetë futbollist i Napolit. Në një intervistë të dhënë për mediat italiane, Xhufredi foli për merkaton dhe dëshirën e Biragit për të shkuar te Interi, duke bërë sërish gabim si në kohën kur shprehej se Hysaj ka dëshirë të largohet nga Napoli. "Biragi? E ardhmja

e tij vendoset nga Fiorentina, megjithatë futbollisti ka dëshirë të largohet. Nuk duhet të harrojmë se nga Fiorentina, kapi kombëtaren dhe vetë shoqëria, mund të vendosë nëse e çon apo jo te Interi. Hysaj? Ai do të qëndrojë te Napoli. Riberi? Ishte një transferim i bukur dhe entuziazëm që në Firenze ka munguar për shumë kohë. Do të jetë mirë edhe për Biragin pasi Riberi do t'i stimulojë të gjithë", u shpreh Xhufredi. Mbetet të shihet nëse do të ketë ndonjë surprizë në ditët e fundit të merkatos, por me këto qëndrime të Xhufredit, mund të besohet e Hysaj do të mbetet përfundimisht i Napolit, të paktën dhe për një vit tjetër.



Sulmuesi po kalon momente magjike me Olimpijan e Ljubjanës, do ftesë në përfaqësuese

Endri Çekiçi sinjal Rejës: Po kaloj momentin më të mirë në karrierë, pres ftesë në Kombëtare

Adriatik BALLA

Një nga futbollistët që ka pasur një ecuri mjaft të mirë gjatë javëve të fundit e gjatë muajve të fundit, qoftë dhe në Ligën e Europës ashtu dhe në duelet miqësore të verës, është sulmuesi Endri Çekiçi, i cili është pjesë e Olimpijas së Ljubjanës dhe me formën e spikatur dhe golat e shumtë, ka pretendime të marrë ftesë në ekipin përfaqësues. Çekiçi i ka kaluar të gjitha shkallët në ekipet kombëtare të moshave dhe ka luajtur edhe me skuadrën Shpresa. Ai tani pret që trajneri Edi Reja ta vlerësojë performancën e tij dhe formën e mirë që po kalon, për ta marrë një ftesë në ekipin përfaqësues. Fundja të gjithë e kanë pasur një herë të parë, janë ftuar kur kalonin momente të mira me skuadrat e tyre respektive, sikurse ka ndodhur me Uzunin, Grezdën, Ismajlin e ndonjë tjetër që kanë luajtur në kampionatin kroat, apo dhe me futbollistët të tjerë që luajnë në Zvicër apo vendete nordike. Të gjithë kanë marrë një ftesë si shans për t'u testuar, pikërisht këtë dëshiron edhe sulmuesi pogradecar, i cili i lëshon kështu sinjalin e fortë trajnerit Edi Reja, për t'ia dhënë një mundësi. Në fakt, e vërteta është se Çekiçi është kthyer në protagonist te Olimpija, ku në 17 ndeshje me skuadrën sllovene, ka arritur të shënojë 10 gola dhe të japë disa



asiste. Në një intervistë që ka dhënë për portalin sportiv shqiptar, "Vip-Sport.al", Çekiçi është shprehur se ky është momenti i tij më i mirë deri më tani, ndërkohë që shtoi se ka ende për të dhënë. Sa i përket Kombëtares, pogradecari është i bindur se këtë radhë e meriton ftesën. "Deri tani besoj se është momenti më i mirë për mua. Ndihej shumë mirë por besoj se kam akoma shumë për të dhënë. Normalisht kur erdha, kisha më shumë besim te vetja por nuk e mendoja që në kohë kaq të shkurtër të kisha këtë ecuri. Fati është një pjesë shumë e rëndësishme në karrierë. Ka pasur momente të cilat mund të kishin ndryshuar komplet karrierën por gjithçka po shkon mirë tani, kështu që jam i lumtur",

shprehet ndër të tjera Çekiçi, ndërkohë që më pas komenton një ftesë të mundshme në ekipin përfaqësues, edhe pse për momentin pranon se nuk është kontaktuar nga asnjë zyrtar, qofshin këta të stafit teknik apo drejtues të përfaqësueses e të FSHF-së. Por Çekiçi thotë se po e pret një ftesë, për shkak se po kalon një prej momenteve më të mira të karrierës së tij. "Me aq sa kam dijeni unë personalisht, deri më tani nuk ka qenë askush. Po kaloj një moment shumë të mirë edhe statistikat e tregojnë këtë. Besoj se e meritoj një shans për të qenë pjesë e ekipit Kombëtar. Unë personalisht e pres me padurim një ftesë dhe besoj se këtë radhë e meritoj pasi siç e përmenda më lart, jam në një moment realisht shumë

të mirë. Në fund, është trajneri ai që vendos dhe unë duhet vetëm të respektoj vendimin", thotë më tej Çekiçi, dukshëm i entuziazmuar dhe me besim që trajneri Edi Reja do ta ketë në qendër të vëmendjes në këtë periudhë, për t'ia dhënë edhe atij një shans. Pra sulmuesi pogradecar po kërkon një shans në përfaqësuese dhe është detyrë e trajnerit të monitorojë gjendjen e secilit dhe në fund të ftojë në Kombëtare lojtarët që janë më në formë. Dhe Çekiçi në këtë moment po bën një paraqitje të mirë me skuadrën sllovene dhe mund t'i shërbejë trajnerit Reja për ndeshjet e vjeshtës, në kuadër të eliminatoreve të "Euro-2020", i bindur se ai ka diçka pozitive për të treguar në radhët e kuqezinjve. Mbetet të shihet nëse djaloshi do të marrë një ftesë nga tekniku veteran italian, por është fakt që rivaliteti në Kombëtare ia vështirëson këtë, pavarësisht se shanset reale janë të mëdha. Duhet thënë se stafi teknik i përfaqësueses është i prirur t'u besojë më shumë lojtarëve që kanë eksperiencë dhe janë të harmonizuar me njëri-tjetrin në ekipin përfaqësues dhe në modul taktik që aplikon trajneri. Për këtë arsye, futbollistët si Balaj, Cikalleshi, Sadiku, Uzuni e ndonjë tjetër kanë më shumë shanse të marrin një ftesë nga Reja për duelet e shtatorit ndaj Francës dhe Islandës, dy përballje mjaft të rëndësishme për objektivat e skuadrës kuqezi në eliminatorët e Europeanit të vitit të ardhshëm.

SULMUESI

Muriqi rrëfen emocionet e golit tek Fenerbahçe

Skuadra e njohur turke, Fenerbahçe, e ka filluar si duhet sezonin e ri në Superligën turke, pikërisht fundjavën e kaluar dhe sulmuesi kosovar ka shënuar një supergol kundër Gezisehir Gazientep. Vedat Muriqi e ka nisur si më së miri aventurën e tij në Turqi duke shënuar supergol për Fenerbahçe. Muriqi mori një top të mirë nga Emre Belozoglu në minutën e 17-të të asaj ndeshje për t'u liruar nga një lojtarë dhe pastaj me një supergoditje shënon një supergol. Sulmuesi kosovar debutoi kështu me gol në ndeshjen e parë të Super Ligës së Turqisë me Fenerbahçen. Pikërisht ky gol i Muriqit u votua si më i miri i javës në Turqi në "BeIN Sports" të Turqisë.

SITUATA

Sadiku jashtë planeve të Levantes, ditë të vështira për bomberin kuqezi

Pas dëmtimit të rëndë që pësoi pak kohë më parë, sulmuesi shqiptar Armando Sadiku nuk po arrin të gjejë hapësira te skuadra e tij. Sulmuesi kuqezi, po stërvitet me Levanten aty ku edhe po shënon gola në stërvitje, megjithatë jo të mjaftueshëm për të bindur trajnerin. Sadiku është lënë sërish jashtë për ndeshjen e radhë në kampionat, ku Levante do të përballlet me Vilarealin. Lista e publikuar nga trajneri i Levantes, ka në përbërje të saj sulmuesin Enis Bardhi ndërkohë që Sadiku mungon për të dytën ndeshje radhazi. Kur kanë mbetur edhe pak ditë nga mbyllja e merkatos, duket se Sadiku nuk ka në plan të largohet nga Levante, por mund të rrezikojë të mbetet jashtë Kombëtares.

FUTBOLL FEMRA

Shënoi gol për Realin, por Asllani dëmtohet

Kosovare Asllani ishte futbollistja e parë në histori që nënkroi me Real Madridin. Sulmuesja shqiptare arriti të shënonte edhe një gol pak ditë më parë, por pa arritur të ndihmojë skuadrën e tij që të marrë një rezultat pozitiv pasi takimi u humb nga Real. Asllani ka qenë e pafat pasi ka pësuar edhe një dëmtim në gishtin e dorës. Asaj i është dashur t'i nënshtrohet një operacioni në ligamentin e gishtit, por nuk pritet të mungojë gjatë. Asllani mund të rikthehet në javën e parë të shtatorit, duke qenë se me një dorezë të posaçme, mund të mbrojë mirë gishtin. Asllani është ndër futbollistët më të rëndësishme te skuadra e Suedisë, skuadër me të cilën aktivizohet.

Valon Berisha po rikuperohet: Mezi pres të jap kontribut për Lacion

Një nga lojtarët më të zellshëm shqiptarë që luajnë tek lacio është padyshim sulmuesi Valon Berisha, i cili, si pasojë e dëmtimeve të shpeshta, nuk ia ka dalë të lerë gjurmë sikurse i ka aftësitë, por ai ende beson se mund të shkruajë histori me Lacion. Në fakt, mesfushori i ekipit kombëtar të Kosovës dhe Lacios, Valon Berisha, ka nxitur reagime të ashpra nga mediat dhe tifozët serbë të futbollit me veprimin e tij të fundit në llogarinë e tij në rrjetin social "Instagram".

Valon Berisha e kaloi një sezon të vështirë në fanellën e Lacios. Lëndimet e kohëpaskohshme ia pamundësuan ta gjejë formën ideale në kampionatin italian, ku ishte transferuar nga Salzburgu. Megjithatë, së fundmi mesfushori kosovar i është bashkuar ekipit të Lacios në përgatitje dhe po ushtron fort për t'u rikthyer Valoni i dikurshëm. Futbollisti i lindur dhe rritur në Norvegji shpreson ta ketë një sezon pa lëndime dhe me formë të mirë. Së fundi, ai postoi për sezonin e ri në llogarinë e tij

në rrjetin social Instagram, ku shkroi: "Edhe dy ditë deri kur të fillojë sezoni i ri. Mezi po pres. Duke u lutur për një sezon të mirë duke qëndruar i shëndetshëm dhe duke e bërë atë që e dua. Forca Lacio". Megjithatë, ajo që bie në këtë sy është se në mesin e pesë fotografive të publikuara në këtë postim, në të parën ai shihet duke e bërë shqiponjën me duar. Ky veprim i Berishës vjen pas reagimeve të shumta të medimeve serbe gjatë javëve të fundit për veprimin e sportistëve shqiptarë.



kulture

Miley Cyrus hedh poshtë akuzat: Martesa nuk mbaroi prej tradhtisë

Këngëtarja e famshme Miley Cyrus ka hedhur poshtë çdo akuzë se është ndarë nga bashkëshorti i saj për shkak të tradhtisë. Në disa postime në Twitter, këngëtarja shprehet se ajo kurrë nuk e ka tradhtuar Liam Hemsworth, me të cilin ishte në një romancë prej 10 vitesh. Cyrus, e cila tani është në një lidhje me Kaitlynn Carter, tha se nuk ka qenë kurrë më e lumtur se tani pasi gëzon një jetë të shëndetshme. Liam paraqiti kërkesën për divorc nga këngëtarja të mërkurën, pasi Miley njoftoi se i dhanë fund martesës së tyre më 10 gusht. "Unë mund të pranoj që jeta që kam zgjedhur do të thotë

se duhet të jetoj plotësisht e hapur dhe transparente me fansat e mi që i dua, dhe publikun, gjatë gjithë kohës. Ajo çfarë nuk mund të pranoj është kur thuhet se po gënjej për të fshehur një krim që nuk e kam bërë. Nuk kam asgjë për të fshehur. Mund të pranoj shumë gjëra, por nuk pranoj se martesa ime mbaroi për shkak të tradhtisë. Unë dhe Liam kemi qenë së bashku për një dekadë. Unë e kam thënë më parë dhe mbetet e vërtetë, e dua Liamin dhe gjithmonë do e dua", u shpreh Miley Cyrus. Pak ditë më parë këngëtarja me famë botërore publikoi edhe një këngë të re, e cila fliste për lidhjen e saj.



FJALEKRYQI SOT

1	2	3		4	5	6		7	8	9	10		11
12			13				14						
15		16				17					18		
	19				20					21			
22				23					24				
25			26					27					
28			29				30					31	
32		33					34					35	
	36					37				38			
39					40					41			

Horizontal

1- Njëloj si zakone. 4- Bernared ... eksplorator dhe historian spanjoll. 7- Adelina shkrimtare. 12- Është lëvizja e ajrit. 13- Institucion riedukimi. 14- I vogli i gomarcës. 15- Lumë në veri. 17- Pisha e zezë i thonë edhe çetinë. 18- Komuniteti Evropian. 19- Një figurë gjeometrike. 20- Larva, kafshë uji e sapo dalë nga veza. 21- Lloj qymyri industrial. 22- Një fshat në rrethin e Vlorës. 23- I thonë edhe çitjane apo brekushe për gratë. 24- Banushi i skenës. 25- Spiro ... protagonist i ngjarjes me anijen luftarake, motive që u bë filmi "Duel i heshtur". 26- Janë me name ato kubaneze. 27- Një shoqëri karburantesh e falimentuar tek ne. 28- Agjencia e lajmeve greke. 29- Tregim i shkurtër në vargje a prozë që ka si personazhe kafshë, bimë apo sende. 30- Një lloj uji që tregtohet. 32- Ndërmarrje tregtare. 33- Dhënie pa shpërblim, dhuratë. 34- Fshat në rrethin e Korçës. 36- Është vepër e rëndë penale. 37- Dërgoje. 38- Kafshë e egër e pyjeve ton. 39- Bashkëpunarë. Pengesë që ngrihet për një ujëmbledhës apo për të penguar vërshimin e ujërave. 41- Patrioti Vokshi.

Vertikal

1- Gamile. 2- Stacioni televiziv ... Njus. 3- Vendbanimi i Nënë Terezës. 4- Spiro aktor. 5- Organizatë terroriste në Irlandë. 6- Arturi aktor në inic. 7- Markë cigareje italiane. 8- Pjesë e shkëputur nga një opera. 9- Tip avioni luftarak rus. 10- Andrea shkrimtar në inic. 11- Tip automjeti italian. 13- Ish futbollist anglez Çarlton. 14- Luftëtar që del malit për liri. 16- Femra e qenit. 17- Notë në pentagram që tregon se një notë muzikore duhet të ulet në gjysmë toni. 18- Kompozitori Kristo ... 20- Mikrob. 21- Është kryeqyteti i Venezuelës. 22- Titull fisnik në një perandori. 23- Një qytet bregdetar turistik në Republikën e Bashkuar Arabe me kryeqytet Abu Dabi. 24- Kompozitori Daija. 25- Degë e muzikës në Institutin e Arteve. 26- Është lule dekorative. 27- Goli në Olimpikun e Romës. 29- Konica i letrave. 30- Krahina, toka, treva. 31- Veshje me kujdes, me teka, nazeli. 33- Një zonjë gjermane. 34- Barelë primitive. 35- Nevojë e ngutshme për të ngrënë. 36- Kombinati Tekstilit. 37- Ndërmarrje industriale...

SUDOKU

9		2		8									
			8	3									
6		2		7		4	1						
	5	8					4	6					
			5		9								
3	9					1	7						
	6	5		9		3		1					
			3	1									
		1			6								9

				4	3	7							
	9	2			5		3						
4		7	8				1	2					
9	6		7		2	3							
2				3							4		
		5	4		1		6	2					
	2	9			7	8		1					
	1		9			6	5						
			3	5	1								

						3							6
		5	1	8									
6		3				7	4						
5						8	7			9			
	4										2		
1		6	3										4
			9	4				1					7
								6	3	4			
4					8								

Studiuesit parashikojnë vdekjen me saktësi të frikshme

Një analizë gjaku mund të parashikojë nëse do të vdisni brenda 10 viteve të ardhshme dhe shifra e frikshme e saktësisë është 83%. Një ekip shkencëtarësh në Holandë zbuluan se duke u bërë matje 14 substancave metabolike në gjak, ata mund të parashikojnë nëse një person mund të vdesë apo jo në 10 vitet e ardhshme. Shkencëtarët morën të dhëna nga 44.168 persona, nga moshë 18 deri në 109 vjeç. Ata klasifikuan vdekjet e tyre dhe matjet e 226 substancave të ndryshme në gjak, për 17 vite. Nga këta 44.168 persona, 5.512 vdiqën brenda këtyre 17 viteve. Dhe nga 226 substancat në gjak, 14 prej tyre ishin në parametra të ngjashme për 83% të rasteve, ndaj mund të parashikojnë nëse personi do të vdesë në 5 deri 10 vitet e ardhshme me saktësi prej 83%.



Provimet

Nxënësit pyesin një ditë profesorin:
 -Profesor, a i ke korrigjuar provimet?
 -Nxënës, unë kam 3 klasa. Nuk i korrigjoj dot aq shpejt.
 -Ju i keni bërë detyrat?
 -Jo, ne kemi 12 lëndë.

Shakaja para vdekjes

Nastradini ishte në prag të vdekjes dhe po bisedonte me të shoqen:
 -Dëgjo moj grua, kështu me lot në sy nuk mundem të të shikoj. Prandaj të kërkoj që të shkosh të visesh bukur si në nusëri, të rregullosh vetullat, të zbukurosh sytë dhe pastaj eja ulu këtu pranë meje.
 -Nuk i kuptoj këto fjalë që më thua, iu kthye e shoqja. Pse të zbukurohem siç thua kur të shoh ty që je sëmurë dhe të dëgjoj teksa rënkon?
 -Po zbukurohu se mbase kur vijnë të më marrin shpirtin më harrojnë mua se të shohin ty aq të bukur.

kulture

www.sot.com.al

Justin Bieber dhe Hailey Baldwin më në fund janë gati për martesën e tyre. Këngëtari dhe modelja janë martuar në 13 shtator 2018 me një ceremoni shumë intime në pallatin e drejtësisë në New York, por nuk kanë kryer ndonjë festë të madhe. Në fillim thuhej që ata donin të rimartoreshin me rastin e vitin e parë të martesës, por mediat e huaja shkruajnë që ato kanë zgjedhur datën 30 shtator. Madje, mediat e huaja kanë zbuluar edhe vendin e dasmës, që do të jetë në Californi ose Canada. Në ditët e kaluara të dy kanë qenë në Palmetto Bluff për të konfirmuar detajet. Justin Bieber dhe Hailey Baldwin kishin premtuar që do të organizonin ceremoninë e madhe këtë vit. Në fillim flitej për shkurtin e 2019 dhe më pas për pranverën e 2019. Por në të dyja rastet çifti nuk bëri asgjë.

Bieber dhe Baldwin gati të martohen në shtator



Përgjigjet e fjalëkryqit

	P	A	L		P	A	M	B	U	K
K	A	R	A	K	A	T	I	N		A
A	T		K	O	D	A	K		P	T
M	I	R		M	I	K		K	E	R
	N	O	R	I	S		K	A	R	O
S	A	M	I	T		S	O	T	I	R
E	T	E	R		V	E	R	E	M	
L	O	T		12/T	O	P		K	I	E
A	R		M	9/O	K	E	R		T	O
M		M	I	8/R	A	T	O	H	E	T
I	M	O	R	3/A	L		M	I	R	

Studimi, dioksidi i karbonit zgjat më shumë pemët

Sasia në rritje e dioksidit të karbonit mund të bëjë që pemët të zgjaten më shumë se zakonisht brenda vitit 2100. Sipas një studimi ndërkombëtar të koordinuar nga Universiteti Stanford dhe Universiteti Autonom i Barcelonës, të paktën deri në fund të shekullit bimët do të vazhdojnë të thithin me bollëk gati ¼ e CO2 të prodhuar nga njeriu, duke prodhuar 12% më shumë biomasë falë bashkëpunimit me mikroorganizmat dhe kërpudhat në tokë. Duke përpunuar rezultatet e 138 studimeve të mëparshme me ndihmën e inteligjencës artificiale dhe të dhënave satelitore, studiuesit kanë zbuluar se nivelet e CO2 që priten në fund të shekullit do të përcaktojnë një rritje të biomasës së bimëve me 12%, duke i mundësuar pemëve dhe bimëve të thithin më shumë CO2.

Fjalëkryq i shifruar

	2	3	10			2	3	6	13	14	11
11	3	8	3	11	3	12	5	4			3
3	12			11	9	14	3	11		2	12
6	5	8			6	5	11		11	1	8
	4	9	8	5	7		11	3	8	9	
7	3	6	5	12		7	9	12	5	8	
1	12	1	8			16	1	8	1	6	
10	9	12			12/T	9	2		12	1	10
3	8			6	9/O	11	1	8		12	9
6		6	5	8/R	3	12	9	17	1	2	
5	6	9	8	3/A	10		6	5	8		



1	2	3	4	5
6				
7				8
9			10	
		11		
12	13	14	15	
16				
17				
18				
19				
20				
21				
22				
23				
24				
25				
26				
27	28			
29				
30				
31				
32				
33				
34				
35				
36				
37				
38				
39				
40				
41				
42				
43				

Horizontal

1- Kryeqytet evropiano-jugor. 6- Element kimik, përbëhet nga azoti dhe hidrogjeni, hyn në përbërjen e shumë kripërave. 7- Tip automjeti i vogël transporti polak. 8- Notë në pentagram. 9- Ushtria Ruse. 10- Arixhi. 11- Shkretëtirë e madhe në Mongoli. 12- Zonja nga qyteti. 16- Janë kujdestare fëmijësh, shumës. 17- Është kryeqyteti i Arabisë Saudite. 18- Fshat i thellë malor në veri të Tiranës. 19- Së bashku. 20- Ndryshe për mbledhjen. 22- Aktorja Papavali, në inic. 23- I vogli i gomariçës. 24- Kazemat italiane. 25- Venë gjaku. 26- Sinjal i koduar për ndërhyrje emergjente. 27- Mbishkrim në varr. 29- Figurë tek gurët e shahut. 30- Musliu, specialist dhe kryeinxhinier në ndërtimin e hidrocentraleve dhe ministër. 31- Fortesë. 32- Dashuri e pastër dhe e sinqertë. 33- E thërrasin ndryshe këngëtarin Veronika Çikone. 35- Kush e ka atë i ecën. 36- E fillon nga e para. 37- Trupat Ndërkombëtare. 38- Kafshë ose bimë parahistorike të ngurtësuar. 39- Hyrja në Itali. 40- Ish sallë kumari, pa të fundit. 41- Agjencia e lajmeve greke. 42- Një hotel në mes të Tiranës. 43- Fshat shumë afër Tiranës.

Vertikal

1- Është lëndë djegëse. 2- Lumi ... Darja në Mesopotami të Irakut. 3- Cohë për rroba pune. 4- Rita, ish këngëtare në inic. 5- Përgjimet, e zë gjumi me hope. 8- Aparaturë elektronike që zëvendëson punën e njeriut. 10- Kolosi i ..., një ishull grek që njihet si një nga shtatë mrekullitë e botës së vjetër. 11- Ulje mbi gjunjë. 12- Bashkëpronare. 13- Poli i ngatërruar. 14- Kulare që i vihet qeve në qafë kur janë në qerre. 15- Dara, poeti arbëresh në inic. 16- Ish aktori elbasanas Hyskja. 18- Dorështrënguar. 20- Lumi që kalon për në Fier. 21- Virna, aktore italiane. 23- Vrasës, barbar, i pamëshirshëm. 24- Lartësira në mes të Palestinës dhe Izraelit. 25- Çitjane, brekushe apo ... që veshin gratë çame. 26- Magazinë e madhe drithi, hangar ose ... 28- Sheshi i shtangës të ngritësit të peshave. 29- Specialisti i sigurimeve shoqërore Kepi. 31- Një fshat i Vlorës. 32- Vakt ngrënie i besimtarëve myslimanë që agjërojnë. 33- Emri i mëparshëm i Egjiptit. 34- Pjesëtar. 36- Një ngjyrë. 38- Lumë në veri, degë e lumit Drin. 39- Gjika e skenës. 40- Ish shahisti rus kampion Kaparov në inic. 41- Humoristi anglez Atkinson në inic.

HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI

<p>Dashi 21 mars - 20 prill</p> <p>Një perspektivë e re marrëdhëniesh do shfaqet, dhe pyetja është: A do jeni gati? Koha mund të mos jetë ideale, por kur troket mundësia, duhet të përgjigjeni!</p>	<p>Demi 21 prill - 21 maj</p> <p>Familja juaj ose grupi shoqëror ka shumë për t'ju mësuar tani, kështu që kaloni më shumë kohë me ta! Duhet të keni rreth vetes sa më shumë njerëz.</p>	<p>Binjakët 22 maj - 21 qershor</p> <p>Jeni duke mësuar më shumë rreth asaj sesi të përdorni hijeshinë tuaj për të përparuar në perspektivat e karrierës, dhe ajo tashmë po fillon të paguhet.</p>	<p>Gaforrrja 22 qershor - 22 korrik</p> <p>Jini absolutisht të përqendruar! Pra, largojini të gjitha gjërat me shkëlqim dhe kthejeni vëmendjen tuaj të pandarë në atë që duhet të bëhet.</p>	<p>Luani 23 korrik - 22 gusht</p> <p>Kënaquni dhe argëtohuni me mënyrën si i bëni gjërat. Vendosi një buzëqeshje në fytyrën tuaj dhe dita do të jetë shumë e këndshme.</p>	<p>Virgjëresha 22 gusht - 22 shtator</p> <p>Mund të merrni lajme të mira sa i përket aspektit profesional. Edhe nëse jeni duke aplikuar për punë gjasat janë që të keni sukses.</p>
<p>Peshorja 23 shtator - 22 tetor</p> <p>Është e rëndësishme të vlerësoni gjërat më të vogla. Idetë që dëshironi të zhvillonin s'do kenë sukses, derisa t'i kuptoni plotësisht të gjitha detajet.</p>	<p>Akrepi 23 tetor - 21 nëntor</p> <p>Nuk ka asnjë enigmë të fshehur për ju, kështu që mos harxhoni kohë duke u përpjekur t'i kuptoni ëndrrat. Bëni mirë të kurseni pak më shumë.</p>	<p>Shigjetari 22 nëntor - 21 dhjetor</p> <p>Besimi të njerëzve është gjëja e duhur. Do t'ju mundësojë të afroheni më shumë me njerëzit, por do ju ndihmojë edhe të zgjeroni horizontet tuaja.</p>	<p>Bricjapi 22 dhjetor - 21 janar</p> <p>Niveli juaj i krijimtarisë është më i lartë se i shumë njerëzve që keni pranë. Përdoreni këtë moment për të realizuar ndonjë punë ose projekt.</p>	<p>Ujori 22 janar - 19 shkurt</p> <p>Përqendrohuni te njerëzit dhe në ndërtimin e marrëdhënieve me ta. Kjo do t'ju ndihmojë që të mos ngeleni vetëm në momente delikate.</p>	<p>Peshqit 20 shkurt - 20 mars</p> <p>Një person nga e kaluara juaj do të kthehet në jetën tuaj dhe transformimi i tij do të jetë i jashtëzakonshëm, por jo domosdoshmërisht për mirë.</p>

Telenovela "Ikardi" mund të ketë fund të lumtur, Juve nis sulmin final për të marrë yllin argjentinasi

Sulmuesi nuk po e gjen më veten tek Interi dhe Juve po shfrytëzon momentin për të mundësuar marrjen e tij për një shumë të pranueshme financiare

Adriatik BALLA

Një prej çështjeve më të nxehta të merkatos së verës, ajo që ka të bëjë me sulmuesin argjentinasi Mauro Ikardi, mund të zgjidhet në ditët e fundit të gushtit. Në fakt, ka lajme kontraktore, pasi vetë Ikardi dhe e dashura e tij pretendojnë se do të qëndrojnë tek Interi, por mediat italiane këmbëngulin se Juventus po ndërmer në këtë moment hapin e fortë për ta marrë numrin 9 të Interit tek "Zonja e Vjetër". Pra, e ardhmja e tashmë ish-kapitenit të Interit ende nuk është e qartë, e sigurt është që krisja me zikaltrit është e parikuperueshme. Juventus prej kohësh kërkon një qendërsulmues i cili të qëndrojë pranë portës dhe të jetë i aftë ta dërgojë topin në rrjetë, Higuain nuk është në planet e askujt dhe edhe nëse qëndron nuk do të jetë titullar, në këtë mënyrë Ikardi ka CV-në që dëshiron klubi bardhezi. Në krahun tjetër edhe 26-vjeçari i ka shkelur me kohë syrin "Zonjës së Vjetër" madje për herë të parë konfirmoi se do të largohet. Në dalje të restorantit ku po festohej ditëlindja e Martinez me një fjalë të shkurtër



pohues "po" ai iu përgjig pyetjes nëse do t'i thoshte lamtumirë Interit. Problemi qëndron tek kërkesa e klubit nga Milano që synon të përfshijë në bisedime Paulo Dibalën, në një kohë që presidenti i Juves, Anjeli ka vendosur vetëm një kusht, jo emri i Dibalës në negociatë. Në këtë mënyrë kampionët e Italisë po studiojnë një tjetër plan për të mbërritur tek amerikano-latini. Juventus po kërkon të të përfitojë menjëherë të ardhura për t'ia xhiruar zikaltrëve dhe është shtuar intensiteti i bisedimeve me Romën për kalimin

e Ruganit në kryeqytet, me valixhe në duar janë edhe Mario Mandzukic e Bentankur, ndërsa po bisedohet edhe me Barcelonën për transferimin e Emre Xhan në Katalonjë, teksa në listë për t'u larguar është edhe Matuidi. Nëse realizohet gjysma e operacioneve në dalje atëherë klubi torinez do të kishte paratë e mjaftueshme për të paguar Interin pa qenë nevoja që në negociatë të jetë emri i Dybalës, me klubin milanez që është i gatshëm të pranojë një ofertë prej 70 milionë eurosh. Ndërkohë që duket se është mbyllur përfun-

dimisht pista Napoli për Mauro Ikardin i cili duhet t'i jepte një përgjigje të kaltërve dhe sipas mediave në Itali, përgjigja ka qenë negative. Ndërkohë, e dashura e Ikardit, Uanda Nara, ka dhënë sinjale se argjentinasi mund të qëndrojë me Interin, duke qenë opsion i dëshiruar prej tij. Uanda Nara i ka thënë të gjitha por vetëm ka mbetur të konfirmohet zyrtarisht që Mauro Ikardi do të mbetet një lojtar i Interit, ashtu sikurse është raportuar më parë dhe se ai do të stërvitet me skuadrën e parë. Spekulumet se Ikardi do të largohet këtë verë janë ftohur dhe këtë e ka konfirmuar edhe Uanda Nara, agjente dhe gruaja e Ikardit gjatë një mbrëmje me gratë e tjera të futbollistëve të Interit, pasi që e dashura e Lautaro Martinez festoi ditëlindjen e 22-të mbrëmë. "Edhe një tjetër vit së bashku", ka shkruar ajo poshtë kësaj fotografie. "Sport Mediaset" dhe "Sky Sport Italia", në anën tjetër kanë raportuar që sulmuesi është ftuar sonte për të stërvitur në mbrëmje në "San Siro". 26-vjeçari konsiderohet si person "non grata" dhe është stërvitur i vetmuar kur Interi ishte në International Champions Cup.

MERKATO/ Zidane ende ka shpresë të sjellë Nejmari në Madrid

Gjigantët e La Ligës, Real i Madridit dhe Barcelona, mësohet se janë duke garuar për nënshkrimin e Nejmari këtë verë, pasi është bërë e qartë se Paris San Zhermen është e gatshme ta shesë brazilianin Navas. 27-vjeçari ishte sërish temë diskutimi gjatë konferencës për shtyp të Zinedine Zidane të premten, që ndodhi mes spekulimeve në Spanjë se Kejllo Navas mund të shkojë në anën tjetër, në PSG. Trajneri Zidane e ka bërë të qartë se ai preferon që Navasi të mbetet në Madrid, mirëpo nuk ishte kaq i drejtpërdrejtë kur foli edhe për mundësinë e transferimit të Nejmari. "Jam duke punuar me lojtarët që i kam në dispozicion dhe ne e kemi një ndeshje të shtunën. Gjithçka mund të ndodhë deri më 2 shtator, kur mbyllet afati kalimtar. Disa mund të vijnë, disa mund të largohen. Unë dua që 2 shtatori të vijë sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë që të mos ketë më pyetje. Jam i përqendruar te ndeshja e së shtunës. Unë nuk mund ta imagjinoj skuadrën pa Navasin. Ai është i lumtur këtu dhe dëshiron ta dëshmojë se mund të luajë këtu. Ai është një profesionist dhe unë llogaris në të", u shpreh Zidane. Tekniku francez pranoi për Nejmari s mbetet një objektivi



ATLETIKË

Koleman mund të përjashtohet 2 vjet, refuzon testin antidoping



Atletika është "mbretëreshë e sporteve", por përdorimi i dopingut në atletikën e avancuar është shqetësim ndërkombëtar në sport. Kështu, Kristian Koleman, njeriu më i shpejtë në botë në tre vjetët e fundit, po lufton për reputacionin e tij pas raportimeve se nuk është paraqitur në një numër të testeve të dopingut. Burime të nivelit të lartë i kanë thënë "Sportsmail" se sprintieri 23-vjeçar amerikan, që ka siguruar kontratë shtatëvjeçare sponsorizuese me

"Nike" në vitin 2017 si një pasardhës i Usain Boltit, është duke kundërshtuar një nga tri dështimet për t'u paraqitur në kontroll për doping në vitin e fundit. Por nëse Coleman dështon që të anulohet njëri nga këto, atëherë mund të përballet me një suspendim të gjatë, që jo vetëm se do ta mbajë atë jashtë Botërorit në Katar muajin e ardhshëm, por edhe jashtë Lojërave Olimpikë të vitit 2020 në Tokio, shkruan "Daily Mail". Sipas uebfaqes së Agjencisë Amerikane të

Anti-Dopingut (USADA), dështimi për t'u paraqitur në test dopingut në tri raste brenda 12 muajve mund të rezultojë në një suspendim prej dy vjetëve për atë që është shkelës i parë. Mësohet se ka bisedime të nivelit të lartë mes Agjencisë Botërore të Anti-Dopingut (ËADA), USADA-s dhe Njësitit të Integritetit të Atletikës të Federatës Botërore të Atletikës (IAAF) për këtë rast, ndërsa ekipi ligjor i Colemanit po e kundërshton së paku një nga mungesat.

MBROJTËSI

Van Dijk: Në të ardhmen nuk bëhem trajner

Ka shumë futbollistë që pasi tërhiqen nga futbolli i luajtur vijnë të bëjnë një karrierë si trajner. Një pjesë kanë dalë të suksesshëm dhe shembull është Zidane, por ka dhe të tjerë që nuk e preferojnë këtë. Mbrojtësi i Liverpoolit, Virxhil van Dijk ka pranuar që në të ardhmen nuk do të bëhet trajner. Van Dijk, i cili është pretendenti kryesor për të fituar "Topin e Artë", beson që një trajner ka shumë presion. "Në këtë moment nuk mendoj se profesioni i trajnerit është për mua. Shumë njerëz japin mendimet e tyre të cilat ndikojnë te ti. Preferoj mos të



përfundoj në këtë situatë. Nuk dua të bëhem analist sepse më duhet të them shumë gjëra që nuk i mbështes. Do të shohim", deklaroi ai.

LËVIZJA

Sançez braktis Gjermaninë, kalon tek Lila në Francë

"Mesfushori portugez i Bajernit të Mynihut, Renato Sançez do të bëhet pjesë e Lilës", shkruante dje e përditshmja e njohur franceze, "L'Equipe". Sançez do të bëhet transferim rekord i Lilës, pasi skuadra franceze do të paguajë 20 mln euro për të. 22-vjeçari do të firmos kontratë pesëvjeçare me Lilën. Mesfushori portugez iu bashkua Bajernit në verën e vitit 2016 për 35 mln euro, mirëpo ai nuk arriti të stabilizohej te skuadra bavareze. Ai ishte huazuar te Suonsi në verën e vitit 2017, por edhe aty dështoi të linte gjurmë.



Sançez stinorin e fundit me Bajernin luajti 24 ndeshje në të gjitha garat, ku shënoi dy gola dhe realizoi tre asiste për bavarezët.

SULMUESI

Defrele ikën nga Roma, rikthehet tek Sampdoria

Merkato në Itali vijon me ritme të larta. Gregor Defrel mund të cilësohet plotësisht një futbollist i Sampdorias, ndonëse për zyrtarizimin do të duhet të pritët edhe disa orë. Klubi gjenovez ka gjetur marrëveshjen me Romën, për të marrë francezin në huazim një vjeçar kundrejt një milionë eurove, me detyrimin për ta blerë verën e ardhshme për 13.5 milionë euro. Marrëveshja ka lënë të kënaqur të gjithë palët, ndërsa aktualisht menaxheri i Defrel po diskuton për kontratën e klientit të tij me skuadrën e Sampdorias. Defrel ishte një kërkesë speci-



fike e trajnerit De Françesko, që e ka pasur sulmuesin nën urdhrat e tij edhe te Sasuolo e Roma, skuadra që i ka drejtuar më herët.

STAFI/

DREJTOR/ Arjan PRODANI; KRYEREDAKTOR/ Kliti TOPALLI; KRONIKË/ Elvis MYRTA; KULTURË/ Julia VRAPI; SPORT/ Adriatik BALLA; MENAXHER SHITJE/ Shpëtim Caco

MARKETING: Glen PRODANI Cel: 068 60 33 098; email: gazetasotnews@gmail.com